# Republika e Kosovës

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 27/116
Datë: 28.12.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 dhjetor 2022, merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Sport.

2. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
***Qeveria – Vlada – Government***

***Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit***
***Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta – Ministry of Culture, Youth and Sports***

---

# Koncept Dokumenti për Sport

**Përgatitur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit**

Përmbajtja

Përmbledhje e dokumentit të konceptit 3
Hyrje 6
Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit 6
Kapitulli 1.1. Hyrje në përcaktimin e problemit 6
Kapitulli 1.2. Përcaktimi i problemit, shkaqet dhe pasojat 45
Kapitulli 1.3. Palët e interesuara 61
Kapitulli 1.4. Zbatimi i acquis së BE-së **Error! Bookmark not defined.**
Kapitulli 1.5. Krahasimi me vendet tjera **Error! Bookmark not defined.**
Kapitulli 2: Objektivat 63
Kapitulli 3: Opsionet 66
Kapitulli 3.1: Opsion asnjë ndryshim 85
Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit 86
Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë 87
Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme të opsioneve 98
Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave 102
Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi 103
Kapitulli 6: Krahasimi i opsione 105
Kapitulli 6.1: Planet e implementimit për opsionet e ndryshme 105
Kapitulli 6.2: Tabela krahasuese me të tre opsione 116
Kapitulli 7: Konkluzioni dhe hapat e ardhshëm 118
Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin 119
Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik 120
Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet sociale 123
Shtojca 3: Forma e vlerësimit për Ndikimet Mjedisore 127
shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore 130

Përmbledhje e dokumentit të konceptit

| **Informacion i përgjithshëm** | |
|---|---|
| Titulli | Koncept Dokument për Sport |
| Ministria bartëse | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit |
| Personi kontaktues | Fidan Shatri, Departamenti i Sportit në Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit |
| PVPQ | 4.1.2. i Planit Strategjik dhe Operacional 2022 - 2025 |
| Prioriteti strategjik | PSO - Konsolidimi i politikave vendore dhe ndryshimet e kornizës ligjore në harmonizim me organizatat ndërqeveritare sportive si dhe me organizatat botërore të sportit |

| **Vendimi** | |
|---|---|
| Çështja kryesore | Struktura e sportit nuk i përshtatet qëllimit dhe nevojave të kohës |
| Përmbledhje e konsultimeve | Procesi i hartimit të këtij Koncept Dokumenti ka filluar në muajin maj të vitit 2022, ku nga faza fillestare janë përfshirë të gjithë mekanizmat e përfshirë në sektor për të mundësuar dhënien e kontributit në hartim. Janë realizuar një sërë takimesh të prezantuara në kapitullin 5 të këtij Koncept Dokumenti, ku palë kryesore të interesit kanë qenë: institucionet publike të nivelit qendror dhe komunat; organizatat e sportit sikurse: KOK; KPK; KAS; Këshilli Kombëtar për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në aktivitete sportive; KosADA; Federata të Sportit; përfaqësues të sportistëve; Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive; Shoqata e Gazetarëve Sportivë; Grupi Konsultativ i Sportit. |
| Opsioni i propozuar | Opsioni 3: Kombinim i masave legjislative të kombinuara me hartimin e Strategjisë së Sportit dhe masa zbatuese |

| **Ndikimet kryesore të pritshme** | |
|---|---|
| Ndikimet buxhetore | |
| Ndikimet ekonomike | Krijimi i një kornize të re ligjore dhe hartimi i Strategjisë së Sportit i kombinuar me masa zbatuese dhe standarde të trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve, do të ketë efekt të drejtpërdrejtë në zhvillimin e sportit, krijimin e vendeve të punës si dhe mundësi për investime në sport dhe në infrastrukturë fizike të sportit. Gjithashtu, zhvillimi i konceptit të sportit për turizëm do të tërheq vëmendjen e shoqërisë dhe do të kontriboj në dimensionin ekonomik dhe shoqëror. |
| Ndikimet shoqërore | Opsioni 3 do të ketë ndikime pozitive në pjesëmarrjen e të rinjëve si dhe pjesëmarrjen e të gjithë grupmoshave në aktivitete fizike të cilat drejtpërdrejtë do të ndikojnë në përmirësimin e jetës dhe shëndetit. |

| | |
|---|---|
| | Opsioni 3 përmes krijimit të kornizës së re ligjore të sportit si dhe përmes miratimit të Strategjisë së Sportit do të ofroj qasje më të lehtë në aktivitetin fizik si dhe do të mundësoj krijimin e infrastrukturë fizike dhe hapësira për aktivitete.<br><br>Korniza e re ligjore dhe strategjike do të shoqërohet me aktivitete ndërgjegjësimi me qëllim nxitjen dhe pjesëmarrjen e të gjitha grupmoshave, atyre që jetojnë në varfëri, grupeve të margjinalizuara dhe të rinjve, pjesëmarrjen gjinore dhe etnike si dhe do të ofroj ambient të sigurtë dhe favorizues për të gjithë pavarësisht përkatësisë sociale, fetare, etnisë apo përkatësive të tjera.<br><br>Synim tjetër i këtij Koncept Dokumenti është nxitja e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete sportive dhe shfrytëzimi i potencialit që përmes një rinie aktive, të përmirësohet shëndeti i shoqërisë, të eliminohen pabarazitë shoqërore dhe gjinore në pjesëmarrjen dhe përfaqësimin në sport, të avancohet imazhi i Kosovës në arenën vendore dhe ndërkombëtare në sektorin e sportit. |
| Ndikimet mjedisore | Nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis, megjithatë rritja e pjesëmarrjes në aktivitetet fizike dhe sport në përgjithësi do të rezultoj në interesim më të madh dhe kujdes të shtuar ndaj mjedisit. |
| Ndikimet ndër-sektoriale | Opsioni 3 ndikon drejtpërdrejt në mbrojtjen e të drejtave themelore të të gjithë atyre që përfshihen në aktivitetin fizik sportiv.<br><br>Opsioni rekomandon përfshirjen e parimeve të qeverisjes së mirë në kornizën ligjore e cila do të mundësoj avancimin dhe shfrytëzimin e mekanizmave për parandalimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.<br><br>Parimet dhe standardet e qeverisjes së mirë, janë propozuar të shoqërohen me ndërgjegjësimin dhe trajnimin e të gjithë grupmoshave për tu siguruar se janë të informuar për të drejtat e tyre dhe mjetet juridike në dispozicion.<br><br>Ky Koncept Dokument ka për qëllim ngritjen e pjesëmarrje së shoqërisë në aktivitete të sportit dhe vlen të theksohet se gjendja ekzistuese dëshmon se pjesëmarrja e burrave dhe djemve është dukshëm më e madhe se sa pjesëmarrja e grave dhe vajzave në aktivitetet e sportit dhe jo vetëm. Ngritja e pjesëmarrjes në sport do të shoqërohet me fushata ndërgjegjësuese ku gjithashtu do të synohet zbatimi i plotë i ligjit për barazi gjinore në të gjitha nivelet.<br><br>Gjendja ekzistuese e pabarazizë në të gjitha nivele e qeverisjes sportive dhe përfaqësimi i grave në strukturat qeverisë të sportit do të synohet të ngrihet përmes instrumenteve dhe masave legjislative dhe zbatuese. |
| Ngarkesat administrative për kompanitë | Opsioni i rekomanduar do të thjeshtoj komunikimin dhe ndërveprimin e organizatave të sportit me institucionet publike përmes krijimit të një sistemi/platforme digjitale e cila do të jetë e ndërveprueshme dhe me qasje në sistem nga të gjitha palët e përfshira në sektor. |
| Testi i NVM-së | N/A |

| **Hapat e ardhshëm** | |
|---|---|
| Afatshkurtër | 1. Finalizimi dhe miratimi i Strategjisë së re për Sport;<br>2. Krijimi i grupit punues për hartimin e ligjit të ri për sport;<br>3. Ndryshimi dhe plotësimi i ligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive; |

| | |
|---|---|
| | 4. Zhvillimi i konsultimeve me të gjitha palët e përfshira përgjatë procesit të hartimit të ligjeve;<br>5. Miratimi i Projektligjit nga Qeveria;<br>6. Mbështetja e punës së shqyrtimit të Projektligjit në Kuvend deri në miratimin e tij;<br>7. Hartimi i i akteve nënligjore në zbatim të ligjeve;<br>8. Zhvillimi i konsultimeve me të gjitha palët e përfshira përgjatë procesit të hartimit të akteve nënligjore deri në miratimin e tyre;<br>9. Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuese për nxijen e pjesëmarrjes në sport dhe aktivitete fizike. |
| Afatmesëm | 1. Ngritja e strukturave të reja të përcaktuara në ligjin e Sportit dhe ligjit përkatës për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive për të siguruar zbatimin e tij;<br>2. Zhvillimi i programeve dhe moduleve për ngritjen e kapaciteteve në të gjitha nivelet;<br>3. Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuese për nxijen e pjesëmarrjes në sport dhe aktivitete fizike;<br>4. Zhvillimi i platformës digjitale të sektorit të sportit. |

Hyrje

*Figura 1: Tabela përmbledhëse për koncept dokumentin*

| | |
|---|---|
| Titulli | Koncept Dokument për Sportit |
| Ministria bartëse | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit |
| Personi kontaktues | Fidan Shatri, Departamenti i Sportit në Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit |
| PVPQ | 4.1.2. të Planit Strategjik dhe Operacional 2022 - 2025 |
| Prioriteti strategjik | PSO - Konsolidimi i politikave vendore dhe ndryshimet e kornizës ligjore në harmonizim me organizatat ndërqeveritare sportive si dhe me organizatat botërore të sportit |
| Grupi punues | Fidan Shatri, Departamenti i Sportit – MKRS - Kryesues<br>Bilsim Bislimi – MKRS – anëtar<br>Brikena Mulliqi – MKRS – anëtare<br>Afërdita Fazliu – MKRS – anëtare<br>Taibe Selmani – MKRS – anëtare<br>Fatmir Kastrati – MKRS – anëtar<br>Atifete Jakupaj – MFPT – anëtare<br>Mirlinda Lushtaku – ZKM – anëtare<br>Liridona Hoti – ZKM – anëtare<br>Përfaqësues – KOK – anëtar<br>Jeton Oruçi – Ekspert i jashtëm<br>Richard Parrish – Ekspert i jashtëm<br>Borja Garcia – Ekspert i jashtëm |
| Informata shtesë | N/A |

Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

Kapitulli 1.1. Hyrje në përcaktimin e problemit

Sporti luan një rol jetik, jo vetëm në shëndetin dhe kondicionin individual, por edhe në formësimin e shoqërisë në përgjithësi. Mund të përmirësojë mirëqenien e përgjithshme dhe të ndihmojë në tejkalimin e çështjeve më të gjera shoqërore si racizmi, përjashtimi social dhe pabarazia gjinore.[1] Më e rëndësishmja, sporti ofron përfitime të rëndësishme në të gjithë vendin dhe është një mjet i rëndësishëm për marrëdhëniet e jashtme përmes diplomacisë si një shtytës kyç i politikave në forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare duke marrë gjithashtu në konsideratë çështje të tilla si arsimi, ekonomia, kultura, shëndeti dhe punësimi.

[1] Politika sportive e BE-së, Ecim më shpejt, synojmë më lart, arritur më tej, Shërbimi i Kërkimeve Parlamentare Evropiane: https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2019/640168/EPRS_BRI(2019)640168_EN.pdf#:~:text=Sport%20has%20a%20growing%20impact%20both%20on%20the,3%20%25%20of%20total%20EU%20gross%20value%20added .

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Qeveria në përgjithësi, përmes kësaj politike synon të përmirësoj kuadrin ligjor dhe institucional në mënyrë që të vendos bazën për përmirësimin e mjedisit sportiv të hapësirave/infrastrukturës për fëmijë dhe të rritur, të krijojë mundësi më të mirë për të marrë pjesë në aktivitete fizike dhe sport si dhe të promovoj shëndetin, të kontribuojë në eliminimin e pabarazive dhe diskriminimit në bazë gjinore, racore dhe etnike, për të mbështetur një lëvizje sportive të lirë dhe të pavarur dhe për të dhënë përvojë pozitive të sportit si garë por edhe si argëtim përmes aktiviteteve sportive.

Sporti në Kosovë rregullohet me Ligjin nr. 2003/24 për sportin i cili është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-075 dhe Ligjin nr. 06/L-115 i cili ligj për herë të parë hyri në fuqi në vitin 2003 (në tekstin e mëtejmë " ligji").

Sipas këtij ligji, aktivitetet sportive zhvillohen në baza amatore dhe profesionale. Sporti përfshin të gjitha format e aktivitetit fizik, të cilat, nëpërmjet pjesëmarrjes së rastësishme ose të organizuar, synojnë të shprehin dhe përmirësojnë aftësinë fizike dhe shëndetin mendor si dhe ndikon pozitivisht në krijimin e marrëdhënieve shoqërore ku ndër të tjera, synimi i pjesëmarrjes është arritja e rezultateve në të gjitha nivelet e pjesëmarrjes në sport.[2]

Për më tepër, ligji rregullon organizimin, kushtet dhe mënyrat e aktiviteteve fiziko-sportive; të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e atyre që i organizojnë ato; si dhe rregullon çështjet që kanë të bëjnë me themelimin, licencimin dhe menaxhimin e organizatave sportive.

Ligji ofron garanci për të gjithë personat, pavarësisht nga mosha, gjinia, kombësia, përkatësia politike, feja, aftësitë fizike dhe niveli social dhe ekonomik për të marrë pjesë në sport dhe aktivitetet fizike.

Përveç kësaj, ligji përcakton përgjegjësitë e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e institucioneve dhe organizatave sportive.

Ministria përgjegjëse për sport, në bazë të ligjit ka kompetencë të përcaktoj politikat, hartoj akte ligjore, aprovoj akte nënligjore dhe përcaktoj standardet e detyrueshme në fushën e sportit si dhe zhvilloj programe për rritjen e nivelit të sportit. Gjithashtu, ministria në bazë të ligjit është përgjegjëse që të sigurojë zbatimin e këtij ligji përmes mekanizmave specifikë të parashikuar në ligj.

Vlen të theksohet se ligji për Sport është miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2003 kur Kosova vepronte nën autoritetin e UNMIK-ut. Që atëherë, shumë ndryshime kanë ndodhur duke përfshirë edhe sektorin e sportit. Që nga pavarësia në vitin 2008, organizatat sportive të Kosovës filluan të njihen nga federatat ndërkombëtare sportive. Federata e parë vendore e njohur ndërkombëtarisht edhe para vitit 2008 ishte Federata e Pingpongut që u bë pjesë e Federatës Ndërkombëtare të Pingpongut në vitin 2003. Federatat e tjera vendore sportive u bënë pjesë e federatave ndërkombëtare përkatëse në faza/periudha të ndryshme, por vetëm pas vitit 2008. Deri sa po zhvillohej gjatë viteve, Kosova ka siguruar edhe njohje ndërkombëtare nga organizatat ndërkombëtare sportive sikurse nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar në vitin 2014, FIBA në vitin 2015 dhe FIFA në vitin 2016, si dhe vazhdon të kërkojë anëtarësim në organizata të tjera ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Këshilli e Evropës. Në këtë kontekst, Kosova po ashtu është pjesë e nismës "Java Evropiane e Sportit" e Komisionit Evropian e cila ka për synim pjesëmarrjen sa më të madhe të shoqërisë në sport dhe aktivitet fizik. Tani e disa vite, ky aktivitet realizohet në baza të rregullta.

Ndërkohë që ndryshimet kanë ndodhur në praktikë, dokumentet e politikave dhe kuadri ligjor i sportit kanë mbetur të njëjtë, me përjashtim të disa ndryshimeve dhe amendamenteve të kufizuaratë cilat janë realizuar

[2] Karta Evropiane e Sportit, neni 2: https://rm.coe.int/revised-european-sports-charter-web-a6/1680a7534b

në vitin 2012 dhe 2019. Gjatë zbatimit të ligjit të sportit, janë evidentuar paqartësi ligjore dhe boshllëqe ligjore në kuptim të përmbajtjes dhe procedurave që do të shpjegohen në kapitullin e mëposhtëm.

Duke marrë parasysh atë që është cekur më lartë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në planin vjetor të saj të punës dhe në Dokumentin e Planit Strategjik dhe Operacional, e ka paraparë hartimin e Koncept Dokumentit për Sportin.

Qëllimi i këtij Koncept Dokumenti është të analizojë problemin duke përdorur burimet e mëposhtme: 1. shqyrtimi i raporteve në fushën e sportit; 2. analiza e kuadrit ligjor ekzistues për sportin (legjislacioni primar dhe sekondar); 3. analiza raporteve të ndryshme të përgatitura nga Ministria dhe institucionet dhe organizatat e tjera; 4. të gjeturat nga takimet dhe diskutimet me palët e përfshira (si: organizatat e ndryshme të sportit; federatat; klubet sportive; sportistët; gjyqtarët/arbitrat etj.); 5. duke përfshirë aktorë të tjerë të ndryshëm të përcaktuar në seksionin 5.

Dispozitat përkatëse që lidhen me fushat në kompetencë të sportit janë përcaktuar në ligjet specifike dhe aktet nënligjore të paraqitura figurën 2 si më poshtë.

*Figura 2: Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore*

| Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor | Lidhja me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare | Institucioni (-et) shtetëror (e) përgjegjës (e) për zbatim | Roli dhe detyrat e institucionit (-eve) |
|---|---|---|---|
| Kushtetuta e Republikës së Kosovës | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702 | Të gjitha institucionet shtetërore, media, shoqëria civile dhe qytetarët e Kosovës | Zbatimi dhe reflektimi i parimeve dhe të drejtave dhe lirive kushtetuese në të gjitha politikat publike (ligjore dhe zhvillimore) të ndërmarra në nivel qendror dhe lokal. |
| Ligji për Barazi Gjinore 05/L-020 | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923 | Të gjitha institucionet shtetërore, media, shoqëria civile dhe qytetarët e Kosovës Agjencia për Barazi Gjinore | - Garantimi i mundësive dhe trajtimi i barabartë, në sferën publike dhe private të jetës shoqërore, duke përfshirë jetën politike dhe publike, punësimin, arsimin, shëndetësinë, ekonominë, përfitimet shoqërore, sportin, kulturën |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | dhe sferat tjera të përcaktuara me këtë ose ndonjë ligj tjetër.<br>- sigurimin e pjesëmarrjes së plotë dhe të barabartë të meshkujve dhe femrave në të gjitha aspektet e jetës politike, sociale, kulturore, arsimore, ekonomike dhe fushat tjera të përcaktuara me këtë ose ndonjë ligj tjetër. |
| Ligji Nr. 05/L -021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10924 | - Qeveria e RKS<br>- Zyra për Qeverisje të Mirë, dhe Zyra Ligjore, në kuadër të Zyrës së Kryeministri | - Qasje dhe pjesëmarrje në shkencë, sport, art, shërbime dhe aktivitete kulturore. |
| Ligji nr. 2003/24 për Sportin | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2490 | - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;<br><br>- Departamenti i Sportit (në kuadër të Ministrisë) | - zhvillimi dhe përcaktimi i politikave të përgjithshme në sektorin e sportit;<br>- krijimi i infrastrukturës sportive;<br>- përcaktimi i kritereve dhe procedurave për dhënien e licencave për federatat vendore;<br>- monitorimi i zbatimit të ligjit.<br><br>- zhvillimi, monitorimi dhe vlerësimi i programeve të politikave të sportit, hartimi i |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | legjislacionit primar dhe sekondar për sektorin e sportit në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin Ligjor dhe departamentet e tjera përkatëse në Ministri. |
| | | - Komiteti Olimpik i Kosovës; | - promovimi dhe përcjella e zhvillimit të sportit në Republikën e Kosovës;<br>- pjesëmarrja në propozimin dhe zbatimin e masave për përmirësimin e zhvillimit të sportit;<br>- kontribuon në arritjen e rezultateve më të larta të sportistëve të Kosovës dhe pjesëmarrjen e tyre në ekipet vendore sportive në Lojërat Olimpike si dhe në garat botërore, evropiane, rajonale;<br>- promovon edukimin në programet e vlerave olimpike në të gjitha nivelet e arsimit në institucionet sportive dhe universitete.<br>- KOK-u ka autoritetin ekskluziv për të përfaqësuar Kosovën në |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | Lojërat Olimpike dhe në ato rajonale, në garat kontinentale nën patronazhin e KON-it dhe të udhëheqë delegacionet e saj përkatëse në ngjarje dhe gara të tilla. |
| | | - Këshilli i Arbitrazhit Sportiv | - vendos për kërkesën e palëve të cilat janë marrë vesh me kompetencë të gjykatës, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ligj;<br>- Zgjidh mosmarrëveshjet në lidhje me sportin;<br>- vendos për kërkesat dhe shqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimeve të federatave sportive, shoqatave sportive. |
| | | - Federatat e sportit | - përgjegjëse për arritjen e objektivave të përcaktuara në statutet e tyre;<br>- Zhvillon dhe zgjeron konkurrencën sportive në të gjithë territorin;<br>- Merr pjesë dhe përfaqëson Kosovën në arenën ndërkombëtare; |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | - Rritja e kapaciteteve të klubeve sportive. |
| | | - Klubet Sportive | - mund të jetë private ose publike;<br>- zbatojnë aktivitete sportive;<br>- merr pjesë në veprimtari në vend dhe në gara ndërkombëtare sipas legjislacionit në fuqi. |
| | | - Komuna | - Përcakton buxhet për sportin;<br>- Përgjegjëse për operimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të sportit në kompetencën e tyre dhe brenda territorit të komunës;<br>- Monitoron aktivitetet sportive në territorin e Komunës |
| | | - të gjitha institucionet e edukatës fizike dhe sportit; | - mbajnë stërvitje, edukatë fizike dhe sportin; |
| Ligji nr. 04/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 për Sport | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2802 | - Komiteti Olimpik i Kosovës | Komiteti Olimpik i Kosovës është institucioni më i lartë sportiv joqeveritar, ku anëtarësohen federatat sportive, shoqatat sportive dhe shoqatat tjera, aktivitetet e të cilave janë të |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | rëndësishme për zhvillimin e sportit në përputhje me statutin dhe rregulloret e saj. |
| | | - Komiteti Paralimpik | - Federatat sportive të personave me aftësi të kufizuara anëtarësohen në Komitetin Paralimpik të Kosovës, përkatësisht në Federatën e Sporteve të Shurdhërve, kurse institucionet dhe personat e tjerë juridikë për të ushtruar aktivitete specifike sportive dhe rekreacion të personave me aftësi të kufizuar i bashkohen Olimpiadës Speciale të Kosovës me statusin e Federata Kombëtare e Sporteve. |
| | | - Këshilli i Arbitrazhit Sportiv | - vendos për kërkesën e palëve të cilat janë marrë vesh me kompetencë të gjykatës, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ligj;<br>- Zgjidh mosmarrëveshjet në lidhje me sportin;<br>- vendos për kërkesat dhe |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | shqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimeve të federatave sportive, shoqatave sportive, etj. |
| | | - Këshilli shkollor në shkollat fillore dhe të mesme | - organizon gara sportive në bashkëpunim me Federatën e Sporteve Shkollore. |
| | | - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministria përgjegjëse për arsim | - Lidh memorandum mirëkuptimi për të përcaktuar mënyrën e themelimit, detyrave dhe financimit të organizimit të sportit shkollor. |
| | | -Qendra e Mjekësisë Sportive | - Përgjegjës për kryerjen e ekzaminimit shëndetësor të sportistëve dhe pjesëmarrësve në aktivitete sportive. |
| Ligji Nr. 06/l-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 për Sportin, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-075 | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18916 | | Njëjtë si më sipër |
| Ligji Nr. 05/L-090 për Sponsorizime në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13271 | - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; | - Nxjerr akte nënligjore për zbatimin e ligjit;<br>- Lëshon certifikatë që vërteton se sponsorizimi në |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | fushën e kulturës, rinisë dhe sportit është në interesin e përgjithshëm publik. |
| | | - Administrata Tatimore e Kosovës | - Zbaton implementimin e ligjit |
| Ligji Nr. 06/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L -090 për sponsorizimet në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18918 | - | - Njëjtë si më sipër |
| Ligji Nr. 05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13278 | - Komiteti Olimpik i Kosovës | - Mund të organizojë ngjarje sportive<br>- Ndërmerr masa parandaluese për të shmangur dhunën, sjelljet e pahijshme, dukuritë negative, manipulimet dhe kurdisjen e ngjarjeve sportive |
| | | - Federatat e sportit | - Kanë të njëjtat detyrime ligjore si më sipër |
| | | - Klubet sportive | - Kanë të njëjtat detyrime ligjore si më sipër |
| | | - Organizatori | - Ka të njëjtat detyrime ligjore si më sipër si dhe është i detyruar të respektojë nenin 6, 8,9, 10, 12 të ligjit. |
| | | - Këshilli Kombëtar për | - Është organ i përhershëm i |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në aktivitete sportive | përbërë nga përfaqësimi ndërinstitucional dhe përbëhet nga pesë anëtarë nga sektorë të ndryshëm. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Këshillit konsistojnë në: parandalimin e dhunës dhe dukurive të tjera negative në aktivitetet sportive; sanksionimi i dhunës dhe dukurive të tjera negative në ngjarje sportive; pjesëmarrjen dhe dhënien e rekomandimeve për projektligjet dhe politikat që lidhen me dhunën; ndjek me kujdes ngjarjet sportive në rastet e vlerësuara në ngjarje sportive etj. |
| | | - Policia e Kosovës | - Ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e dhunës dhe sjelljet e pahijshme në aktivitetet sportive nën përgjegjësinë e tij në përputhje me nenin 13 të ligjit. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Ligji nr. 06/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18919 | - Federatat e sportit<br><br>- Klubet sportive<br><br>- Organizatori | - Do të gjobiten nëse nuk zbatojnë nenin 2 dhe 3 të ligjit.<br><br>- Do të gjobiten nëse nuk zbatojnë nenin 2 dhe 3 të ligjit.<br><br>- Do të gjobiten nëse nuk zbatojnë nenin 2 dhe 3 të ligjit. |
| Ligji Nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=19055 | - OJQ-të<br><br>- Departamenti i OJQ-ve | - Janë të obliguar të aplikojnë në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit për t'u themeluar si person juridik. Aplikimi bëhet në Departamentin e OJQ-ve pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme<br>- Përfitimi publik i OJQ-së e obligon të bëjë raportim financiar dhe mbikëqyrje<br><br>- Lëshon certifikatën e themelimit të OJQ-së<br>- Mban regjistrin dhe bazën e të dhënave të OJQ-ve |
| Ligji NR. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe llogaridhënien, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/194, Ligjin nr. 05/L-063 | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524 | - Institucionet publike si më poshtë:<br>1. Ministritë e linjës<br>2. Komunat<br>3. Agjencitë | -Janë të obliguar të shpenzojnë fondet publike në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530 | - Komuna | - Ushtron kompetencat e veta në planifikimin urban; zbatimin e rregulloreve të tyre lidhur me infrastrukturën |
| Ligji Nr. 04/-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770 | - Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë | - Licencon institucionet e arsimore private ose në partneritet që ofrojnë arsimin në nivelet 0,1,2,3 dhe 4 dhe merr parasysh standarded e për shëndetin dhe sigurinë dhe dizajnin e qasjes në salla sportive |
| Ligji Nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18684 | - Ministria | - Çdo ndryshim në strukturën organizative të Ministrisë do të bëhet në përputhje me këtë ligj. |
| Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative | https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=12559 | - Ministria | - Zbatimi i procedurave administrative |
| Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8666 | - Ministria e Shëndetësisë | - Neni 17 Llojet e institucioneve shëndetësore<br>- 3. Institucionet e nivelit dytësor të kujdesit shëndetësor janë:<br>- 3.8. Qendra e mjekësisë sportive;<br><br>- 4. Institucionet e nivelit tretësor të kujdesit shëndetësor janë:<br>- 4.5. Qendra kombëtare e mjekësisë Sportive; |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | - Neni 33 Mjekësia e sportit<br>- 1. Mjekësia e sportit është formë e organizimit të kujdesit shëndetësor në nivelin dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor që veprimtarinë e saj e zbaton nëpërmjet përkujdesjes për gjendjen shëndetësore të sportistëve aktivë si dhe të qytetarëve të cilët merren në mënyrë rekreative me sport.<br>- 2. Themelimi, organizimi dhe veprimtaria e Shërbimit profesional të mjekësisë së sportit përcaktohen me akt nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria përkatëse. |
| Kodi Nr. 03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2600 | - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve | - Neni 42<br>Nenet 39 deri 41 zbatohen me ndryshimet e nevojshme për produktet e peshkimit apo të veprimtarisë së kultivimit të peshkut në liqeje apo lumeje, që ndodhen përskaj kufirit ndërmjet Kosovës dhe vendit tjetër nga peshkatarë kosovarë apo edhe për produktet e veprimtarisë së |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | gjuetisë, që zhvillohet në liqeje apo lumeje të tille nga sportistët e Kosovës. |
| | | - Dogana e Kosovës | - Produktet farmaceutike që përdoren në manifestimet ndërkombëtare sportive<br>- Neni 68<br>- Produktet farmaceutike për përdorim mjekësor njerëzor apo veterinar nga personat apo shtazët që vijnë nga vende tjera për të marrë pjesë në manifestimet ndërkombëtare sportive të organizuara në Kosovë, e që nuk i tejkalojnë kufijtë e sasive që do të mjaftonin për plotësimin e nevojave gjatë tërë qëndrimit të tyre në Kosovë, do të lejohen të liruara nga detyrimet e importit.<br><br>DEKORATA APO SHPËRBLIME NDERI Neni 89<br>b) Kupat, medaljet dhe artikujt e ngjashëm të një natyre tejet simbolike të cilat i janë dhënë shpërblim jashtë Kosovës, personave që janë |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | banor të Kosovës, si shenjë nderi për veprimtarinë e tyre në fusha të artit, shkencës, sportit apo shërbimeve publike apo si një mirënjohje për suksesin e arritur në një ngjarje të veçantë, të cilat importohen në Kosovë nga vetë ata persona;<br><br>Neni 98<br>c) Ekspozita dhe ngjarje që mbahen kryesisht për arsye shkencore, teknike, zejtare, artistike, edukative apo kulturore, apo sportive, për arsye fetare apo kulti, aktivitete të sindikatave apo për turizëm, apo me qëllim të promovimit të njohjes ndërkombëtare;<br><br>Literatura apo materialet informative turistike (botimet informative turistike)<br>a) Dokumentacioni (fletushkat, broshurat, librat, revistat, udhërrëfyesit, afishet me apo pa kornizë, fotografitë dhe fotot e zmadhuara pa korniza, hartat me apo pa |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | ilustrime, ekspozimet e vitrinave dhe kalendarët e ilustruar), që do të shpërndahen falas dhe qëllimi kryesor i të cilave është inkurajimi i publikut për të vizituar vendet e huaja e sidomos për të marrë pjesë në takime apo ngjarje kulturore, turistike, sportive, fetare apo profesionale, me kusht që kjo literaturë përmban jo më tepër se 25 % reklamime private komerciale, duke përjashtuar të gjitha reklamat private komerciale për firmat në Kosovë dhe se natyra e përgjithshme e qëllimeve promovuese të tyre është e dukshme; |
| Ligji Nr. 02/L-78 Ligji për Shëndetësi Publike | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2573 | - Ministria e Shëndetësisë | - Neni 28<br>- d) Rolin e ushtrimeve fizike, të sportit dhe muzikës në promovimin e shëndetit;<br><br>Kujdesi Shëndetësor për të Rinjtë<br>Neni 34<br><br>b) Këshillon lidhur me edukatën fizike (trupore) në shkolla, edukatën ndihmëse fizike, |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | dhe sportet studentore;<br><br>Kujdesi Shëndetësor në Lidhje me Sportin<br><br>Neni 35<br><br>Veprimtaria, struktura dhe mënyra e funksionimit të kujdesit shëndetësor në lidhje me sportin për shkak të specifikave rregullohet me akt nënligjor. |
| Ligji Nr. 05/L -028 për Tatimin në të Ardhurat Personale | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11014 | - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve | - Neni 8<br>Të ardhurat që përjashtohen<br><br>1.23. të ardhurat në formë shpërblimi nga institucionet shtetërore për arritje në shkencë, sport dhe kulturë; |
| Udhëzimi Administrativ (MKRS) Nr. 01/2022 për kushtet, kriteret dhe procedurat për themelimin, licencimin dhe rivlerësimin e federatave dhe organizatave sportive | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=59343 | - Komisioni për vlerësimin e kritereve për licencimin e Federatave Sportive<br><br>- Sekretari i Komisionit | - Shqyrton dhe vlerëson aplikimet e federatave sportive dhe i rekomandon ministrit lëshimin, refuzimin ose heqjen e licencave.<br>- Mbani regjistrin e të gjitha aplikimeve dhe vlerësimeve për licencim.<br>- I raporton ministrit në përputhje me UA.<br><br>- Mbështet punën e Komisionit; përgatit raporte dhe mbështet |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | - Komisioni i Ankesave<br><br>- Federatat e sportit | Komisionin në mbajtjen e regjistrit.<br><br>- Përgjegjës për shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave kundër vendimeve të Komisionit.<br><br>- Janë të detyruar të respektojnë kriteret dhe detyrimet që rrjedhin nga UA. |
| Rregullore (MKRS) Nr. 03/2022 për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Këshillit Kombëtar për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=59831 | - Këshilli Kombëtar për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive | - Zhvillon politika dhe strategji për parandalimin e dhunës dhe dukurive të tjera negative;<br><br>- Koordinon aktivitetet me institucionet përkatëse për parandalimin dhe sanksionimin e dukurive negative në ngjarjet sportive;<br><br>- Vlerëson nëse një ngjarje sportive është me rrezik të lartë;<br><br>- Duke dhënë informacion këshillon autoritetet kompetente për hulumtimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive; |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | - Të gjithë personat fizikë dhe juridikë | - Bashkëpunon me Organizatat Joqeveritare që merren me parandalimin e dhunës dhe dukurive të tjera negative;<br><br>- Bashkëpunon me organizata dhe institucione ndërkombëtare në shkëmbimin e përvojave për parandalimin e dhunës dhe dukurive të tjera negative;<br><br>- Zbaton të gjitha masat dhe aktivitetet e nevojshme të parapara në Rregullore.<br><br>- Janë përgjegjës për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Rregullorja |
| Rregullorja nr. 14/2013 për ofrimin e mbështetjes së përhershme financiare të sportistëve që kanë fituar medalje në Lojërat Olimpike, Kampionatet Botërore dhe Kampionatet Evropiane | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10239 | - Federatat e sportit<br><br>- Ministria<br><br>- Sportistët | - Paraqet propozimet për fituesit e mbështetjes së përhershme financiare në KOK dhe KPK.<br><br>- Vendos për mbështetje të përhershme financiare për kandidatët që i plotësojnë kushtet sipas Rregullores.<br><br>- Sportistët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | rregullore, kanë të drejtë për përfitime financiare. |
| Rregullorja nr. 15/2013 për ndarjen e shpërblimeve shtetërore për sportistët që arrijnë rezultate kulminante në garat ndërkombëtare | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10251 | - Federatat e sportit<br><br>- Ministria<br><br>- Sportistët dhe trajnerët | - Rezultatet e arritura ia praqet KOK-ut dhe KPK-së<br>- KOK dhe KPK-ja verifikojnë rezultatet dhe ia paraqesin Ministrisë vendimin përfundimtar<br><br>- Vendos për ndarjen e shpërblimeve për fituesit në përputhje me kriteret e përcaktuara në Rregullore<br><br>- Sportistët që përmbushin kriteret e përcaktuara në rregullore, kanë të drejtë për përfitime financiare. |
| Rregullorja (MKRS) Nr. 04/2018 për kategorizimin e sporteve | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18284 | - Federatat e sportit<br><br>- KOK | - Federatat sportive janë të kategorizuara në përputhje me kriteret e përcaktuara në Rregullore.<br><br>- Informon federatat sportive për e format dhe procedurat e aplikimit të përcaktuara në Rregullore<br><br>- Komisioni përkatës i KOK- |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | ut shqyrton aplikacionet dhe zhvillon një listë të renditjes së federatave sportive; |
| | | - Ministria | - Ofron mbështetje financiare në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në Rregullore |
| Rregullorja (MKRS) Nr. 05/2018 për kategorizimin e sportistëve dhe trajnerëve | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18285 | - Sportistët | - Kategorizohen në përputhje me kriteret e përcaktuara në Rregullore dhe kanë të drejtë për përfitime financiare |
| | | - Trajnerët | - Kategorizohen në përputhje me kriteret e përcaktuara në Rregullore dhe kanë të drejtë për përfitime financiare |
| | | - Ministria | - Ministria ofron mbështetje financiare për sportistët dhe trajnerët që i përmbushin kriteret e përcaktuara në Rregullore |
| | | - KOK | - Në përputhje me Rregulloren bën renditjen e sportistëve dhe trajnerëve si dhe mban regjistrin. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2015 për Funksionin e Komitetit Olimpik të Kosovës | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15141 | - KOK | - Rregullorja përcakton funksionimin si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e KOK-ut. |
| Rregullorja nr. 03/2013 për dhënien e bursave për shpresat olimpike dhe paralimpike | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10369 | - Sportistët<br><br>- Federatat e sportit<br><br>- KOK ose KPK<br><br>- Ministri | - Sportistët që përmbushin kriteret e përcaktuara në rregullore kanë të drejtë të përfitojnë bursë studimi në përputhje me procedurat dhe kriteret e Rregullores.<br><br>- Federatat sportive përzgjedhin kandidatët që do të propozohen për bursa në KOK ose KPK-ë<br><br>- Shqyrton aplikimet dhe i propozon ministrit listën e kandidatëve<br><br>Për përfituesit vendos në bazë të listës së kandidatëve të pranuar nga KOK dhe KPK-ja. |
| Projektligji për Anti Doping | https://konsultimet.rks-gov.net/vieëConsult.php?ConsultationID=41380 | - Agjencia Shtetërore Anti-Doping | - Është i vetmi institucion shtetëror që organizon, drejton dhe kontrollon aktivitetet antidoping në sport në Republikën e Kosovës;<br>- Rregullon, përcakton dhe kryen kontrollin |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | brenda dhe jashtë të garave sportive në përputhje me kodin botëror antidoping;<br>- Mbledh, ruan, mbron dhe kryen veprime të të dhënave personale të sportistëve dhe personave të tjerë në bazën e të dhënave në lidhje me kontrollin e dopingut;<br>- Bën rritjen e kapaciteteve dhe certifikimin e zyrtarëve të kontrollit të dopingut<br>- Implementon detyrimet që rrjedhin nga ligji. |
| | | - Organizatat sportive; sportistët; trajnerët | - Janë përgjegjës për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji. |
| Udhëzim Administrativ (MKRS) Nr. 03/2015 për Themelimin dhe Regjistrimin e Klubeve Sportive Publike dhe Private të Sportit | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15156 | - Federatat e sportit | **KLUBET PUBLIKE TE SPORTIT**<br>**Neni 1**<br>1. Klube publike të sportit janë të gjitha organizatat sportive të cilat janë të themeluara nga se paku pesëmbëdhjete (15) persona fizik të moshës madhore (mbi 18 vj.) në cilësinë udhëheqëse dhe organizative të punës, ose nga se |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | paku një person juridik. |
| | | - Klubet Sportive | 2.Klubet nuk mund të emërtohen ose të mbajnë emrin e Shtetit "Kosova", (përfshire emërtimet tjera ne gjuhet e komuniteteve të Kosovës) dhe të shteteve tjera. |
| | | -Drejtorit Komunale për Sport | 2.1.Monitorimin e zbatimit te kësaj dispozite e bëjnë drejtoritë komunale për sport dhe Federatat e Sportit.<br>Neni 9<br>1. Klubit publik, për regjistrim ne Drejtorinë e Sportit të Komunës përkatëse nevojiten:<br>1.1.aktet normative nga neni 7 i këtij Udhëzimi;<br>1.2.nenshkrimet e themeluesve të klubit, numrat dhe kopjet e letërnjoftimeve;<br>1.3.procesverbali nga mbledhja e Kuvendit Themelues; |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | 1.4.vendimi për zgjedhjen e Bordit Drejtues, Kryetarit dhe Këshillit Mbikëqyrës.<br><br>Neni 10<br><br>Drejtoritë Komunale për sport obligohen të mbajnë regjistrat për klubet sportive të regjistruara në Komunat e tyre. |
| Rregullore (MKRS) Nr. 01/2018 për Përcaktimin e Kritereve, Procedurave dhe Formës për Vërtetimin e Sponsorizimit në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15916 | - Ministria | Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i kritereve, procedurave dhe formës së vërtetimit të sponsorizimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, si fusha të interesit publik sipas përkufizimit të dhënë në Ligjin 05/L – 090 për Sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit si dhe në përputhje me fushat e përgjegjësisë së Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.<br><br>Neni 6<br>Kriteret e veçanta në fushën e sportit<br><br>1. Përfitues i sponsorizimit në fushën e sportit mund të jenë individët që janë të regjistruar në |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | klube / shoqata sportive dhe organizatat sportive që janë të regjistruar në federata sportive, Komitetin Olimpik të Kosovës, përkatësisht në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.<br><br>2. Komiteti Olimpik i Kosovës është përfitues i lehtësirave të përcaktuar me Ligjin për Sponsorizimet.<br><br>3. Federatat sportive të cilat mund të përfitojnë nga lehtësirat e përcaktuara me Ligjin për Sponsorizime, duhet të jenë të licencuara nga MKRS si dhe të jenë anëtare të KOK-ut.<br><br>4. Klubet dhe organizatat sportive të cilat janë të regjistruara në federatat sportive përkatëse dhe të cilat kanë zhvilluar veprimtari sportive se paku një vit e më shumë, mund të përfitojnë nga Ligji për Sponsorizime.<br><br>5. Sportistët e sporteve |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | individuale të cilët janë anëtarë të ekipeve kombëtare të Republikës së Kosovës apo Ekipit Olimpik të Kosovës.<br><br>Neni 7<br>Procedura e dorëzimit të kërkesës<br><br>1. Përfituesi i sponsorizimit i drejtohet me kërkesë me shkrim Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për shqyrtimin dhe vërtetimin e sponsorizimit pasi të jenë siguruar paraprakisht aprovimet në rastet si: 1.1. Sportisti individual siguron aprovimin nga klubi i tij /saj dhe nga federata përkatëse; 1.2. Klubi përkatës siguron aprovimin nga federata përkatëse; 1.3. Federata përkatëse siguron konfirmimin e anëtarësisë në KOK; 1.4. Komiteti Olimpik i Kosovës aplikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | - Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave për Lëshimin e Vërtetimeve për Sponsorizime në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. | - Komisioni, në punën e tij do të ketë të gjitha përgjegjësitë që të shqyrtojë vërtetësinë e dokumenteve zyrtare, të sigurojë zbatimin e plotë të Ligjit dhe akteve të përgjithshme normative në fuqi, të vlerësojë qartësisht dhe në bazë të kritereve, ekzistimin ose jo të interesit publik në çdo kërkesë të sponsorizimit;<br><br>-Komisioni, ne afatin e caktuar mund të kërkojë sqarim për secilën kërkesë të paraqitur, në bazë të kompetencave të veta, nga organet përkatës mbikëqyrëse; |
| | | - Komisioni i Ankesave | Për shqyrtimin e ankesave të palëve, Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të formojë një komision ad-hoc, në përbërjen prej 3 anëtarëve, në përbërje të të cilit duhet të jenë: një përfaqësues nga departamentit ligjor, një nga divizioni i financave dhe një |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | nga fushëveprimtaria e natyrës së lëndës kultura, rinia dhe sporti.<br>-Në cilësinë e anëtarit të komisionit ad hoc të ankesave, nuk mund të jenë personat që kanë vendos në shkallën e parë.<br>- Komisioni ad-hoc do të vendos në përgjigjen në ankese në afatin brenda 30 ditëve. |
| RREGULLORE PER MENYREN DHE KUSHTET E SHFRYTEZIMIT E PALE,STRES SPORTIVE (Komuna e Kamenicës) | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15479 | - Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport | - Definon rregullat, kushtet dhe përgjegjësitë e shfrytëzimit të objekteve sportive si dhe rregullat në rastet kur propozohet vendosja e reklamave;<br>- Zgjidh ankesat në rastet kur ato paraqiten nga shfrytëzuesi i hapësirës;<br>- Vlerëson dëmet e shkaktuara nga palët e ndryshme të cilat dëmtojnë palestrën si dhe shqipton masa ndëshkuese; |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | - Shfrytëzuesi i palestrës sportive | - Institucionet shtetërore; klubet sportive; organizatat politike; organizatat jo-qeveritare; bizneset; institucionet shkollore; universitetet; institucionet ndërkombëtare dhe grupet tjera formale dhe jo-formale obligohen të tëbjnë shfrytëzimin e palestrës në përputhje me rregullat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore. |
| RREGULLORE (K.PE) 06-120235/2015 PËR SHFRYTEZIMI E OBJEKTEVE SPORTIVE (Komuna e Pejës) | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11657 | | - NUK HAPET |
| RREGULLORE (K.PE) 400-85581/2015 PËR OBJEKTE SPORTIVE NË PARKUN KARAGAQ-PEJË (Komuna e Pejës) | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11624 | - Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport | - Definon rregullat, kushtet dhe përgjegjësitë e shfrytëzimit të objekteve sportive si dhe rregullat në rastet kur propozohet vendosja e reklamave;<br>- Autoritet kompetent për menaxhimin e objekteve sportive; |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | - Shfrytëzuesi i palestrës sportive | - Institucionet shtetërore; klubet sportive; organizatat politike; organizatat jo-qeveritare; bizneset; institucionet shkollore; universitetet; institucionet ndërkombëtare dhe grupet tjera formale dhe jo-formale obligohen të bëjnë shfrytëzimin e palestrës në përputhje me rregullat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore. |
| RREGULLORE (K.OB) 151 PALESTRA SPORTIVE (Komuna e Obiliqit) | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11722 | - Kryetari i Komunës<br><br>- Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport | - Përgjegjës për aprovimin dhe implementimin e Rregullores.<br><br>- Definon rregullat, kushtet dhe përgjegjësitë e shfrytëzimit të objekteve sportive si dhe rregullat në rastet kur propozohet vendosja e reklamave;<br>- Autoritet kompetent për menaxhimin e |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | objekteve sportive; |
| | | - Shfrytëzuesi i palestrës sportive | - Institucionet shtetërore; klubet sportive; organizatat politike; organizatat jo-qeveritare; bizneset; institucionet shkollore; universitetet; institucionet ndërkombëtare dhe grupet tjera formale dhe jo-formale obligohen të bëjnë shfrytëzimin e palestrës në përputhje me rregullat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore. |
| RREGULLORE (K.GLL) 400-27845/2014 PER TARIFA DHE NGARKESA NE PALESTREN SPORTIVE NE KOMUNEN E GLLOGOCIT (Komuna e Gllogocit) | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11754 | - Komuna e Drenasit (Gllogoc) | - Autoritet kompetent për miratimin e rregullores dhe përcaktimin e tarifave për shfrytëzimin e palestrave sportive brenda territorit të komunës |
| RREGULLORE (K.KAC) NR. 02/2022 - PËR MËNYRËN DHE KUSHTET E SHFRYTËZIMIT TË PALESTRËS SPORTIVE NË KOMUNËN E KAÇANIKUT | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=60379 | - Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport | - Definon rregullat, kushtet dhe përgjegjësitë e shfrytëzimit të objekteve sportive si dhe rregullat në rastet kur |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | propozohet vendosja e reklamave;<br>- Autoritet kompetent për menaxhimin e objekteve sportive;<br>- Autoritet kompetent për krijimin e komisionit vlerësues të dëmeve; |
| | | - Shfrytëzuesi i palestrës sportive | - Institucionet shtetërore; klubet sportive; organizatat politike; organizatat jo-qeveritare; bizneset; institucionet shkollore; universitetet; institucionet ndërkombëtare dhe grupet tjera formale dhe jo-formale obligohen të bëjnë shfrytëzimin e palestrës në përputhje me rregullat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore. |
| RREGULLORE PËR MËNYRËN DHE KUSHTET E SHFRYTËZIMIT TË PALESTRËS SPORTIVE (Komuna e Kamenicës) | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=25199 | - Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport | - Definon rregullat, kushtet dhe përgjegjësitë e shfrytëzimit të objekteve sportive si dhe rregullat në rastet kur |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | propozohet vendosja e reklamave;<br>- Autoritet kompetent për menaxhimin e objekteve sportive;<br>- Autoritet kompetent për krijimin e komisionit vlerësues të dëmeve; |
| | | - Shfrytëzuesi i palestrës | - Institucionet shtetërore; klubet sportive; organizatat politike; organizatat jo-qeveritare; bizneset; institucionet shkollore; universitetet; institucionet ndërkombëtare dhe grupet tjera formale dhe jo-formale obligohen të bëjnë shfrytëzimin e palestrës në përputhje me rregullat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore. |
| RREGULLORE (K.FR)MENAXHIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E OBJKETEVE SPORTIVE (Komuna e Ferizajt) | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18033 | - Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport | - Definon rregullat, kushtet dhe përgjegjësitë e shfrytëzimit të objekteve sportive si dhe rregullat në |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | rastet kur propozohet vendosja e reklamave;<br>- Autoritet kompetent për menaxhimin e objekteve sportive;<br>- Propozon kryetarit themelimin e komisionit vlerësues të dëmeve; |
| | | - Shfrytëzuesi i palestrës | - Personat fizik dhe juridik obligohen të bëjnë shfrytëzimin e palestrës në përputhje me rregullat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore. |
| RREGULLORE PËR MËNYRËN DHE KUSHTET E SHFRYTEZIMIT TË PALESTRES SË SPORTEVE "MIZAHIR ISMA" NË RAHOVEC (Komuna e Rahovecit) | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=27509 | - Drejtoria pëe Kulturë, Rini dhe Sport | - Definon rregullat, kushtet dhe përgjegjësitë e shfrytëzimit të objekteve sportive si dhe rregullat në rastet kur propozohet vendosja e reklamave;<br>- Autoritet kompetent për menaxhimin e objekteve sportive;<br>- Autoritet kompetent për krijimin e |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | komisionit vlerësues të dëmeve; |
| | | - Shfrytëzues i palestrës | - Institucionet shtetërore; klubet sportive; organizatat politike; organizatat jo-qeveritare; bizneset; institucionet shkollore; universitetet; institucionet ndërkombëtare dhe grupet tjera formale dhe jo-formale obligohen të bëjnë shfrytëzimin e palestrës në përputhje me rregullat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore. |
| RREGULLORE (K.GJ) 01.nr.7834 PËR MËNYRËN DHE KUSHTET E SHFRYTËZIMIT TË PALESTRËS SË SPORTEVE (Komuna e Gjilanit) | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12118 | - Departamenti për Kulturë, Rini dhe Sport | - Definon rregullat, kushtet dhe përgjegjësitë e shfrytëzimit të objekteve sportive si dhe rregullat në rastet kur propozohet vendosja e reklamave;<br>- Autoritet kompetent për menaxhimin e objekteve sportive;<br>- Autoritet kompetent për |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | krijimin e komisionit vlerësues të dëmeve;<br><br>- Klubet e regjistruara në DKRS she subjektet tjera të interesuara të përcaktuara në Rregullore obligohen të bëjnë shfrytëzimin e palestrës në përputhje me rregullat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore. |

Krahas ligjeve të paraqitura në figurën e mësipërme, ekzistojnë edhe akte tjera nënligjore që lidhen me këtë fushë.

Ligji ekzistues për sportin përcakton që Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka përgjegjësinë të zhvillojë dhe definoj politikën e përgjithshme në sektorin e sportit, si dhe të krijojë infrastrukturën sportive. Ministria është gjithashtu përgjegjëse për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për dhënien e licencave për federatat e sportit. Për sa i përket monitorimit të ligjit, sipas nenit 50 të ligjit për sportin, Ministria duhet të monitorojë përdorimin e mjeteve publike duke përfshirë menaxhimin dhe përdorimin e objekteve sportive publike, përmbushjen e standardeve dhe parimeve të zbatimit të programeve në nivel vendi, përmbushjen e kërkesave për organizimin e garave sportive ndërkombëtare, përmbushjen e kërkesave të standardeve për kontrollin mjekësor të përkohshëm dhe periodik si dhe monitorimin nëse të drejtat e sportistëve abuzohen apo shkelen.

Në nivel vendi, të drejtat dhe përgjegjësitë e Departamentit të Sportit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit konsistojnë në zhvillimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve të politikave sportive, si dhe hartimin e legjislacionit primar dhe sekondar për sektorin e sportit në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin Ligjor dhe Departamentet tjera përkatëse në Ministri. Përveç kësaj, Departamenti i Sportit është përgjegjës për monitorimin e infrastrukturës sportive si dhe promovimin e aktiviteteve sportive në të gjithë vendin.

Departamenti i Sportit në kuadër të Ministrisë ka tre divizione:

1. Divizioni për Komitetin Olimpik, Komitetin Paralimpik dhe federatat e sportit;

2. Divizioni i Infrastrukturës Sportive, dhe
3. Divizioni për Sporti për të gjithë dhe Sporti Shkollor.

Në nivel lokal, sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, komunat kanë Drejtoritë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit apo drejtorinë përkatëse të arsimit që mbulon fushën e sportit që janë përgjegjëse për krijimin dhe monitorimin e politikave brenda territorit të tyre, regjistrimin e klubeve, mbajtjen e të dhënave të klubeve, ofrimin e mbështetjes financiare, udhëheqjen dhe mirëmbajtjen e objekteve dhe resurseve sportive lokale, organizimin e tryezave të rrumbullakëta me partnerë dhe palë të ndryshme të interesuara, duke udhëhequr sektorin e sportit në nivel komunal, si dhe duke bashkëpunuar ngushtë me klubet sportive, Federatat dhe me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Komiteti Olimpik i Kosovës funksionon sipas ligjit ekzistues për sportin dhe sipas parimeve dhe vlerave themelore të Olimpizmit në Kosovë. Promovon sportin dhe arsimin, duke përfshirë edukimin në vlerat olimpike në të gjitha nivelet. Anëtarë të KOK-ut janë federatat vendore.

Në vitin 2019, ligji i ndryshuar dhe plotësuar ka njohur Komitetin Paralimpik të Kosovës (në tekstin e mëtejmë "KPK"). Megjithatë, ligji në fuqi është i mangët dhe nuk specifikon nëse KPK vepron në mënyrë të pavarur nga Ministria dhe organizatat e tjera sportive. Roli dhe përgjegjësitë e KPK-së nuk janë të përcaktuara në legjislacionin ekzistues. Ndërsa, federatat e sporteve të personave me nevoja të veçanta, si dhe federatat e sporteve të personave të shurdhër, janë pjesë e Komitetit Paralimpik të Kosovës.

Me ndryshimet dhe plotësimet e ligjit në vitin 2019, po ashtu është përcaktuar funksionimi i Këshillit të Arbitrazhit Sportiv (KAS) dhe Gjykata e Arbitrazhit Sportiv në kuadër të Komitetit Olimpik të Kosovës si organ institucional i pavarur për arbitrazhin në sport për zgjidhjen e kontesteve lidhur me sportin..

Edhe pse ligji thotë se KAS-i duhet të jetë i pavarur, dispozitat ligjore të përcaktuara në ligjin për sportin nuk janë të plota për të siguruar pavarësinë e plotë të KAS-it. Kjo i referohet aspektit financiar, operacional dhe funksionimit të KAS-it.

Krahas institucioneve të lartpërmendura, tre mekanizma kryesorë që luajnë një rol të rëndësishëm në sektorin e sportit janë si më poshtë:

1. Këshilli Kombëtar për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive i cili është organ i përhershëm me përfaqësim ndërinstitucional dhe përbëhet nga pesë anëtarë. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Këshillit konsistojnë në: parandalimin e dhunës dhe dukurive të tjera negative në ngjarjet sportive; sanksionimin e dhunës dhe dukurive të tjera negative në ngjarje sportive; pjesëmarrjen dhe dhënien e rekomandimeve për projektligjet dhe politikat që lidhen me dhunën; ndjekjen me kujdes të ngjarjeve sportive në rastet e vlerësuara me rrëzik etj.
2. Mekanizmi i aktorëve të sportit/Tryeza e Sportit – është mekanizëm i themeluar rishtazi nga MKRS i cili siguron një komunikim të rregullt të të gjitha palëve të përfshira sikurse: përfaqësues nga institucionet publike, akterë të sportit sikurse: federatat, sportistët, gazetarët sportiv dhe OJQ-ve të ndryshme. Ky mekanizëm përveç sigurimit të komunikimit të rregullt, ofron mundësi të mirë për të përmirësuar hartimin e politikave dhe legjislacionit në sektorin e sportit.
3. Grupi Konsultativ i Sportit– është organ i përbërë nga përfaqësues të ndryshëm kryesisht nga komuniteti sportiv që shërben për të dhënë këshilla dhe për të lehtësuar bashkëpunimin ndërmjet Ministrisë me komunitetin sportiv dhe mbështet përcaktimin e orientimit strategjik të masave zbatuese për të siguruar zbatimin efikas të prioriteteve të qeverisë në sektorin e sportit.

Kapitulli 1.2. Përcaktimi i problemit, shkaqet dhe pasojat

Për të kuptuar më mënyrë më specifike problemin aktual në fushën e sportit, ky Koncept Dokument paraqet dhe shtjellon pemën e problemit në vijim.

*Figura 3: Pema e problemit, që paraqet problemin kryesor, shkaqet dhe efektet e tij*

| | |
|---|---|
| **Efektet** | Qeverisja dhe integriteti i sportit mbetet një sfidë që vazhdon të cenoj të drejtat e qytetarëve në aktivitete fizike dhe atë të sportit |
| | Dimensioni socio-ekonomik i sportit nuk është fokusi kryesor |
| | Pjesëmarrja qytetare në sport dhe aktivitetet fizike mbetet në nivel të ulët |
| **Problem i kryesor** | Struktura e sportit nuk i përshtatet qëllimit dhe nevojave të kohës |
| **Shkaqet** | Mungesa e politikave dhe strategjive të qarta |
| | Rregullat janë të mangëta |
| | Kapacitete të kufizuara njerëzore |
| | Infrastruktura fizike sportive jo adekuate |

Në përputhje me figurën 3 të këtij Koncept Dokumenti, struktura e sportit e cila nuk i përshtatet qëllimit dhe nevojave të kohës është problemi kryesor.

Disa nga shkaqet që kontribuojnë në problemin e identifikuar grupohen si më poshtë: a) mungesa e politikave dhe strategjive të qarta; b) rregullat janë të mangëta; d) kapacitete të limituara njerëzore; dhe e) infrastruktura fizike sportive jo adekuate.

a) Mungesa e politikave dhe strategjive të qarta

Qeveria e Kosovës ka bërë progres të dukshëm duke pasur parasysh se Draft Strategjia e Zhvillimit Kombëtar e cila është në hartim e sipër, parasheh sektorin e sportit në kuadër të shtyllës së zhvillimit të barabartë njerëzor. Draft Strategjia synon të plotësojë dhe adresojë objektivat e përcaktuara në Programin e Qeverisë (2021-2025). Për më tepër, ajo shkon përtej detyrimeve të parapara në Programin e Qeverisë, pasur paraysh se e njejta do të mbuloj një periudhë dhjetëvjeçare. Ajo synon përmirësimin e fushës së kulturës dhe sportit në komunitet, rritjen e kapaciteteve njerëzore në sport dhe kulturë si dhe përmirësimin e infrastrukturës. Procesi i hartimit dhe miratimit të Strategjisë mund të marrë kohë për t'u përfunduar për shkak të kompleksitetit të sektorit.

Megjithatë, gjendja ekzistuese tregon se në sektorin e sportit është vetëm seksioni 2.16 i Programit të Qeverisë (2021-2025) që adreson cështje të sportit dhe nuk ka asnjë dokument strategjik të aprovuar për të vendosur politika dhe strategji të qarta për sektorin në nivel vendi ose atë të komunave.

Si rrjedhojë, në mungesë të politikave dhe strategjive të qarta, Departamenti i Sportit i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka zhvilluar disa politika programore në pesë vitet e fundit si p.sh.:

- Politika programore për rritjen e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të sportit të vajzave dhe grave;
- Politika programore për mjekësinë sportive;
- Politika programore për promovimin e sporteve cilësore;

- o Politika programore për zhvillimin e aktiviteteve sportive me karakter ndërkombëtar jashtë vendit;
- o Politika programore për zhvillimin e aktiviteteve sportive me karakter ndërkombëtar brenda vendit;
- o Politika programore për zhvillimin e aktiviteteve sportive për pakicat dhe sportet multietnike;
- o Politika programore për infrastrukturën sportive dhe pajisjet sportive;
- o Politika programore për zhvillimin e aktiviteteve sportive për personat me aftësi të kufizuara;
- o Politika programore për zhvillimin e kapaciteteve menaxhuese në Komitetin Olimpik të Kosovës dhe Federatat e Sporteve;
- o Politika programore për zhvillimin e aktiviteteve sportive shkollore dhe universitare.

Në mungesë të një strategjie të nivelit shtetëror për sportin, Departamenti i Sportit në ministri, ka zhvilluar programet e sipërpërmendura në baza vjetore të cilat janë konsideruar si dokumente të punës të Ministrisë. Megjithatë, hartimi i këtyre dokumenteve është bërë pa një planifikim të duhur dhe konsultime me palët e përfshira në proces. Politikat programore të lartpërmendura janë hartuar në baza vjetore nga viti 2003 deri në vitin 2017 dhe procesi i hartimit të tyre është parë më shumë si një aktivitet ad-hoc sesa si një orientim i qartë për ndërhyrjet e nevojshme në këtë sektor.

*Figura 4: Financimi i sportit nga buxheti i Republikës së Kosovës 2017-2021*

| | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 |
|---|---|---|---|---|---|
| Kosovo State Budget Total Expenses | 1.837.191.000 € | 1.979.737.000 € | 2.152.546.000 € | 2.334.943.000 € | 2.378.740.000 € |
| **Kosovo State Budget for Sport** | **15.193.895 €** | **18.081.029 €** | **19.675.067 €** | **15.049.838 €** | **17.685.371 €** |
| *MCYS (Sport only)* | *9.949.873 €* | *14.335.288 €* | *14.276.625 €* | *9.947.814 €* | *13.000.599 €* |
| *Subsidies* | *3.347.220 €* | *3.593.559 €* | *4.253.784 €* | *4.142.492 €* | *6.375.674 €* |
| *Sport Infrastructure* | *6.419.978 €* | *10.538.260 €* | *9.801.559 €* | *5.571.976 €* | *6.384.227 €* |
| *Other[1]* | *182.674 €* | *203.470 €* | *221.283 €* | *233.346 €* | *240.697 €* |
| *Municipalities/ from State Budget* | *5.244.022 €* | *3.745.740 €* | *5.398.441 €* | *5.102.024 €* | *4.684.773 €* |
| *Sport Infrastructure* | *5.244.022 €* | *3.745.740 €* | *5.398.441 €* | *5.102.024 €* | *4.684.773 €* |
| % for Sport in Kosovo State Budget Total Expenses | 0,8% | 0,9% | 0,9% | 0,6% | 0,7% |

Sikurse mund të shihet nga figura më sipër, buxheti i planifikuar në pesë vitet e fundit, arrin vlerën prej 85.6851661 si në vijim:

- o 15.193.895 euro për vitin 2017;
- o 18.081.029 euro për vitin 2018;
- o 19.675.067 euro për vitin 2019;
- o 15.049.838 euro për vitin 2020;
- o 17.685.371 euro për vitin 2021.[3]

Pra sic mund të shihet nga figura më sipër, ndarja e buxhetit nga shteti mund të ndahen në katër kategori si në vijim:

1. Subvencionimi i drejtpërdrejtë – mjetet e destinuara për funksionimin dhe zhvillimin e organizatave të sportit sikurse: Komiteti Olimpik, Komiteti Paralimpik, Federatat e Sportit, Klubeve, sportistëve si dhe sistemit të sportit në tërësi;
2. Subvencionimi indirekt përmes sponsorizimit – të mbështetja financiaree ofruar nga shteti përmes Ligjit për Sponsorizim në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
3. Infrastruktura sportive – mjetet financiare të destinuara për ndërtimin, rinovimin, zgjerimin, rregullimin e infrastrukturës sportive dhe paisjeve përcjellëse;

[3] Të dhënat të cilat janë përdorur edhe nga grupi punues për hartimin e Strategjisë së Sportit.

4. Të tjera – mjetet financiare të destinuara për shpenzimet e MKRS-së si paga dhe meditje si dhe shërbime të cilat kanë të bëjnë me sistemin e sportit dhe rolin të cilin e ka Ministria.

Ky buxhet ishte i dedikuar për sektorin e sportit. Për shkak të mungesës së një strategjie, alokimi i fondeve kryesisht është bërë pa përcaktuar masat e duhura prioritare për intervenime.

*Figura 5. Të dhënat paraqesin vlerën e përgjithshme të buxhetit të planifikuar dhe atij të shpenzuar në infrastrukturë fizike sportive*

**Planifikimi fillestar i buxhetit per infrastructure sportive**
**2017-2021**
**77,7 milion €**
**(38,7 mil € te shpenzuara)**

Të dhënat e prezantuara në figurën 5 më sipër, janë indikator i planifikimit jo të mirë të buxhetit pasi që vetëm 38.7 milion janë shpenzuar nga buxheti i planifikuar i cili kap vlerën prej 77.7 milion. Po ashtu, shpenzimi i këtij buxheti të dedikuar për infrastrukturën fizike sportive, nuk ka prodhuar rezultatet e dëshiruara.

Nga diskutimet me palët e përfshira në proces, sikurse drejtoritë përkatëse brenda komunave, federatat, klubet sportive, vlerësojnë se në Kosovë ekziston mungesë e infrastrukturës sportive si dhe infrastruktura ekzistuese në masë të madhe nuk i plotëson standardet e kërkuara nga federatat ndërkombëtare ku ato bëjnë pjesë.

Duke marrë parasysh strukturën e sistemit aktual të shpenzimit të buxhetit i cili nuk bënë ndarjen e përfituesve në baza gjinore apo etnike për sa i përket realizimit të investimeve në infrastrukturën e sportit, grupi punues për hartimin e Koncept Dokumentit e ka pasur të vështirë të identifikoj përfituesit fundor të këtyre investimeve në baza gjinore apo etnike. Megjithatë, përfitues të këtyre investimeve janë i gjithë komuniteti sportiv pa dallim.

Figura 4 më sipër ofron një të dhënë të rëndësishme nga ku shihet se pjesa më e madhe buxhetit e dedikuar për sport vie nga niveli qendror respektivisht Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përderisa komunat në përgjithësi kanë ndarë buxhet tejet të limituar të përcaktuar për sektorin e sportit ndër vite.

Një sfidë e shfrytëzimit të buxhetit është identifikuar ku buxheti i ndarë për komunat përfundon në një kod buxhetor ku në nivel të komunës ky kod përfshinë: kulturën, rininë dhe sportin. Në këtë drejtim, buxheti i ndarë për sportin pengohet nga fusha e kulturës apo rinisë të cilat njëra tjetrën e pengojnë pasi që buxheti për sport mbetet tejet i limituar.

Zhvillimet e fundit ndërkombëtare të renditura në seksionin b) janë gjithashtu të lidhura me seksionin a).

b) Rregullat janë të mangëta

Rregullat janë të mangëta dhe të ndryshme për nga natyra.

Shkaku kryesor i problemit lidhet po ashtu me ndryshimet në kuadrin ligjor dhe rregullativ ndërkombëtar të aplikueshëm për sportin, të kombinuara me sfidat e reja shoqërore dhe dështimin e ligjit të sportit të Kosovës për të qenë në hap me ndryshimet në nivelin vendor dhe atë ndërkombëtar.

Përkundër që sporti ka qenë prioritet me cka edhe është miratuar Ligji nr. 2003/24 për Sportin nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2003, duhet pasur parasysh se miratimi i tij është bërë në periudhën kohore kur Kosova doli nga lufta dhe në atë kohë ishte në fazën fillestare të krijimit të legjislacionit ku mundësitë buxhetore ishin të limituara. Nga shpallja e pavarësisë e tutje, institucione të reja u krijuan me cka u ndryshuan gjithashtu komptencat, detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve të nivelit qendror kryesisht por edhe atij lokal. Edhe pse ky ligj, pësoi ndryshime gjatë periudhave të ndryshme kohore *(në vitin 2012 dhe në vitin 2019),* përkundër këtyre ndryshimeve korniza ligjore ekzistuese për sportin nuk ka adresuar zhvillimet e fundit në sektorin e sportit.

Rregullat jo të plota në kombinim me boshllëqet ligjore dhe dispozitat e vjetruara vazhdojnë të përkeqësojnë strukturën e sportit në vend.

Ligji nuk ka përcaktime të qarta të përgjegjësive dhe të drejtave të të gjitha institucioneve/organizatave përgjegjëse në sektorin e sportit për zbatimin dhe monitorimin efikas të sistemit. Edhe pse neni 50 i ligjit për sport ofron një përcaktim ligjor të mbikëqyrjes, këtë kompetencë pastaj e delegon tek komisioni përkatës profesional i cili emërohet nga Ministria. Në asnjë dispozitë ligjore, nuk përcaktohet mënyra e themelimit të komisionit baza ligjore për nxjerrjen e rregullave të punës apo mënyra e monitorimit të zbatimit si dhe aspekte tjera me rëndësi. Mungesa e mekanizmave përgjegjës për monitorim dhe zbatim e vështirëson tej mase zbatimin e ligjit në tërësi, në veçanti kur kemi parasysh faktin se sektori i sportit është ndër-sektorial dhe në vetvete përfshinë institucionet e nivelit qendror, komunat, federatat dhe organizatat sportive si dhe klubet.

Mungesa e mekanizmave për monitorimin e zbatimit të ligjit, përbën shqetësim për Ministrinë dhe të gjitha institucionet e përfshira në sektorin e sportit, prandaj korniza ligjore konsiderohet e mangët në këtë kontekst.

Gjithashtu, korniza ligjore ekzistuese nuk parashikon bazën ligjore për krijimin e mekanizmave të rinj apo organizatave ombrellë për të përmbushur funksionet e nevojshme për aktivitetet sportive.

Ligji nuk ofron përkufizime të mjaftueshme për konceptet e sportit dhe përkufizime të rëndësishme për të krijuar qartësi dhe si i tillë për nga këndvështrimi i institucioneve tjera publike, ligji më tepër konsiderohet se duhet të zbatohet vetëm nga sektori i ngushtë i sportit pa një gjithëpërfshirje të të gjitha institucioneve dhe organizatave. Deri më tani, përfshirja e institucioneve tjera në këtë sektor mbetet në nivel të ulët në mungesë të qasjes ndër-sektoriale dhe gjithëpërfshirjes. I njejti, nuk është në harmoni me standardet e hartimit të akteve normative në fuqi të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ të Qeverisë për hartimin e akteve normative.

Ligji nuk është konsistent, i qartë dhe i thjeshtë kur bëhet fjalë për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e sektorit të sportit, qoftë në monitorimin e hartimit të politikave dhe ligjeve, qoftë në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e menaxhimit të infrastrukturës fizike sportive. Përkundër që në ligj është përcaktuar se Departamenti i Sportit bënë monitorimin, ndërkohë, parashikohet themelimi i komisionit profesional për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit të përcaktuar në nenin 50 paragrafi 2 dhe 3. Ky rregullim ligjor, ku

monitorimi i lihet si kompetencë një komisioni profesional mbetet i paqartë pas shumë vitesh së zbatimit të ligjit për sport.

Po ashtu, ka akte nënligjore të nxjerra nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në zbatim të ligjit për sport të cilat nuk kanë ndonjë bazë specifike në ligj për nxjerrjen e tyre. Pra, ligji aktual, duhet të ndryshoj për të adresuar cështjet e sipër-përmendura si dhe për të krijuar bazën ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të ligjit.

Çështja e infrastrukturës sportive sipërfaqësisht përmendet në ligj dhe këtë kompetence i'a atribuon ministrisë, por nuk bënë ndonjë sqarim të mëtejmë për sa i përket standardeve të infrastrukturës sportive, kategorizimit të tyre dhe planifikimit të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës sportive.

Një numër i komunave, kanë nxjerrë rregulloret e tyre për menaxhimin e palestrave sportive dhe përcaktimin e tarifave për shfrytëzimin e tyre duke u bazuar në statutet e tyre dhe në ligjin për vetëqeverisje lokale, por të njejtat nuk kanë ndonjë lidhshmëri me ligjin e sportit si dhe nuk përcaktojnë në mënyrë të detajuar menaxhimin e tyre.

Nga takimet dhe tryezat e organizuara gjatë vitit 2022 si dhe nga të konsultimet me palët e përfshira në proces, cështja e menaxhimit të infrastrukturës është potencuar si mangësi kryesisht për arsyet e mungesës së bazës së qartë ligjore dhe mungesës së mekanizmave të monitorimit dhe zbatimit përfshirë mekanizmat e ekzekutimit të ligjit. Në këtë kontekst, palët e përfshira në proces kanë potencuar faktin që shfrytëzimi i palestrave sportive nuk bëhet në mënyrë racionale për të ofruar mundësi që një palestër të shfrytëzohet nga klube sportive të disiplinave të ndryshme sportive apo qoftë edhe brenda disiplinës së njëjtë duke ofruar mundësi dhe qasje të barabartë për të gjithë.

Po ashtu, ligji nuk bën ndërlidhje të mirë me institucionet tjera të nivelit qëndror sikurse me ministrinë përkatëse për arsim, punë të brendshme, planifikim urban, pushtet lokal, shëndetësi si dhe me institucione tjera të përfshira sikurse: Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive, Agjencia Anti-doping dhe autoritetet përkatëse të cilat duhet të bëjnë vlerësimin e standardeve të hapësirave sportive në shkolla dhe universitete etj.

Ligji i sportit bënë referime të përgjithshme të parimeve të Kartës Olimpike dhe Kartës Evropiane të Sportit, megjithatë kuadri ligjor ekzistues është i mangët kur bëhet fjalë përfshirjen e parimeve të qeverisjes së mirë, kodeve të etikës, promovimin e integritetit, mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve, qendërsimin gjinor në sport, etj.[4] dhe standardeve të tjera themelore në kuadrin ligjor të vendit.

Për sa i përket regjistrimit dhe licencimit të federatave sportive, ligji aktual ka dispozita të mangëta të cilat paraqesin vështirësi në zbatim.

Sipas kornizës ligjore në fuqi, federatat e sportit dhe klubet e sportit regjistrohen në përputhje me procedurat e përcaktuara në Ligjin për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare dhe sipas procedurave të përcaktuara në Ligjin për Sportin.

Një federatë e sportit themelohet dhe licencohet me qëllim të organizimit, zhvillimit dhe udhëheqjes së sportit në degë të caktuara sportive, në gjithë territorin e Kosovës. Klubet e sportit të regjistruara sipas dispozitave të ligjeve të lartpërmendura, ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e sportit.

---

[4]Recommendation CM/Rec(2021)5 of the Committee of Ministers to member States on the Revised European Sports Charter (Adopted by the Committee of Ministers on 13 October 2021 at the 1414 th meeting of the Ministers' Deputies). https://rm.coe.int/recommendation-cm-rec-2021-5-on-the-revision-of-the-european-sport-cha/1680a43914

Ligji për Sportin nuk përcakton kriteret bazë për themelimin dhe funksionimin e federatave dhe klubeve sportive. Në vend të kësaj, neni 31 i ligjit u jep autoritet organeve profesionale të autorizuara nga Ministria për të përcaktuar kërkesat dhe procedurat për dhënien e licencës.[5] Kjo dispozitë nuk është në përputhje me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative pasi kriteret kryesore për kryerjen e veprimtarisë duhet të përcaktohen me ligj. Ndërsa, procedurat dhe aspektet e tjera teknike mund të rregullohen më tej me akte nënligjore.

Megjithatë, Ministria në përputhje me nenin 31 të ligjit ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ nr. 01/2022 për kushtet, kriteret dhe procedurat për themelimin, licencimin dhe rivlerësimin e federatave dhe organizatave sportive.

Udhëzimi Administrativ parasheh kushte të përgjithshme dhe kushte specifike për federatat dhe organizatat sportive.

- Janë 5 kushte të përgjithshme dhe 6 kushte specifike që duhet të përmbushen sipas nenit 10 dhe nenit 11 të UA 01/2022.

Federatat, fillimisht regjistrohen në Ministrinë përgjegjëse për regjistrimin e OJQ-ve sipas procedurave të definuara në ligjin për lirinë e asociimit në OJQ dhe pastaj aplikojnë për licencim në Ministrinë përkatëse të Sportit sipas procedurave të përcaktuara në Ligjin për Sport dhe aktet nënligjore.

Përderisa, klubet sportive gjithashtu regjistrohen fillimisht në Ministrinë përgjegjëse për regjistrimin e OJQ-ve dhe pastaj aplikojnë në komunën përkatëse sipas procedurave të përcaktuara në Ligjin për Sport dhe aktet nënligjore, ndërsa klubet e sportit e kanë po ashtu mundësinë të regjistrohen si biznese në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve sipas ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Kushtet dhe kriteret për regjistrim të federatave si dhe klubeve sipas ligjit për lirinë e asociimit në OJQ janë kushte të karakterit administrativ, përderisa ligji për sport ka kushte dhe kritere të karakterit profesional për të mundësuar ushtrimin e veprimtarisë sportive, sikurse sigurimi i hapësirës, organizimi paraprak i garave, struktura qeverisëse e federatave dhe klubeve.

Vështirësi tjetër e cila haset gjatë zbatimit në praktikë, ka të bëjë me thirrjet publike për subvencionimin apo grantet nga Ministria, ku procedurat e ekzistuese konsiderohen se nuk parandalojnë mbështetjen e dyfisht për qëllimin e njëjtë të një organizate si dhe mungesa e një sistemi të të dhënave dhe bashkëpunimi në nivel jo të duhur ndërmjet institucioneve publike sikurse: MKRS; MPB; ATK; Komunë, paraqet vështirësi në zbatim.

Nga ana tjetër, Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht neni 34 dhe neni 35 i ligjit, bënë thirrje për ndihmë administrative ndërmjet institucioneve publike, që drejton në faktin se dokumentet që mbahen nga institucionet publike nuk duhet të kërkohen nga aplikuesi. Prandaj, procedurat administrative të tepërta krijohen kryesisht për shkak të mungesës së qasjes në platformat digjitale ose nga mos aplikimi i platformave ekzistuese sikurse e-Kosova apo platformës që mbahet nga Departamenti i OJQ-ve, duke krijuar kështu vështirësi për federatat e sportit dhe klubet e sportit. Këto procedura ndikojnë negativisht jo vetëm te organizatat e sportit, por ndikojnë edhe në uljen e përkrahjes përmes sponsorizimit si dhe mund potencialisht të dekurajojnë bizneset që të japin fonde për federatat dhe klubet e sportit.

Pra, marrë parasysh të gjithë këto që u theksuan më sipër, në lidhje me rregullat e mangëta, një sistem i ri i sportit për Kosovën duhet të përcaktojë rrugën drejt harmonizimit të mëtejshëm të legjislacionit vendor me legjislacionin ndërkombëtar në sektorin e sportit. Në mungesë të reformave, Kosova rrezikon të mos jetë

[5] Neni 31, paragrafi 31.2 i ligjit të sportit nr. 2003/24

në përputhje me standardet mbizotëruese ndërkombëtare dhe të mos jetë në hap me sistemet moderne sportive në mbarë Evropën. Kjo do të dëmtonte marrëdhëniet ekzistuese me organet ndërkombëtare sportive dhe organizatat ndërkombëtare, dhe do të frenonte përpjekjet për njohje më të gjerë ndërkombëtare dhe anëtarësim në organizata ndërkombëtare. Në fund të fundit, mospërmirësimi i sistemit të sportit, do të dëmtojë imazhin e Kosovës jashtë vendit dhe Kosova mund të humbasë mundësitë që ofron sporti për të kontribuar në objektiva më të gjera sociale, ekonomike dhe politike.

Nisur nga ky këndvështrim, kuadri ndërkombëtar në sektorin e sportit inkurajon shtetet respektive të kontribuojnë në promovimin e çështjeve sportive duke marrë parasysh natyrën specifike të sportit.

Në këtë drejtim, disa nga institucionet kryesore ndërkombëtare që lidhen me sektorin e sportit janë renditur dhe përmbledhur si më poshtë:

*Bashkimi Evropian (BE)*

Në vitin 2009, BE-ja ndryshoi Traktatet e saj dhe futi nenet 6 dhe 165 në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE). Neni 165 i jep BE-së një kompetencë në fushën e sportit. Megjithatë, roli i tij është i kufizuar në 'mbështetje, bashkërendim ose plotësim të veprimeve të Shteteve Anëtare'. Kjo do të thotë se BE-ja nuk ka fuqi të harmonizojë ligjet dhe rregulloret e Shteteve Anëtare edhe pse neni 165(1) i bën një ftesë BE-së për të 'kontribuar në promovimin e çështjeve sportive evropiane duke marrë parasysh natyrën specifike të sportit'.

Që nga vendimi i Gjykatës Evropiane në *Walrave*, ligji i BE-së është zbatuar në aspektet ekonomike të sportit.[6] Kjo u konfirmua në rastin *Bosman* në të cilën Gjykata vendosi se disa rregullore të futbollit nuk ishin në harmoni me legjislacionin[4] e BE-së për lëvizjen e lirë të punëtorëve dhe në *Meca-Medina* në të cilën Gjykata konfirmoi se ligji i konkurrencës i BE-së zbatohet gjithashtu për rregullat dhe praktikat sportive.[5] Në vitet e fundit, Gjykata ka zbatuar gjithashtu ligjin e BE-së për aspektet joekonomike të sportit që do të thotë se ndikimi i BE-së në qeverisjen e sportit është shumë i gjerë.[6]

BE-ja është një burim i rëndësishëm i standardeve ndërkombëtare të zbatueshme për sportin. Për shembull, dokumenti i Komisionit Evropian i vitit 2011, "Zhvillimi i Dimensionit Evropian në Sport" përcakton se qeverisja e mirë në sport është një kusht për autonominë dhe vetërregullimin e organizatave sportive dhe se ka parime të ndërlidhura që mbështesin qeverisjen e sportit në nivel evropian, si autonomia brenda kufijve të ligjit, demokracia, transparenca dhe llogaridhënia në vendimmarrje dhe gjithëpërfshirja në përfaqësimin e palëve të interesuara.[7]

Ekzistenca e nenit 165 pasqyron gjithashtu pikëpamjen se sporti është i natyrës ndër-sektoriale dhe mund të kontribuojë në arritjen e prioriteteve të BE-së në një sërë fushash duke përfshirë arsimin, shëndetin, të rinjtë, çështjet sociale, përfshirjen, mjedisin, zhvillimin ekonomik, punësimin dhe marrëdhëniet e jashtme.

---

[6] Case 36/74, *Walrave and Koch*, EU:C:1974:140.

[4] Case C-415/93, Union Royale Belge Sociétés de Football Association and others v. Bosman and others, EU:C:1995:463.

[5] Case C-519/04 P, Meca-Medina and Macjen v. Commission, EU:C:2006:492.

[6] Case C-22/18, TopFit e.V. and Daniele Biffi v Deutscher Leichtathletikverband e.V. [2019], EU:C:2019:497.

[7] European Commission, Developing the European Dimension in Sport, 11 COM92011) 12 final (2011), s.4.1

[8] Resolution of the Council and of the Representatives of the Governments of the Member States meeting within the Council on the European Union Work Plan for Sport (1 January 2021-30 June 2024) 2020/C 419/01.

[9] Case C-49/07 Motosykletistiki Omospondia Ellados NPID (MOTOE) v. Elliniko Dimosio [2008] ECR I-4863 and Case T-93/18, International Skating Union v European Commission

Prioritetet aktuale të BE-së në sport janë mbrojtja e integritetit dhe vlerave në sport; dimensionet socio-ekonomike dhe mjedisore të sportit; dhe promovimi i pjesëmarrjes në sport dhe aktivitetet fizike që përmirësojnë shëndetin.

BE-ja mund të financojë aktivitete në lidhje me sportin përmes programit Erasmus+ por mekanizmat vendor të sportit në Kosovë, duhet të shfrytëzojnë këto mundësi të cilat ofrohen nga BE-ja.

*Këshilli i Evropës (KiE)*

Përveç BE-së, KiE është një burim i rëndësishëm i standardeve ndërkombëtare të zbatueshme për sportin. Në fillim të vitit 2022, KiE vendosi prioritetet e saj në fushën e sportit për periudhën 2022-2025. Tre prioritetet e reja janë (1) të drejtat e njeriut (2) promovimi i sportit udhëhequr me vlera dhe (3) roli i KiE si partner në adresimin e sfidave evropiane dhe globale në sport. Në dispozicion, për të përparuar këto prioritete, KiE përdor një sërë burimesh duke përfshirë Kartën Evropiane të Sportit, Konventat e saj tematike dhe Marrëveshjen e Pjesshme të Zgjeruar për Sportin (EPAS).

EPAS është një forum për bashkëpunimin ndërqeveritar sportiv dhe dialogun ndërmjet autoriteteve publike, federatave sportive dhe OJQ-ve, i krijuar për të zhvilluar politika dhe standarde për të promovuar sportin në shtetet anëtare. EPAS luan rolin në avancimin e standardeve më të larta të qeverisjes së mirë në sport përmes zbatimit të parimeve kryesore të transparencës, integritetit, demokracisë dhe solidaritetit, të kanalizuara përmes Kartës Evropiane të Sportit.

Konventa për Manipulimin e Garave Sportive (Konventa Macolin) u miratua nga KiE në vitin 2019 si përgjigje ndaj një numri në rritje të rasteve të 'kurdisjeve të rezultateve' dhe formave të tjera të manipulimit në sport. Ai kërkon nga autoritetet publike që të bashkëpunojnë me organizatat sportive, operatorët e basteve dhe organizatorët e garave për të parandaluar, zbuluar dhe sanksionuar manipulimin e garave sportive.

KiE ka një interes të gjatë për të luftuar trazirat e tifozërisë dhe për të garantuar sigurinë e tifozëve në ngjarjet sportive.

Mbrojtja dhe siguria e fëmijëve në sport është gjithashtu një shqetësim i KiE. KiE pranon se ndonëse fëmijët përfitojnë shumë nga pjesëmarrja në sport, rreziqet janë të pranishme, si abuzimi. Në vitin 2015, KiE publikoi rekomandime për parandalimin dhe në vitin 2016 rekomandimet për qeverisjen e mirë për mbrojtjen e sportistëve të rinj dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në sport. Këto bazohen në ndërhyrje më të përgjithshme si Konventa për Mbrojtjen e Fëmijëve Kundër Shfrytëzimit Seksual dhe Abuzimit Seksual (2007) dhe Konventa për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (2011).

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore është Konventa e cila është drejtpërdrejtë e aplikueshme në Kosovë edhe pse nuk i drejtohet posaçërisht sportit, dispozitat e saj janë gjithnjë e më me ndikim në vendosjen e standardeve të zbatueshme për sportin.

*Agjencia Botërore Anti-Doping (WADA-ABAD)*

Konventa Ndërkombëtare e UNESCO-s kundër Anti-Dopingut është krijuar gjithashtu për të mbështetur Kodin Botëror Anti-Doping, i cili hyri në fuqi në vitin 2004 dhe i cili është ndryshuar më pas në një numër rastesh, më së fundi në vitin 2021. Kodi është produkt i WADA. E themeluar në vitin 1999, WADA vendos standardet ndërkombëtare që udhëheqin fushatën kundër dopingut në sport. Kodi synon të harmonizojë politikat, rregullat dhe rregulloret anti-doping brenda organeve sportive dhe tek autoriteteve publike. Mbi 700 organe sportive janë nënshkruese të Kodit. Kjo i vendos ata nën detyrimin për të pranuar, zbatuar dhe

zbatuar parimet e Kodit. Qeveria e Republikës së Kosovës, rishtazi ka miratuar projektligjin për agjencinë anti-doping i cili është në proces të shqyrtimit në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

*Federatat Ndërkombëtare të Sporteve (FNS)*

Pjesa më e madhe e sportit në Evropë dhe në mbarë botën është e organizuar sipas parimeve të të ashtuquajturit modeli evropian i sportit; edhe pse është e rëndësishme të theksohet se kjo nuk është mënyra e vetme në të cilën organizohet sporti, pasi ka diversitet në të gjitha sportet dhe në pjesë të ndryshme të botës. Parimet e të ashtuquajturit modeli evropian i sportit, siç u përcaktua fillimisht nga Komisioni Evropian në vitin 1998, i vendosin federatat ndërkombëtare të sportit në një pozicion të fortë në lidhje me rregullimin e sporteve të tyre përkatëse, pasi atyre u jepet autoriteti si rregullatori dhe organi i vetëm drejtues i sportit të tyre në nivel ndërkombëtar. Prandaj, shumë FN të sporteve imponojnë standarde teknike dhe profesionale të rëndësishme për projektet e infrastrukturës në nivel të shteteve. Ato vendosin gjithashtu kërkesa në lidhje me strukturat e qeverisjes sportive në nivel të shteteve. Kjo do të thotë që FN-të mund të vendosin detyrime ndaj organeve vendore të sportit dhe mund të vendosin sanksione duke përfshirë tërheqjen e njohjes prej tyre për mos respektim. Ndërkohë që është kryesisht përgjegjësi e vetë organeve sportive që të sigurojnë se të njejtat veprojnë në përputhje me standardet e përcaktuara nga FN.

c) Kapacitetet e kufizuara njerëzore

Ministria, ka kapacitete të limituara në hartimin e politikave të sportit si dhe në monitorimin e zbatimit të plotë tij.

Sipas të dhënave të pranuara nga Ministria e Punëve të Brendshme, Kosova ka gjithsej 1571 klube sportive të cilat janë regjistruar si OJQ. Nga ky numër, 841 janë klube sportive aktive të cilat zhvillojnë aktivitetin e rregullt në kuadër të sistemit të sportit të Kosovës.[7]

Në përputhje me këtë, janë 40 federata sportive të licencuara nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit që funksionojnë sipas ligjit për sportin dhe legjislacionin përkatës që derivon ky ligj. Aktualisht, këto federata janë në procesin e ri-licencimit. Secila prej tyre, ka aktet normative të miratuara dhe është gjithashtu përgjegjëse për organizimin e aktiviteteve sportive; të shpenzojë buxhetin në përputhje me kërkesat dhe standardet e përcaktuara në ligjin për sportin; marrë pjesë në garat ndërkombëtare si dhe promovoj aktivitetet sportive.

Duke marrë parasysh atë që u theksua më lartë tek dispozitat e mangëta ligjore, fillimisht duhet theksuar se kompetencat për monitorimin e zbatimit të ligjit janë të paqarta e cila pastaj kombinohet me kapacitete të limituara.

Departamenti i Sportit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit përbëhet nga tre divizione:

1. Divizioni për Komitetin Olimpik, Komitetin Paralimpik dhe Federatat e sportit;
2. Divizioni i Infrastrukturës Sportive, dhe
3. Divizioni për Sporti për të gjithë dhe Sporti Shkollor/Universitar.

Monitorimi dhe mbikëqyrja i takon kryesisht Departamentit të Sportit edhe pse sic u potencua më sipër, ligji i sportit përcakton dispozita të mangëta për sa i përket monitorimit dhe mbikëqyrjes.[8] Pavarësisht

[7] Të dhëna të pranuara me datë 23 maj, 2022 nga Departameni i OJQ-ve të MPB-së.
[8] Shih neni 50 i ligjit të Sportit: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2490.

pjesës së monitorimit dhe mbikëqyrjes, i njëjti Departament është përgjegjës për zhvillimin e politikave në këtë sektor sipas përcaktimit të ligjit.

Në shumicën e komunave, drejtoritë e sportit kanë mungesë të stafit dhe nuk kanë kapacitete për të siguruar monitorimin dhe mbikëqyrjen e ligjit brenda territorit të komunës.

Stafi përkatës në Ministri dhe në komuna kanë mungesë të një platforme/baze të të dhënave për: sportistët, pjesëmarrjen në aktivitete sportive si ato ndërkombëtare dhe vendore, mungesë të dhënash për infrastrukturën fizike sportive dhe të dhëna të tjera relevante për monitorimin e duhur të zbatimit të ligjit dhe për hartimin e politikave zhvillimore.

Gjithashtu, stafi i lartpërmendur i ministrisë dhe komunave nuk kanë qasje në sisteme të tjera (si p.sh. sistemi/regjistri i OJQ-ve). Dokumentet mbahen në mënyrë manuale kryesisht për shkak të mungesës së një sistemi baze të të dhënave.

Ngjashëm me gjendjen ekzistuese në nivel të institucioneve publike, mungesa e kapaciteteve njerëzore në fushën e menaxhimit dhe nivelin administrativ në kuadër federatave dhe klubeve mbetet sfidë. Mungesa e kapaciteteve i atribuohet sportit profesional, elitar si dhe atë rekreativ duke filluar nga menaxherët, psikologët, nutricionistët, fizioterapeutët, mjekët sportiv etj.

Standardet e kualifikimeve për trajner, njohja e profesionit të trajnerit nuk është e rregulluar me ligjin aktual, përderisa kapacitetet dhe njohuritë e një pjese të trajnerëve mbeten të limituara.

d) Infrastruktura fizike sportive jo adekuate

Deri më tani nuk ka të dhëna të sakta për numrin, cilësinë dhe shfrytëzimin e infrastrukturës fizike sportive në Kosovë. Perceptimi i përgjithshëm është se një numër i konsiderueshëm i infrastrukturës fizike sportive ekzistuese nuk i plotësojnë standardet për organizimin e garave veçanërisht garat ndërkombëtare. Një tjetër vështirësi që haset në infrastrukturën fizike sportive ka të bëjë me pronësinë. Disa nga objektet sportive janë në pronësi të komunave dhe disa janë në pronësi private.

Gjithashtu, nuk ka standarde për kategorizimin e objekteve sportive.

Është jashtëzakonisht e rëndësishme që të posedohen të dhënat e lartpërmendura për të ndërmarrë një planifikim të duhur për të ardhmen. Për më tepër, objektet ekzistuese nuk menaxhohen si duhet në mungesë të standardeve dhe detyrimeve të qarta për institucionet e ndryshme të nivelit qendror dhe komunave kryesisht për shkak të paqartësisë dhe mungesës së zbatimit të legjislacionit.
Autoriteti kryesor për të mbështetur krijimin e infrastrukturës fizike sportive në Kosovë vazhdon të mbetet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Deri më sot nuk ka asnjë investim në kuadër të partneritetit publik-privat që do t'i shërbente avancimit të sportit në vend.

Vetëm në vitin 2021, Ministria ka ndarë 6.3 milion euro për infrastrukturë fizike sportive, përderisa të gjitha komunat e Republikës së Kosovës së bashku kanë ndarë buxhet në vlerë prej 4.6 milion euro për vitin 2021.[9] Kur kemi parasysh shumën e ndarë prej 4.6 milion euro e cila është e shpërndarë në të gjithë territorin e vendit, konsiderohet një disbalancë i ndarjes së buxhetit në raport me atë të nivelit qendror.

[9] Të dhëna të nxjerra nga buxheti dhe të prezantuara nga grupi punues për hartimin e Strategjisë.

Shkaktar i menaxhimit jo të duhur të infrastrukturës fizike sportive janë përgjegjësitë e pa qarta sipas legjislacionit ekzistues ku pastaj pengohet orientimi më i mirë në planifikimin, ndërtimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të sportit.

Efektet

Efektet të cilat janë të ndërlidhura me shkaqet mund të grupohen në tre kategori si vijojnë më poshtë:

a) Qeverisja dhe integriteti i sportit vazhdon të cënoj të drejtat e pjesëmarrësve në aktivitete fizike dhe atë të sportit
b) Dimensioni socio-ekonomik i sportit nuk është fokusi kryesor
c) Pjesëmarrja në sport dhe aktivitete fizike mbetet në nivel të ulët.

*Figura 6: temat, çështjet, shembujt dhe efeketet për kuadrin ligjor vendor.*

| **Qeverisja dhe integriteti i sportit vazhdon të cënoj të drejtat e pjesëmarrësve në aktivitete fizike dhe atë të sportit** | | | |
|---|---|---|---|
| **Tema** | **Çështja** | **Shembujt** | **Efektet** |
| Qeverisja e mirë dhe përfaqësimi i palëve të interesit në sport | Ka një fokus në rritje në qeverisjen e mirë në sport në nivel global, duke përfshirë shmangien e konfliktit të interesit, përfaqësimin e palëve të interesuara, barazinë gjinore dhe respektimin e sundimit të ligjit. | Dokumenti i Komisionit Evropian, 'Zhvillimi i Dimensionit Evropian në Sport'.<br><br>Vendimet e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (p.sh. Rasti C-49/07 *Motoe* & Rasti T-93/18, ISU).<br><br>Nenet .151-156 TFBE: Dialogu Social.<br><br>Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO): Forumi Global i Dialogut mbi Punën e Denjë në Botën e Sportit (2020). | Mungesa e parimeve të qeverisjes së mirë në legjislacionin e sportit, çon në:<br><br>1. të drejta dhe përgjegjësi të paqarta të organeve sportive;<br><br>2. Mungesë të kodit të qeverisjes sportive, që ndikon në mbrojtje jo të duhur të sportistëve, klubeve e organizatave sportive; |
| Zgjidhja e kontesteve | Ekziston shqetësim për standardet e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve në sport. | Aktgjykimi i GJEDNJ në rastin *Mutu dhe Pechstein kundër Zvicrës.* | Të drejtat e sportistëve, klubeve e federatave nuk mbrohen në nivelin e dëshiruar në mungesë apo për shkak të kapaciteteve të limituara në zgjidhjen e kontesteve, qoftë |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | përbrenda organizatës qoftë në zgjidhjen e rasteve në KAS. |
| Të drejtat e njeriut dhe mirëqenia e atyre që marrin pjesë në sport dhe aktivitete fizike | Fokusi i të drejtave të njeriut po shfaqet si një fushë kyçe e shqetësimit në sport, duke përfshirë kushtet e punës, mirëqenien e sportistëve në nivel bazë dhe profesional, mosdiskriminimin, lirinë e fjalës, të drejtën për tu paguar për jetesë, të drejtën e fjalës së lirë për sportistë në gara dhe përfaqësimin e sportistëve. | Karta Evropiane e Sportit.<br><br>Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore.<br><br>Vendimet e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (p.sh. Rasti C-415/93 *Bosman* dhe Rasti C-22/18, TopFit).<br><br>Plani i Punës i BE-së për Sportin 2021-2024.<br><br>Objektivat e OKB-së për Zhvillim të Qëndrueshëm (nr.5). | Instrumentet ndërkombëtare janë sikurse Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore është pjesë e sistemit ligjor e njohur me Kushtetutë, por mos-shfrytëzimi i duhur i mekanizmave ekzistues për mbrojtjen kundër diskriminimit, mbetet sfidë. |
| Antidopingu | Ka një harmonizim në rritje të standardeve ndërkombëtare antidoping. | Kodi WADA (ABAD).<br><br>Konventa e KiE Anti-Doping.<br><br>Konventa Ndërkombëtare e UNESCO-s kundër Anti-Dopingut.<br><br>Jurisprudenca e GjAS. | Mungesa e dispozitave ligjore për standardet antidoping con në konkurrencë jo të barabartë në mes sportistëve.<br><br>Projektligji për antidoping për të siguruar funksionimin efektiv të Agjencisë antidoping në Kosovë në mënyrë që të sigurohet pajtueshmëria e ËADA-s dhe të qartësohen mekanizmat e financimit dhe përgjegjësitë e palëve. |
| Manipulimi i garave sportive | Ekziston një shqetësim dhe veprim ndërkombëtar në rritje në lidhje me manipulimin e garave sportive. | Konventa e KiE për Manipulimin e Garave Sportive (Konventa Macolin). | Kapacitetet e limituara dhe mangësitë në ligjin për luftimin e dukurive negative ndikon drejtpërdrejtë tek sportistët, trajnerët dhe |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | Plani i Punës i BE-së për Sportin 2021-2024. | klubet për sa i përket abuzimit/manipulimit në sistemin e sportit. |
| Diplomacia Sportive | Ka një rritje të ndërgjegjësimit dhe përdorimit në nivel vendor dhe të BE-së për rolin që mund të luajë sporti në marrëdhëniet e jashtme, duke përfshirë brendimin shtetëror, normalizimin e marrëdhënieve diplomatike dhe për paqen dhe zhvillimin. | Strategjitë kombëtare të diplomacisë sportive në zhvillim (p.sh. Franca, Kroacia, Irlanda).<br><br>Plani i Punës i BE-së për Sportin 2021-2024.<br><br>Konkluzionet e Këshillit për Diplomacinë Sportive (2016).[10]<br><br>Strategjia Globale e BE-së.<br><br>Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së (nr. 16, 17) | Mungesa e dokumentit strategjik me objektiva të qarta për diplomacinë sportive, brendimin shtetëror ngadalëson avancimin e marrëdhënieve diplomatike. |

Dimensioni socio-ekonomik i sportit nuk është fokusi kryesor

*Figura 7: temat, çështjet, shembujt dhe efeketet për kuadrin ligjor vendor*

| **Dimensioni socio-ekonomik i sportit nuk është fokusi kryesor** | | | |
|---|---|---|---|
| **Tema** | **Çështja** | **Shembujt** | **Efektet** |
| Financimi i Qëndrueshëm | COVID-19 theksoi rëndësinë e ligjeve dhe politikave kombëtare sportive që ndërtojnë elasticitetin financiare dhe qëndrueshmëri në sektorin e sportit. | Plani i Punës i BE-së për Sportin 2020-2024.<br><br>Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së (nr.8, 9).<br><br>Ligji dhe politika e BE-së për Ndihmën Shtetërore (Neni 107 TFBE). | Strukturat sportive si klubet, federatat dhe organizatat përkatëse: KOK; KPOK; KAS; Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive; KOSADA mund të mos jenë plotësisht të vetë-qëndrueshme.<br><br>Financimi shtetëror i sportit nuk është në |

[10] Konkluzionet e këshillit në diplomacinë sportive, 15/12/2016, (2016/C 467/04): https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52016XG1215(03)&from=EN

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | përputhje me praktikat e mira të vendeve anëtare të BE-së dhe nuk reflekton rritjen e buxhetit të shtetit. |
| Qëndrueshmëria mjedisore | Ka një në rritje të njohjes së ndikimit mjedisor të sportit dhe rolit të tij në sigurimin e Axhendës 2030. | Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së (nr. 6, 7, 13).<br><br>Plani i Punës i BE-së për Sportin 2020-2024. | Çështjet mjedisore në planifikimin dhe funksionimin e infrastrukturës fizike sportive duhet të aplikohen dhe të bëhet ndërlidhje me legjislacionin mjedisor. |
| Infrastruktura fizike sportive | Përvoja ndërkombëtare tregon rëndësinë e planifikimit, ndërtimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës fizike sportive. Ekziston gjithashtu një rritje e të kuptuarit të kostove dhe përfitimeve lidhur me organizimin e ngjarjeve të mëdha sportive. | Ligji dhe politika e BE-së për Ndihmën Shtetërore (Neni 107 TFBE)<br><br>Plani i Punës i BE-së për Sportin 2020-2024.<br><br>Standardet ndërkombëtare të vendosura nga federatat ndërkombëtare të sportit. | Të drejtat dhe përgjegjësitë e pa-qarta të palëve të përfshira në të gjitha fazat nga: planifikimi, ndërtimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës sportive, çon në infrastrukturë të papërshtatshme.<br><br>Gjatë planifikimit të infrastrukturës fizike sportive mungojnë analizat e kost benefitit për atë infrastrukturë duke përfshirë mundësinë e organizimit të ngjarjeve të mëdha sportive të cilat mund të kenë përfitime.<br><br>Kërkesat e detyrueshme dhe zbatimi i standardeve për personat me aftësi të kufizuara mbetet sfidë për qasjen e personave me aftësi të kufizuara. |
| Karriera e dyfishtë | Ekziston një njohje ndërkombëtare në rritje e nevojës që sportistët të jenë në gjendje të kombinojnë | Plani i Punës i BE-së për Sportin 2020-2024. | Potenciali për shfrytëzimin e kapaciteteve të sportistëve dhe |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | karrierën e tyre sportive me arsimin/punën. | Konkluzionet e Këshillit për Karrierat e Dyfishta për Sportistët, 2013/C 168/04. | trajnerëve nuk është në nivelin e duhur. Mbështetja për sportistët gjatë dhe pas karrierës së tyre nuk është adresuar mjaftueshëm në legjislacionin ekzistues. |
| Siguria për tifozët | Ka një zhvendosje të theksit nga një fokus i bazuar në dhunë drejt një qasjeje të integruar që fokusohet në sigurinë, mbrojtjen dhe shërbimin. | Konventa e Sigurisë, Mbrojtjes dhe Shërbimit në Sport (Konventa e Saint-Denis) | Më shumë aktivitete ndërgjegjësuese nevojiten për të gjitha palët e përfshira: tifozët; sportistët; klubet; federatat për shërbimet e sigurisë dhe mbrojtjes. Mungojnë standardet e licencimit të stadiumeve dhe objekteve tjera sportive. |

a) Pjesëmarrja në sport dhe aktivitetet fizike mbetet në nivel të ulët

Pjesëmarrja në aktivitetin fizik sjellë përfitime të mëdha në aspektin shëndetësor, ekonomik, social, psikologjik, mjedisor dhe të tjera. Të dhënat e Organizatës Botërore të Shëndetësisë tregojnë se mungesa e aktivitetit fizik tek personat e moshës 18 vjecë e më shumë është një nga katër faktorët kryesorë që shkakton vdekshmëri në botë. Pra, mospjesëmarrja në aktivitet fizik rritë rrëzikun për 20% deri në 30% të vdekshmërisë sipas rapoetit të vitit 2018.

Për sa i përket pjesëmarrjes në sport dhe aktivitetit fizik në Republikën e Kosovës, korniza ligjore në fuqi garanton të drejta dhe qasje të barabartë në sport për të gjithë pa dallim gjinie, etnie etj. Në këtë drejtim, pervec ligjit të sportit dhe kornizës ligjore në zbatim të ligjit të sportit, ekzistojnë edhe një varg ligjesh tjera të cilat zbatohen drejtpërdrejtë në sektorin e sportit sikurse Ligji për Barazi Gjinore, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligji për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive. Megjithatë, përderisa korniza ligjore ofron të drejta të barabarta, në praktikë qasja në sport nuk është në nivel të barabartë për sa i përket gjinisë. Përvec pjesëmarrjes jo të barabartë të burrave e djemve dhe grave e vajzave, niveli i pjesëmarrjes në aktivitetin fizik në përgjithësi mbetet në nivel të ulët.

Disa statistika relevante të cilat janë prezantuar nga raporti i hulumtimit të Organizatës DemSport "Gardianët e Barazisë" tregon që:

- në evropë 4 nga 10 persona merren me aktivitet fizik apo sport një herë në javë;
- 36% e grave ushtrojnë të paktën një herë në javë, ndërsa burrat 44%;
- 39% e moshës 40-54 ushtrojnë të paktën 1 herë në javë, ndërsa personat e moshës 55 vjecë e më shumë janë vetëm 30%.

Ndërsa për sa i përket pjesëmarrjes në aktivitet fizik në Kosovë, deri më tani nuk ka të dhëna zyrtare apo matje të aktivitetit fizik për të kuptuar më mirë aktivitetin apo pasivitetin e qytetarëve. Megjithatë, disa të dhëna të mbledhura nga ministria tregojnë se përafërsisht 51% e tërë popullatës në Kosovë nuk merren fare

me aktivitet fizik, përderisa në BE mesatarja e atyre që nuk merren fare me aktivitet fizik është 31%. Në këtë drejtim, gratë dhe vajzat mbeten më pak aktive. Pëderisa 34.15% e burrave dhe djemve nuk merren fare me sport, përqindja e grave dhe vajzave shkon në 52.83%. Pjesëmarrja më e ulët e grave dhe vajzave mund ti atribuohet faktorëve të ndryshëm sikurse social dhe ekonomik e kombinuar me mungesën e hapësirave dhe mundësisë për pjesëmarrje në aktivitet fizik.

Gjendje aspak më e mirë nuk është për sa i përket përfshirjes së grave në qeverisjen sportive në klubet e sportit.

*Figura 8: përfshirja e burrave dhe grave në qeverisjen sportive*

| **Qeverisja sportive në klubet e sportit** | | | |
|---|---|---|---|
| **Pozita** | Numri | Burra | Gra |
| **Drejtor** | 274 | 93% | 5% |
| **Menagjer** | 83 | 95% | 5% |
| **Sekretar** | 171 | 94% | 6% |

Ministria, Strategjisë së re të Sportit do të zhvilloj politika dhe zvogëlimin e pabarazisë dhe ngritjen e përfshirjes së grave dhe vajzave në aktivitetin fizik si dhe ngritjen e përqindjes së përfshirjes së tyre në strukturat qeverisëse të sportit duke respektuar gjithashtu kornizën ligjore në fuqi për barazi gjinore dhe mbrojtje nga diskriminimi.

*Figura 9: temat, çështjet, shembujt dhe efektet për kuadrin ligjor vendor*

| **Pjesëmarrja në sport dhe aktivitetet fizike mbetet në nivel të ulët** | | | |
|---|---|---|---|
| **Tema** | **Çështja** | **Shembujt** | **Efektet** |
| Promovimi i aktivitetit fizik/sportit për të gjithë | Ka gjithnjë e më shumë fokus në edukimin fizik cilësor dhe aktivitetin fizik gjatë gjithë jetës. | Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së (nr. 3, 4).<br><br>Plani i Veprimit KAZAN (PVK).<br><br>Udhëzimet e UNESCO-s për edukimin fizik cilësor (EFS). | Mungesa e programeve adekuate dhe kapacitetet e limituara njerëzore të mësimdhënësve dhe instruktorëve, hapësira e pamjaftueshme për pjesëmarrje në aktivitete fizike qojnë në nivel të ulët të pjesëmarrjes në aktivitete fizike. |
| Sport i sigurt/Mbrojtje | Ka gjithnjë e më shumë njohje ndërkombëtare të nevojës për të vendosur standarde të larta mbrojtëse në sport. | Rekomandimet dhe konventat e KiE.<br><br>Neni 165 TFBE | Kodi i mirësjelljes dhe parimet e qeverisjes së mirë nuk janë të adresuara në kornizën ligjore.<br><br>Gjithashtu, mungojnë fushatat ndërgjegjësuese për |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | Konkluzionet dhe studimet e Këshillit të BE-së.<br><br>Masat mbrojtëse ndërkombëtare të UNICEF-it për fëmijët në sport.<br><br>Plani i Veprimit KAZAN. | mekanizmat e sinjalizimit si dhe mekanizmat për mbrojtje.<br><br>Të gjitha palët e përfshira në sektorin e sportit duhet të jenë të informuar mbi të drejtat ligjore të garantuara nga ligji për sinjalizimin si dhe kornizën ligjore në fuqi. |
| Trajnimi cilësor | Ekziston një njohje ndërkombëtare në rritje e nevojës për të promovuar standarde të larta të stërvitjes në sport. | Neni 165 TFBE.<br><br>Grupi i Ekspertëve të BE-së për Zhvillimin e Aftësive dhe Burimeve Njerëzore në Sport: Udhëzime në lidhje me kërkesat minimale në aftësitë dhe kompetencat për trajnerët (2020).<br><br>Plani i Punës i BE-së për Sportin 2020-2024. | Mungesa e standardeve dhe rregullave të kualifikimeve të trajnerëve qon në lëndime të shpeshta. |

Kapitulli 1.3. Palët e interesuara

Figura më poshtë paraqet palët e interesuara të identifikuara. Gjithashtu tregon nëse ato janë prekur nga shkaqet, efektet apo të dyja së bashku. Kapitulli 5 ofron informacion se si janë konsultuar këto palë të interesit.

*Figura 10: Pasqyrë e palëve të interesuara në lidhje me përcaktimin e problemit*

| Emri i palës së interesit | Shkaku(qet) dhe efekti(tet) me të cilat është i lidhur pala e interesit | Mënyra në të cilën palët e interesit janë të lidhura me këtë(ol shkak(qe) ose efekt(a) |
|---|---|---|
| Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | Mungesa e politikave dhe strategjive të qarta<br>Rregullat janë të mangëta<br>Mungesa e kapaciteteve<br>Infrastruktura/objektet sportive janë jo adekuate | Të prekur drejtpërdrejt<br>Ministria përmes koncept dokumentit do ti adresoj shkaqet dhe efektet. |
| Komuna | Mungesa e politikave dhe strategjive të qarta<br>Rregullat janë të mangëta | Të prekur drejtpërdrejt |

| | | |
|---|---|---|
| | Mungesa e kapaciteteve<br>Infrastruktura/objektet sportive janë jo adekuate | |
| Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporë | Mungesa e politikave dhe strategjive të qarta | Të prekur drejtpërdrejt |
| Ministria e Punëve të Brendshme - DOJQ | Mungesa e politikave dhe strategjive të qarta<br>Rregullat janë të mangëta | Të prekur drejtpërdrejt |
| Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit | Mungesa e politikave dhe strategjive të qarta<br>Rregullat janë të mangëta<br>Kapacitete të limituara | Të prekur drejtpërdrejt |
| Ministria e Shëndetësisë | Mungesa e politikave dhe strategjive të qarta<br>Rregullat janë të mangëta<br>Kapacitete të limituara | Të prekur drejtpërdrejt |
| Këshilli Kombëtar për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive | Mungesa e politikave dhe strategjive të qarta<br>Rregullat janë të mangëta<br>Kapacitete të limituara | Të prekur drejtpërdrejt |
| Komiteti Olimpik i Kosovës | Mungesa e politikave dhe strategjive të qarta<br>Rregullat janë të mangëta<br>Mungesa e kapaciteteve<br>Infrastruktura/objektet sportive janë jo adekuate | Komiteti Olimpik i Kosovës është prekur direkt |
| Komiteti Paralimpik i Kosovës | Mungesa e politikave dhe strategjive të qarta<br>Rregullat janë të mangëta<br>Mungesa e kapaciteteve<br>Infrastruktura/objektet sportive janë jo adekuate | Komiteti Paralimpik i Kosovës është prekur drejtpërdrejt |
| Këshilli i Arbitrazhit Sportiv | Rregullat janë të mangëta<br>Kapacitete të limituara | Të prekur drejtpërdrejt |
| Federatat e sportit | Integriteti i Sportit mbetet një sfidë<br>Dimensioni socio-ekonomik i sportit<br>Pjesëmarrja në aktivitete sportive mbetet në nivel të ulët. | Federatat e Sportit i bartin pasojat dhe preken drejtëpërdrejt |
| Klubet sportive | Rregullat e mangëta<br>Kapacitete të limituara<br>Infrastrukturë jo adekuate<br>Integriteti i Sportit mbetet një sfidë<br>Dimensioni socio-ekonomik i sportit | Klubet sportive i bartin pasojat dhe preken drejtpërdrejt |

| | | |
|---|---|---|
| | Pjesëmarrja në aktivitete sportive mbetet në nivel të ulët. | |
| Sportistët, trajnerët dhe gjyqtarët/referët | Shkaqe dhe efekte | Pasojat i bartin drejtpërdrejt |
| Universitetet dhe shkollat | Mungesa e politikave dhe strategjive të qarta<br>Infrastruktura/objektet sportive janë jo adekuate<br>Kapacitete të limituara | Të prekur drejtpërdrejt |
| Bizneset | Dimensioni socio-ekonomik i sportit<br>Rregullat janë të mangëta | Bizneset i bartin pasojat dhe preken drejtpërdrejt |
| Qytetarët | Integriteti i Sportit mbetet një sfidë<br>Pjesëmarrja në aktivitete sportive mbetet në nivel të ulët. | Pasojat i bartin qytetarët |

Kapitulli 2: Objektivat

Në figurën 11 më poshtë janë listuar objektivat strategjike dhe ato specifike të Koncept Dokumentit.

Objektiva strategjike 4.1.2. *"të konsolidoj politikat vendore të bëjë ndryshime në kornizën ligjore dhe të përafrohet me standardet e zbatueshme të organizatave ndërkombëtare dhe organizmave sportiv ndërkombëtar me synim ngritjen në të gjitha nivelet të sektorit të sportit i cili i shërben qëllimit"* si dhe objektiva specifike 2.16.3 *"për të lehtësuar rolin e sportit si zhvillues i imazhit shtetëror dhe të mirëqenies sociale"* janë objektiva ekzistuese të cilat përcaktohen në Planin Strategjik Operacional të Qeverisë 2022-2025 si dhe në Programin Qeveritar 2022-2025 ndërsa objektivat tjera të listuara më poshtë, janë objektiva specifike të këtij Koncept Dokumenti.

*Figura 11: Objektivat relevante të Qeverisë*

| **Emri i dokumentit përkatës të planifikimit** | **Objektivi relevant** |
|---|---|
| **Objektivë strategjike 1**: të konsolidoj politikat vendore të bëjë ndryshime në kornizën ligjore dhe të përafrohet me standardet e zbatueshme të organizatave ndërkombëtare dhe organizmave sportiv ndërkombëtar me synim ngritjen në të gjitha nivelet të sektorit të sportit i cili i shërben qëllimit.<br><br>**Objektivë specifike 1.1:** finalizimi dhe miratimit i strategjisë për sport;<br><br>**Objektivë specifike 1.2:** hartimi dhe miratimi i ligjit dhe akteve nënligjore në fushën e sportit;<br><br>**Objektivë specifike 1.3:** rregullimi ligjor institucional i institucioneve publike përfshirë | 4.1.2. e Planit Strategjik Operacional të Qeverisë 2022-2025 |

| | |
|---|---|
| definimin e të drejtave dhe përgjegjësive të organizatave në sistemin e sportit;<br><br>**Objektivë specifike 1.4:** krijimi i bazës ligjore për mekanizma të rinj si në nivel të institucionit publik ashtu edhe në nivel të organizatave sportive;<br><br>**Objektivë specifike 1.5:** Krijimi i bazës ligjore për krijimin e bazës së të dhënave/platformës e cila do të përmbaj të dhëna për: infrastrukturën fizike sportive, federatat, klubet, sportistët, buxheti etj; | |
| **Objektivë strategjike 2:** Ri-organizimi i strukturës dhe mekanizmave që qeverisin me sportin.<br><br>**Objektivë specifike 2.1:** Rishikimi i rolit dhe përgjegjësive të mekanizmave të institucioneve publike në fushën e sportit dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional;<br><br>**Objektivë specifike 2.2:** Rishikimi i rolit dhe përgjegjësive të mekanizmave tjerë jo-qeveritar në fushën e sportit; | Këtij koncept dokumenti |
| **Objektivë strategjike 3:** Përmirësimi i financimit dhe përcaktimi i modeleve të financimit, të hyrave dhe instrumenteve ekonomike;<br><br>**Objektivë specifike 3.1:** Rishikimi i modelit ekzistues të financimit në sektorin e sportit; | Këtij koncept dokumenti |
| **Objektivë strategjike 4:** Ngritja e kapaciteteve njerëzore.<br><br>**Objektivë specifike 4.1:** Rivlerësimi dhe zhvillimi i programeve të trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve;<br><br>**Objektivë specifike 4.2:** Ngritja e kapaciteteve në nivel të institucioneve publike relevante të fushës së sportit;<br><br>**Objektivë specifike 4.3:** Ngritja e kapaciteteve të mekanizmave tjerë qeverisës të sportit si dhe të organizatave sportive. | Këtij koncept dokumenti |
| **Qëllimi specifik 2.2 Krijimi i mjedisit të favorshëm për realizimin e të drejtave, kapaciteteve dhe potencialeve njerëzore**<br><br>**7. Analiza të vazhdueshme të buxhetit me perspektivë gjinore në fushën e arsimit, shkencës, sportit, energjetikës, kulturës, rinisë, diasporës, shëndetësisë, kthimit dhe komuniteteve** | Programi i Kosovës për Barazi Gjinore, 2020-2024 shih dokumentin e programit për indikatorët dhe aktivitetet përkatëse. |

| 8. Përfshirja e vajzave dhe grave në sport | |
|---|---|

**Mjeti 15: Analiza e politikave për transpozimin e Acquis të BE-së**

Sipas nenit 4 të Traktatit për Bashkimin Evropian (TEU), kompetencat që nuk i janë dhënë BE-së mbahen nga shtetet anëtare. Deri në vitin 2009, traktatet nuk i bartnin BE-së kompetencë në fushën e sportit. Megjithatë, sporti i nënshtrohet ligjit të BE-së sa herë që ai praktikohet si një aktivitet ekonomik, siç u vërtetua për herë të parë në Rastin 36/74. *Walrave kundër Union Cycliste Internationale.* Fusha të tjera të kompetencës brenda Traktatit, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me lirinë e lëvizjes dhe ligjin e konkurrencës, u bënë të zbatueshme në aktivitetet sportive nëpërmjet jurisprudencës së Gjykatës së Drejtësisë dhe praktikës vendimmarrëse të Komisionit Evropian (shih tabelat 3 dhe 4 në vijim).

Sporti u bë kompetencë e BE-së me hyrjen në fuqi të neneve 6 dhe 165 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU) në vitin 2009. Megjithatë, sporti nuk është kompetencë ekskluzive apo e përbashkët e BE-së. Aktiviteti i BE-së në fushën e sportit është i kufizuar në ofrimin e mbështetjes, koordinimit ose plotësimin e aktiviteteve të shteteve anëtare që mbajnë kompetencën për sportin. Për më tepër, kjo kompetencë nuk shpie në ndonjë përjashtim për sportin nga aplikimi i kompetencave të tjera të Traktatit (shih tabelën 1 në vijim), megjithëse neni 165 kërkon që BE-ja të kontribuojë në promovimin e çështjeve sportive evropiane, "duke marrë parasysh natyrën e veçantë të sportit, strukturat e tij të bazuara në veprimtarinë vullnetare dhe funksionin e tij social dhe edukativ".

Prandaj, edhe pse sporti është kompetencë e shtetit anëtar, praktikat sportive duhet të jenë në përputhje me *Acquis* të BE-së përfshirë vendimet e Gjykatës së Drejtësisë.

Marrëveshja për Stabilizim Asociim ndërmjet BE-së dhe Republikës së Kosovës e obligon Kosovën që të përafrojë legjislacionin e saj në sektorët përkatës me atë të BE-së dhe ta zbatojë atë në mënyrë efektive. Ndonëse marrëveshja nuk përmban ndonjë referencë për sektorin e sportit.

Për më tepër, një sërë fushash të rëndësishme për sportin mbulohen në marrëveshje, duke përfshirë parimet e përgjithshme si respektimi i të drejtave të njeriut, mosdiskriminimi, sundimi i ligjit, qeverisja e mirë dhe diskutimi i kompetencave specifike siç është lëvizja e lirë, themelimi, ofrimi i shërbimeve, rregullat e konkurrencës, bashkëpunimi social, arsimi dhe trajnimi, bashkëpunimi kulturor dhe bashkëpunimi në fushën audio-vizuale.

Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (2022-2026) bënë referim te Komunikata e Komisionit të vitit 2011 "Zhvillimi i Dimensionit Evropian në Sport", por nuk adreson në mënyrë eksplicite *acquis*-in e BE-së për sportin. Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës (2021-2025) e bën të qartë ambicien e anëtarësimit në BE. Në lidhje me sektorin e sportit, Programi përcakton synimin e qeverisë për të konsoliduar politikat kombëtare të sportit dhe për t'i sjellë ato në përputhje me standardet e organizatave ndërqeveritare.

Në këtë kontekst, legjislacioni i Bashkimit Evorpian për fushën e sportit mund të pëmbledhet në aktet si në vijim:

| Nr. | Legjislacioni Primar i Bashkimit Evopian |
|---|---|
| 1. | Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian – TFEU |
| | Legjislacioni dytësor |
| 1. | Rregullorja e Komisionit (EU) Nr. 651/2014 e datës 17 qershor 2014 që cek kategori të caktuara të ndihmës që është kompatibile me tregun e brendshëm në zbatim të neneve 107 dhe 108 të Traktatit. |
| 2. | Direktiva 2010/13/EU [2010] Shërbimet Mediatike Audiovizive. |
| 3. | Rregullorja e Komisionit (EU) 2017/1084 e datës 14 qershor 2017, që ndryshon Rregulloren (EU) Nr.651/2014 për sa i përket ndihmës për infrastrukturën e portit aeroportit, njoftimit bazë për ndihmën për ruajtjen e kulturës dhe trashëgimisë dhe për ndihmën për sportin dhe infrastrukturën rekreative multifunksionale, dhe skemat rajonale të ndihmës operative për rajonet më të largëta e cila ndryshon Rregulloren (EU) Nr. 702/2014 për sa i përket llogaritjes së kostove të pranueshme |
| 4. | Rregullorja (EU) 2016/679, Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave. |
| 5. | Rregullorja (EU) 2021/817, Rregullorja Erasmus+. |
| 6. | Rezoluta për Planin e Punës së Bashkimit Evropian për Sportin (1 janar 2021-30 qershor 2024) 2020/C 419/01; |
| 7. | Karta Olimpike dhe Karta Evropiane të Sportit e rishikuar (aprovuar nga Këshilli i Ministrave me 13 tetor 2021 në mbledhjen 1414). |

Kapitulli 3: Opsionet

**Mjeti 18: Testi i konkurrueshmërisë rregullative**

Për qëllime të këtij Koncept Dokumenti dhe shqyrtimin e opsioneve të mundshme për adresimin e problemit kryesor, janë analizuar sistemet e katër shteteve si në vijim: Irlanda, Kroacia, Sllovenia dhe Maqedonia e Veriut.

**Iralanda**

| Fushat e Krahasimit | Karakteristikat dhe përshkrimi | Materialet dhe Dokumente t përkatëse |
|---|---|---|
| 1. Korniza Strategjike | - Hartimi i planeve strategjike pesëvjeçare dhe dhjetëvjeçare në nivel kombëtar (1997-2006; 2018-2027)<br>- Synimi i arritjes së ndryshimeve sportive në Irlandë 1997-2006 dikur drejtohej nga Departamenti i Arsimit<br>- Në vitin 1999, Këshilli i Sporteve Irlandez (tani Sport Ireland) u themelua për të zbatuar politikën e qeverisë në lidhje me vlerën e parasë<br>- Në vitin 2018, Departamenti i Transportit, Turizmit dhe Sportit i qeverisë publikoi strategjinë kombëtare "Politika Kombëtare | Politika Kombëtare e Sportit 2018-2027<br><br>Akti i "Sport Irelandë" 2015 |

| | | |
|---|---|---|
| | Sportive 2018-2027". Synimi kryesor është ta ngre Irlandën në "krye të tabelës globale" si në sportin e pjesëmarrjes ashtu edhe në performancën e lartë.<br>- Korniza ligjore kërkon që "Sport Ireland" të paraqes 'deklaratë strategjike' për një periudhë pesëvjeçare pas vitit të paraqitjes. | |
| 2. Korniza Ligjore | - Korniza aktuale rregullatore në Irlandë është e strukturuar qartë, veçanërisht pas Aktit të vitit 2015, pasi pothuajse të gjitha çështjet që lidhen me sportin janë nën ombrellën e Sport Ireland.<br>- Sport Ireland është agjencia kryesore dhe udhëheqëse për të monitoruar dhe koordinuar iniciativat dhe veprimet e qeverisë. 64 Organet Drejtuese Kombëtare të Sportit (ODK) janë agjencitë kryesore të dërgesave të Sport Ireland, që i raportojnë si Qeverisë ashtu edhe Sport Ireland dhe mbështeten nga to.<br>- Puna e ODK-ve koordinohet nga klubet me bazë komunitare, shkollat dhe institucionet e arsimit të lartë në nivel lokal. Në nivel kombëtar, Sport Ireland gjithashtu menaxhon si pjesëmarrjen ashtu edhe sportin elitar përmes "Coaching Ireland", Institutit Irlandez të Sportit dhe Këshillit Olimpik të Irlandës.<br>- Irlanda i vë theksin më shumë anës politike dhe strategjike se sa kuadrit ligjor formal. Akti i Sporteve i vitit 2015 që e ndryshon Aktin e Këshillit të Sporteve Irlandeze të vitit 1999, përcakton marrëdhëniet juridike midis Qeverisë (Ministrit) dhe Sport Ireland sot - përshkruante të drejtat e institucionit.<br>- Akti rregullon funksionin, bordin, stafin, tokën, raportet, përgjegjësitë antidoping të Sport Ireland; Politika Kombëtare e Sporteve shpjegon angazhimin e Organeve Kombëtare Drejtuese.<br>- DTTAS (Departamenti i Transportit, Turizmit dhe Sportit) përcakton politikat sportive dhe administron Programin Kapital të Sportit duke alokuar fonde për organizatat dhe objektet. Politika mbikëqyr pothuajse të gjitha aspektet e zhvillimit të sportit në Irlandë.<br>- Sport Ireland zbaton dhe vendos për të arritur qëllimet e qeverisë. | Politika Kombëtare e Sportit 2018-2027<br><br>Akti i "Sport Ireland" 2015 |
| 3. Struktura institucionale & statusi i federatave dhe klubeve sportive | - Në vitin 2014, Irlanda reformoi sistemin e saj sportiv duke mësuar veçanërisht nga sistemi sportiv i Singaporit për shkak të ngjashmërisë në madhësinë e popullsisë dhe ekonominë.<br>- DTTAS (Departamenti i Transportit, Turizmit dhe Sportit) përcakton politikat sportive dhe administron Programin Kapital të Sportit duke alokuar fonde për organizatat dhe objektet. | Politika Kombëtare e Sportit 2018-2027 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Politika mbikëqyr pothuajse të gjitha aspektet e zhvillimit të sportit në Irlandë.<br>- Këshilli Irlandez i Sporteve ("Sport Ireland") është përgjegjës për ofrimin e politikave, veçanërisht për 1) zhvillimin e pjesëmarrjes sportive, 2) sportin me performancë të lartë, 3) antidoping, 4) kodin e etikës dhe praktikave të mira për fëmijët në sport, 5) hulumtim.<br>- Sport Ireland është përgjegjëse për tetë divizione kryesore: i) anti-doping, ii) shërbimet korporative, iii) performancën e lartë, iv) Institutin Irlandez të Sportit, v) partneritetet sportive lokale, vi) organet qeverisëse kombëtare, vii) Zyrën kombëtare të shtigjeve dhe viii) kërkim<br>- Sport Ireland është e obliguar të përgatis strategjinë cdo tri vite dhe gjithashtu ofroj këshilla për Qeverinë dhe Departamentin.<br>- Sport Ireland ka autoritetin të vendos për zbatimin dhe arritjen e politikave qeveritare dhe aspektet e zhvillimit.<br>- Federata Olimpike është përgjegjëse për të gjitha cështjet lidhur me përgatitjet dhe lëvizjen olimpike. | |
| 4. Procesi i ofrimit të shërbimit ose licencave | Regjistrimi i federatave:<br>- Federatat njihen nga Agjencia Irlandeze e Sportit (*Sport Ireland*), agjencia kombëtare e sportit në Irlandë.<br>- Regjistrimi nënkupton që federatat konstatohen se 'i plotësojnë' (për ODK-të) ose 'janë në proces të përshtatjes (për OJQ-të e tjera sportive)' të kodit qeverisës të sportit në Irlandë. Regjistri monitorohet rregullisht dhe i dërgohet i përditësuar Agjencisë Irlandeze të Sportit për shqyrtim.<br>- Të gjitha organizatat konsiderohen se i plotësojnë kushtet për tre vjet nga takimi i Bordit në të cilën nënshkruhet "Deklarata Publike e Pajtueshmërisë" dhe i përcillet Agjencisë së Sportit bashkë me "Formularin e Pajtueshmërisë ose Shpjegimit".<br>- Çdo vit, të gjitha organizatat duhet gjithashtu të dorëzojnë një vetë-vlerësim të qeverisjes, si dhe të rikonfirmojnë praktikat e tyre karshi Kodit dhe të rideklarojnë pajtueshmërinë e tyre me Kodin me anë të dorëzimit të dokumenteve përkatëse.<br>- Organizatat duhet t'i referohen Dokumentit "Kriteret e Njohjes për Organet Drejtuese Kombëtare të Sportit".<br>- Për t'u regjistruar, tarifa e anëtarësimit në Federatën Irlandeze të Sportit është 1000 euro për ODK-të me mbi 75,000 anëtarë dhe 500 euro për ODK-të me nga 20,000 deri në 75,000 anëtarë; si dhe duhet të dorëzohen dokumente si kushtetuta dhe rregullat e organizatës, pasqyra e strukturës qeverisëse, të dhënat kontaktuese, konfirmimi me shkrim si ODK nga Agjencia e Sportit, | Politika Kombëtare e Sportit 2018-2027<br><br>"Si të strukturoni organizatën tuaj sportive "Sport Ireland<br><br>"Kriteret e Njohjes për Organet Drejtuese Kombëtare të Sportit" |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | abonimin vjetor dhe dokumente të tjera të kërkuara nga bordi.<br><br>Regjistrimi i klubeve:<br>- Organet Drejtuese Kombëtare janë pika e parë e kontaktit për klubet sportive dhe organizatat rajonale.<br>- Gjatë regjistrimit, duhet të dorëzohet struktura organizative e klubit dhe statuti me shkrim që përcakton rregullat dhe qeverisjen<br>- Zyrtarët minimalë: kryesuesi, sekretari dhe arkëtari<br>- Për çështje si masat mbrojtëse, mbrojtja e të dhënave dhe financat klubi duhet t'i përmbahet pakos së mjeteve të përgatitur nga Agjencia e Sportit<br>- Klubeve joprofesionale u rekomandohet të bëhen shoqata jo të inkorporuara; klubeve më të mëdha dhe organeve drejtuese u sugjerohet të bëhen kompani të garantuara nëse nuk kanë nevojë të shpërndajnë fitimet; për operacionet komerciale më të mëdha dhe më komplekse do të nevojitej që organizatat të jenë një kompani private me përgjegjësi të kufizuar; kompanitë publike me përgjegjësi të kufizuar janë për klubet me anëtarësi të madhe. | |
| 5. | Koncepti sportiv | - Sporti rekreativ nënkupton "të gjitha format e aktivitetit fizik, të cilat, nëpërmjet pjesëmarrjes së rastësishme ose të rregullt, synojnë: (a) shprehjen ose përmirësimin e aftësisë fizike dhe mirëqenies mendore, dhe (b) krijimin e marrëdhënieve shoqërore;<br>- Sporti garues nënkupton "të gjitha format e aktivitetit fizik të cilat, nëpërmjet pjesëmarrjes së organizuar, synojnë — (a) shprehjen ose përmirësimin e aftësisë fizike, dhe (b) arritjen e rezultateve të përmirësuara në garë në të gjitha nivelet<br>- Në politikëbërje, sporti elitar është më i fokusuar në financim, ndërkohë që korniza ligjore nuk është e kufizuar dhe merr parasysh sportin e gjerë për të gjithë dhe sportin e pjesëmarrjes. | Politika Kombëtare e Sportit 2018-2027<br><br>Akti i "Sport Ireland" 2015 |
| 6. | Infrastruktura sportive | - "Sport Infrastructure" është nën-divizion i Sport Ireland, megjithëse më parë drejtohej nga Autoriteti Kombëtar i Zhvillimit të Kampusit Sportiv.<br>- Programi Kapital Sportiv ofron një gamë të zgjeruar të objekteve sportive në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.<br>- Zhvillimi i objekteve është i lidhur ngushtë me strategjinë dhe fokusin sportiv të vendit, si p.sh *Programi i Pishinave të Autoritetit Vendor*, objekte sportive për të përmbushur nevojat stërvitore dhe garuese të Dublinit.<br>- Me Strategjinë Kombëtare të Objekteve Sportive 2012-2015, janë zhvilluar dhe financuar objekte më të mëdha multisportive në komuna nga DTTAS. | Politika Kombëtare e Sportit 2018-2027<br>Akti i "Sport Ireland" 2015 |

| | | |
|---|---|---|
| 7. Mbështetja financiare në seksionin e sportit (financimi) | - Sporti në Irlandë financohet kryesisht nga qeveria, dhe ky financim kryesisht shkon përmes Programit Kapital Sportiv ose në mënyrë indirekte përmes Këshillit Sportiv Irlandez/Autoriteteve Lokale si grante vjetore.<br>- Financimi aktual është i orientuar drejt programit me performancë të lartë (për të siguruar mirëqenien e sportistëve elitarë nëpërmjet mbështetjes financiare) dhe për zhvillimin e kapaciteteve dhe aktiviteteve të ODK-ve.<br>- ODK-të në Irlandë financojnë angazhimet dhe operacionet e tyre sportive përmes sponsorizimit komercial, të hyrave nga shitjet e biletave si dhe iniciativave (llotarive).<br>- Programi Kapital Sportiv i Qeverisë mbështet veçanërisht përmirësimin e objekteve për ODK-të. Financimi për aktivitetet bazike sportive nxitet kryesisht nga klubet lokale me bazë në komunitet. | Politika Kombëtare e Sportit 2018-2027<br><br>Akti i "Sport Ireland" 2015 |
| 8. Sponsorizimi | - Sport Ireland mund të ketë të drejtën për të hyrë në çdo sponsorizim, me përjashtim të rasteve kur kushtet e bashkangjitura nuk janë në përputhje me politikën e qeverisë ose funksionin e Sport Ireland.<br>- Akti i sportit nuk rregullon rreptësisht çështjet përkatëse të sponsorizimit. | Politika Kombëtare e Sportit 2018-2027<br>Akti i "Sport Ireland" i vitit 2015 (Pjesa 2 Neni 11) |
| 9. Luftimi i dukurive negative në sport | - Rregulla Anti Doping 2021 botuar nga Sport Ireland.<br>- Edukimi kundër dopingut përfshin seminare, e-learning, trajnime për tutor dhe resurse. | Politika Kombëtare e Sportit 2018-2027<br>Akti i "Sport Ireland" 2015 |
| 10. Edukimi dhe promovimi | - Stërvitja dhe edukimi menaxhohen nga Sport Ireland si nënseksione. | Politika Kombëtare e Sportit 2018-2027<br>Akti i "Sport Ireland" 2015 |
| 11. Monitorimi i zbatimit të ligjit | - Departamenti i Transportit, Turizmit dhe Sportit përcakton politikat dhe strategjitë pas konsultimit me Sport Ireland; Sport Ireland më pas zbaton politikat (planin pesë ose dhjetëvjeçar) duke shpërndarë detyrat tek nën-divizionet dhe Organet Kombëtare Drejtuese (NGB) të menaxhuara nën ombrellën e Sport Irlandës. | Politika Kombëtare e Sportit 2018-2027<br>Akti i "Sport Ireland" 2015 |
| 12. Shënim | - Struktura veçanërisht e qartë dhe sistemi i autoritetit nën Sport Ireland thjeshtojnë situatën e ndërlikuar në sektorin e sportit. | Politika Kombëtare e |

| | | |
|---|---|---|
| | - Sport Ireland ka pushtet mbi... federatat, kodi i qeverisjes së mirë | Sportit 2018-2027<br>Akti i "Sport Ireland" 2015 |
| 13. Struktura e Qeverisjes | - Shih grafikun dhe listën e agjencive më poshtë:<br><br>- Departamenti i Transportit, Turizmit dhe Sportit, Sport Ireland, Këshilli Olimpik i Irlandës, Paraolimpiada Irlandë, Federatat e Sportit Irlandez.<br><br>- Qeveria mund t'i japë një drejtim ose të kërkojë që Sport Ireland të respektojë politikat e caktuara, ndërsa Sport Ireland nuk lidh kontrata ose marrëveshje nëse termat ose kushtet e saj nuk janë në përputhje me politikën e qeverisë ose funksionin e Sport Ireland (Pjesa 2 Kapitulli 1 Neni 12).<br><br>- Sport Ireland do të dorëzoj strategjinë për miratim nga Ministri çdo pesë vjet (Pjesa 2 Kapitulli 1 Neni 15) duke ndjekur kriteret. Sport Ireland gjithashtu duhet t'i paraqesë ministrit raporte vjetore çdo vit.<br><br> | Politika Kombëtare e Sportit 2018-2027 |
| 14. Linjat e përgjegjësisë dhe llogaridhënies | - Si agjenci kryesore për të monitoruar dhe koordinuar nismat dhe veprimet e qeverisë, Ministri ka fuqinë t'i japë drejtim Sport Irlandës për të respektuar politika të tilla të qeverisë siç është specifikuar.<br>- Sport Irlanda nuk do të hyjë në një kontratë, marrëveshje apo të pranojë një sponsorim ku ajo do të ishte e papajtueshme me politikën e qeverisë dhe sport Irlanda funksionit.<br>- Nëse ministri kërkon, Sport Ireland duhet të japë 1) këshilla për çdo çështje të lidhur me funksionin e Sport Ireland, 2) informacion në lidhje me ecurinë e Sport Ireland.<br>- Sport Ireland ka nevojë për të siguruar një raport vjetor që deklaron arritjen dhe ecurinë e vitit pas përfundimit të çdo viti financiar.<br>- Ministri mund të vendosë për emërimin e shefit ekzekutiv të Sport Ireland të caktuar para se të emërohen shefat e rinj. | |

| | | |
|---|---|---|
| | - Zgjedhja e Bordit të Sport Irlandës nuk është specifikuar në Aktin e Irlandës Sportive apo Kodin e Qeverisjes. Por Kodi shpjegon në mënyrë specifike detyrën dhe përgjegjësitë e anëtarëve të bordit.<br>- Autoritetet lokale, OJQ-të dhe Partneritetet mbështesin punën e OJQ-ve së bashku me klubet e bazuara në komunitet, shkollat dhe institucionet e arsimit të lartë. | |

**Republika e Kroacisë**

| Fushat e Krahasimit | Karakteristikat dhe përshkrimi | Materialet dhe Dokumentet përkatëse |
|---|---|---|
| 1. Korniza Strategjike | - Strategjia sportive e Kroacisë ndjek aktin sportiv të vitit 2007 siç kërkohet me Nenin 2 "Programi kombëtar i sportit përcakton qëllimet dhe detyrat në lidhje me zhvillimin e sportit dhe aktivitetet e nevojshme...".<br>- Programi kombëtar i sportit duhet të përfshijë: 1) programet që krijojnë kushte për aktivitete sportive në sistemin arsimor; 2) për arritjen e rezultateve të nivelit të lartë në garat ndërkombëtare; 3) aktivitetet sportive rekreative.<br>- Programi do të përcaktojë detyrimet e organeve shtetërore dhe organeve rajonale vetëqeverisëse, Komitetit Olimpik Kroat, Komitetit Paralimpik, federatave kombëtare sportive dhe komuniteteve sportive, dhe qytetit të Zagrebit për të arritur qëllimet e përcaktuara.<br>- Si financuese, Ministria e Sportit do të pranoj raporte mbi zbatimin dhe arritjen e programit. | Programi Kombëtar i Sportit 2019-2026<br><br>Ligji i Sportit 2007 Neni 2 |
| 2. Korniza Ligjore | - Kuadri rregullator i sportit kroat konsiderohet si pararojë e vendeve reformiste për të harmonizuar legjislacionin e tyre me kuadrin ligjor të BE-së, për vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe shpesh merret si shembull i suksesshëm nga shtetet e tjera në rajon (p.sh. Serbia).<br>- Kuadri ligjor përdor një akt, Ligjin e Sportit 2007 për të mbuluar aspektet ligjore të shumicës së çështjeve të ndërlidhura me sportin, përfshirë institucionet relevante për sportin, punën profesionale në sport, garat, hapësirat sportive, shëndetin dhe antidopingun, financimin, menaxhimin e informacionit, çmimet shtetërore në sport, mbikëqyrjet ligjore, dispozitat ndëshkimore.<br>- Ligji i ri i Sportit përmban një funksion social duke synuar një shumëllojshmëri subjektesh, përfshirë personat fizikë (sportistët, trajnerët, personat që punojnë në sport), personat | (Šuput, 2007)<br><br>Ligji i Sportit i vitit 2007 |

| | | |
|---|---|---|
| | juridikë (asociacionet, palët dhe institucionet ekonomike, klubet) dhe shoqëritë sportive shkollore.<br>- Një akt i tillë gjithëpërfshirës krijoi një mjedis miqësor për sektorin e sportit dhe lehtësoi punën e përditshme të sportit në të gjitha nivelet, pasi klubet amatore gjithashtu kërkohen nga standardet ligjore dhe organizative. | |
| 3. Struktura institucionale & statusi i federatave dhe klubeve sportive | - Këshilli Kombëtar i Sporteve është organi më i lartë profesional për sport në Kroaci. Ai ofron udhëzime dhe jep propozime për Programet Kombëtare Sportive dhe Prioritetet për sportin në vend.<br>- Këshilli Kombëtar i Sporteve ka 12 anëtarë dhe një president. Ai përbëhet nga gjashtë anëtarë të emëruar nga Qeveria e Republikës së Kroacisë, tre anëtarë të propozuar nga Komiteti Kroat i Lojërave Olimpike dhe nga një anëtar nga Komiteti Paralimpik Kroat, Shoqata Kroate e Sporteve të Shurdhërve dhe Fakulteti i Kinesiologjisë të Universitetit të Zagrebit.<br>- Këshilli Kombëtar i Sportit i përgjigjet parlamentit kroat dhe paraqet një raport në këtë institucion të paktën një herë në vit.<br>- Ligji i Sporteve i vitit 2007 përcakton rregullat dhe kriteret ligjore për personat fizikë, personat juridikë dhe shoqëritë sportive shkollore.<br>- Komiteti Olimpik Kroat është shoqata më e lartë kombëtare sportive joqeveritare dhe vepron në mënyrë të pavarur. Përgjegjësia kryesore e KOK-ut është të promovojë sportin, të marrë pjesë në propozimet dhe zbatimin e zhvillimit të sportit, si dhe sigurojë harmonizimin ndërmjet ODK-ve, komuniteteve sportive të qarkut dhe qytetit të Zagrebit.<br>- KOK-u është kompetent për arbitrazhin dhe zgjidhjen e kontesteve të lidhura me sportin me Këshillin e Arbitrazhit Sportiv (i cili është pjesë e KOK-ut). KOK-u ka kompetencën të vendosë lidhur me kërkesat për rishikime të jashtëzakonshme të vendimeve të marra nga ODK-të dhe palët e tjera, si dhe siguron që të drejtat e palëve sportive të mund të ushtrohen lirisht, përveç nëse kontestet mund të zgjidhen vetëm nga një gjykatë e rregullt. | Ligji i Sportit i vitit 2007 |
| 4. Ofrimi i shërbimeve ose procesi i licencave | Për federatat:<br>- Statusi juridik i organizatave dhe federatave nuk shpjegohet shprehimisht në Akt.<br>- Siç ceket në Programin Kombëtar të Sportit, federatat kombëtare të sportit janë nën përgjegjësinë e KOK-ut dhe janë përgjegjëse për zbatimin e programit të sportit.<br>- Federatat sportive regjistrohen dhe drejtohen nga Regjistri i shoqatave (së bashku me organizata të tjera arsimore, sociale, kulturore, shkencore, teknike dhe profesionale në vend).<br>- Për të aplikuar për regjistrim duhet të dorëzohen këto dokumente: procesverbali i kuvendit themelues, vendimi i kuvendit, lista e themeluesve, të dhënat personale të miratimit | Ligji i Sportit 24 |

| | | |
|---|---|---|
| | të përfaqësisisë së organit kompetent për performancën, etj. (referojuni faqes në internet të regjistrit në të djathtë).<br><br>Për klubet:<br>- Zyra Qendrore Shtetërore e Sportit mban Regjistrin për klubet profesionale.<br>- Akti prezanton shoqëritë aksionare të sportit (SHAS) në sportet konkurruese në përputhje me modelin e BE-së për përshkrimin e veçorive të sportit.<br>- Është detyrim shndërrimi i klubeve profesionale në SHAS, ndërsa edhe klubet e tjera mund ta bëjnë këtë vullnetarisht.<br>- Një formë e tillë e re do t'u mundësojë klubeve sportive profesionale të hapen në tregjet e kapitalit dhe të prezantojnë praktika më transparente në klubet sportive.<br>- Si rezultat, ky sistem u mundëson klubeve të rrisin transparencën e tyre, siç kërkohet nga organizatat ndërkombëtare sportive.<br>- Në këtë rast klubet sportive mund të kenë status profesional ose amator.<br>- Statusi profesional është për klubet që synojnë garat, ku mbi 50 për qind të sportistëve në një garë seniorësh menaxhohen nga federata kombëtare e sporteve. Klubet profesionale duhet të regjistrohen edhe në 'Regjistrin e Klubeve Sportive Profesionale' që menaxhohet nga ministria dhe vendimi do të merret brenda një muaji. | |
| 5. Koncepti sportiv | - Ligji i Sportit përcakton "Aktivitetet Sportive" si më poshtë:<br>- pjesëmarrje në garat sportive,<br>- përgatitje sportive,<br>- rekreacion sportiv,<br>- mësimdhënie sportive,<br>- organizimin dhe menaxhimin e garave sportive, dhe<br>- menaxhimin dhe mirëmbajtjen e objekteve sportive<br><br>Kroacia i kushton fokus të veçantë sportit elitar dhe sportit shkollor/rinor, por gjithashtu përfshin marrjen parasysh të sportit për të gjithë. | Ligji i Sportit Neni 18 |
| 6. Infrastruktura sportive | - Ligji i Sportit kërkon ndërtimin e objekteve të reja dhe mirëmbajtjen e objekteve sportive ekzistuese.<br>- Ligji ndalon gjithashtu prishjen e objekteve sportive ose shndërrimin e tyre në lloje të tjera ndërtesash ose për qëllime të tjera. | Ligji i Sportit Neni 18 |
| 7. Mbështetja financiare në seksionin e sportit (financim) | - Financimi për të mbështetur strategjitë e sportit sigurohet nga ministria përgjegjëse për çështjet e sportit.<br>- Anëtarësimet e siguruara nga asociacionet sportive janë baza e financimit të sportit për personat në aktivitete sportive.<br>- Nevojat publike për shoqata studentore dhe universitet i propozohen ministrit nga Federata Kroate e Sporteve | Ligji i Sportit Neni 2 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | Universitare. Nevojat publike për të rinjtë dhe fëmijët propozohen nga Federata Kroate e Sporteve Shkollore. Nevojat publike gjithashtu propozohen edhe nga komunitetet sportive.<br>- Nevojat publike përkufizohen si programe dhe aktivitete që janë të rëndësishme për njësinë vetëqeverisëse. | |
| 8. | Sponsorizimi | - Pa u përmendur veçanërisht si pjesë, Neni 23 thekson se klubet dhe kompanitë janë bashkëpërgjegjëse për detyrimet që rrjedhin nga aktivitetet e tyre afariste. | Ligji i Sportit Neni 23 |
| 9. | Luftimi i dukurive negative në sport | - Qeveria e Kroacisë ka juridiksionin për të krijuar Agjencinë Kroate Anti-Doping, dhe Agjencia është përgjegjëse drejtpërdrejt tek Ministria e Shkencës, Arsimit dhe Sportit për punën e saj.<br>- Neni 72 i Ligjit të Sportit vendos ndalesë për dopingun në sport, duke u harmonizuar me rregulloren e kodit WADA.<br>- Agjencia kundër dopingut është themeluar nga qeveria edhe pse nuk është krijuar një ligj i veçantë për të. Kroacia plotëson pyetësorin për zbatimin e politikave antidoping nga Këshilli i Evropës.<br>- Ligji (neni 86) rregullon gjithashtu dënimin për shkelësit, e cila është një gjobë nga 30.000,00 deri në 100,000,00 kuna kroate.<br>- Detyrat kryesore të Agjencisë janë: 1) ndjekja dhe koordinimi sistematik i aktiviteteve antidoping të institucioneve qeveritare dhe joqeveritare;<br>2) Të propozojë dhe zbatojë masa të ndryshme në lidhje me luftën kundër dopingut në sport;<br>3) Të zbatoj konventat, rregulloret e WADA-s (Kodi Botëror Anti-Doping) dhe rregullat anti-doping të asociacioneve ndërkombëtare sportive dhe Komitetit Olimpik Ndërkombëtar.<br>Agjencia harton "Statutin e Agjencisë Kroate Anti-Doping". | Ligji i Sportit 2007, Nenet 72, 73, 86 |
| 10. | Edukimi dhe promovimi | - Sipas nenit 59, edukimi sportiv kategorizohet në pjesën e punës profesionale në sport, për të siguruar sjellje të shëndetshme, efikase dhe profesionale në sport.<br>- Një plan arsimor më i detajuar është specifikuar në programin më të fundit kombëtar të sportit. | Ligji i Sportit, Nenet 59, 60 Programi Kombëtar i Sportit 2019-2026 |
| 11. | Monitorimi i zbatimit të ligjit | - Programi Kombëtar i Sportit përcakton detyrimet e organeve shtetërore, organeve të vetëqeverisjes lokale dhe rajonale dhe qytetit të Zagrebit, Komitetit Olimpik Kroat, Komitetit Paralimpik Kroat, Asociacionit Kroat të Sporteve të Shurdhërve, federatave kombëtare sportive dhe komuniteteve sportive në funksion të arritjes së qëllimeve të përcaktuara.<br>- Si përgjigje, organet e sipërpërmendura duhet t'i raportojnë këshillit kombëtar dhe ministrisë pas zbatimit. | Ligji i Sportit, Neni 2.4 |

| | | |
|---|---|---|
| 12. Shënim | - Veçantia e Ligjit Kroat për Sportin është harmonizimi i tij me ligjin e BE-së dhe struktura e ngritur e Këshillit Kombëtar të Sporteve.<br>- Së dyti është vënia e theksit të veçantë tek të rinjtë, fëmijët dhe sporti shkollor. | Ligji i Sportit 2007 |
| 13. Struktura e Qeverisjes | - Shihni figurën më poshtë.<br>- Agjencitë përkatëse: Këshilli Kombëtar i Sportit, Ministria e Shkencës, Arsimit dhe Sportit, Agjencia Antidoping, Komiteti Olimpik Kroat, Komiteti Paralimpik, Federatat Sportive të Personave të Shurdhër, Federatat Sportive të Personave me Aftësi të Kufizuara, Federatat Kombëtare të Sportit, etj.<br>- Këshilli Kombëtar i Sportit është organi më i lartë për zhvillimin e sportit në Kroaci. Ai zhvillon dhe përcakton prioritetet në sport për qeverinë. Megjithatë, puna administrative kryhet nga Ministria. KKS është përgjegjës për miratimin e akteve nënligjore dhe rregullon funksionimin e saj. Komiteti Olimpik Kroat ka kompetencën për të dhënë autoritet publik për përcaktimin e kategorive të atletëve. KOK ka gjithashtu një vend të përhershëm në Komitetin e Klubeve Sportive Profesionale dhe tre vende të përhershme në Këshillin Kombëtar të Sporteve (Neni 4).<br><br> | Ligji i Sportit 2007, Neni 4 |
| 14. Linjat e përgjegjësisë dhe llogaridhënies | - ODK-të i raportojnë Komitetit Olimpik Kroat lidhur me performancën dhe përparimin në zhvillimin e sportit, ndërsa Komiteti Olimpik Kroat nuk ka shumë kompetenca rregullatore mbi to. Kompetenca është në duart e Ministrisë dhe Këshillit Kombëtar të Sportit. | Akti i Sportit 2007 Neni 49 |

| | | |
|---|---|---|
| | - Këshilli Kombëtar vendos për politikat dhe orientimin e zhvillimit të sportit, si dhe Komiteti Olimpik Kroat bënë zbatimin e politikave me Federatat Nacionale të Sportit dhe organizatat tjera sportive drejtë zbatimit të programit nacional. | |
| 15. Standardet e Qeverisjes | - Akti i Sportit i vitit 2007 nuk përfshin kodin e qeverisjes në sport, the nuk ka dokumente apo akte normative në lidhje me këtë.<br>- Megjithatë, klubet sportive i kushtojnë vëmendje dokumentit të Këshillit të Evropës përkatësisht rekomandimeve "Promovimi i Qeverisës së mirë në Sport". | Promovimii Qeverisjes së mirë në Sport |

- **Sllovenia**

| **Fushat e Krahasimit** | **Karakteristikat dhe përshkrimi** | **Materialet dhe Dokumentet përkatëse** |
|---|---|---|
| 1. Korniza Strategjike | - Rezoluta e re për Programin Kombëtar të Sportit të Republikës së Sllovenisë 2014-2023 është shpallur si reformë nga qeveria.<br>- Ajo promovon vizionin që sporti duhet të mbetet një pjesë e rëndësishme e kulturës kombëtare, përfshirë shtatë grupe objektivash.<br>- Programet sportive, objektet sportive, aktivitetet zhvillimore për të gjithë individët, organizimi i sportit, ngjarjet sportive, përgjegjësia sociale e sportit dhe mekanizmat mbështetës në sport.<br>- Një ligj i ri për Sportin u krijua më pas në vitin 2017.<br>- Synimi dhe motivimi kryesor për programin kombëtar janë frymëzuar nga ekzistenca e mangësive në sistemin e mëparshëm në ofrimin e shëndetit dhe kujdesit të aksesueshëm për sportistët në të gjitha nivelet dhe zbatimin e sportit në shkollë, përdorimin racional të fondeve publike, problemet me sportet elitare, menaxhimin e informacionit dhe ndikimit të zvogëluar të shoqërisë civile në vendimmarrje për sportin.<br>- Komiteti Olimpik planifikon, organizon dhe ekzekuton programe në tre shtylla: Sport për të gjithë, Sport në nivel komune dhe Top Sport.<br>- Ministria e Arsimit dhe Sportit administron financimin dhe planifikimin e objekteve sportive. | Programi Kombëtar i Sportit në Republikën e Sllovenisë 2014-2023<br><br>(Jagodic, 2010) |
| 2. Korniza Ligjore | - Ligji i Sportit i vitit 2017 mbulon aspektet ligjore të të gjitha çështjeve përkatëse në sportin e vendit.<br>- Ligji u krijua për të mundësuar zhvillimin e njëkohshëm për sportin, për të ofruar mbrojtje më të mirë për pjesëmarrësit në aktivitete sportive, rregullore për sportistët kryesorë, financimin dhe kriteret për 'programin kombëtar', komunikimin midis qeverisë dhe organizatave joqeveritare (Neni 8).<br>- Programi Kombëtar i Sportit mbulon zbatimin e orientimeve afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata. | Ligji i Sportit 2017 |

| | | |
|---|---|---|
| 3. Struktura institucionale & statusi i federatave dhe klubeve sportive | - Në Slloveni, sporti konsiderohet një sektor shumë i kontrolluar, pasi Akti për Sportet (neni 5) parasheh që Programi Kombëtar i Sllovenisë mund të pranohet vetëm nëse arrihet konsensus me Komitetin Olimpik Slloven - Shoqatën e Federatave të Sportit (KOS-AFS) (Lipicer, 2007).<br>- KOS-AFS është organizata sportive ombrellë që i lidh federatat sportive kombëtare, komunale dhe të tjera të cilat udhëheqin me sportin<br>- Këshilli i Ekspertëve dhe Komiteti Olimpik janë në krye të strukturës hierarkike, me federatat kombëtare, federatat sportive komunale dhe klubet nën to.<br>- Këshilli i Ekspertëve është përfshirja e shoqërisë civile.<br>- Në kategorinë e instituteve publike të sportit mund të jetë bashkësia lokale për kryerjen e punëve profesionale, organizative, teknike, administrative dhe të punëve të tjera në sport.<br>- Institutet publike kanë përgjegjësinë për të zbatuar programet vjetore sportive, për të kryer planifikimin për objektet publike dhe për mbledhjen e të dhënave që kanë të bëjnë me sportin. | Ligji i Sportit, Neni 45 |
| 4. Ofrimi i shërbimeve ose procesi i licencave | Për federatat:<br>- Institutet publike mund të themelohen nga shteti ose komuniteti lokal.<br>- Të jesh i regjistruar si institut publik do të thotë që duhet kryer detyra të caktuara, si monitorimi dhe mbështetja e zbatimit të programit vjetor, mbledhja e të dhënave të nevojshme dhe dhënia e ndihmës organizative.<br>- Nuk jepen informata të mëtejshme në lidhje me regjistrimin e klubeve dhe procedurën e licencimit.<br>- Një statut i disponueshëm publikisht i organizatës së e-sportit në Slloveni tregon se organizatat duhet të dorëzojnë një rregull dhe kod kur regjistrohen.<br><br>Për klubet:<br>- Një klub duhet regjistruar me Aktin për drejtimin e shoqërisë dhe ta ketë sportin të përkufizuar si veprimtarinë kryesore në aktin e themelimit.<br>Klubet gjithashtu regjistrohen si anëtarë të asociacionit të klubeve dhe KOS-AFS. | Ligji i Sportit, Neni 45 |
| 5. Koncepti sportiv | - Rekreacioni sportiv nënkupton forma të ndryshme të aktivitetit fizik sportiv me qëllim ruajtjen e shëndetit, mirëqenies dhe vitalitetit, integrimit social dhe garimit apo argëtimit.<br>- Sporti elitar nënkupton programe për përgatitjen dhe konkurrencën e sportistëve elitarë të fokusuar në arritjen e rezultateve më të mira sportive në nivel ndërkombëtar.<br>- Edukimi fizik i fëmijëve dhe të rinjve gjatë kohës së lirë nënkupton aktivitetet sportive që shtojnë aktivitetet fizike në periudhën parashkollore, edukimin fizik shkollor dhe programet | Ligji i Sportit, Neni 2 |

| | | |
|---|---|---|
| | sportive jashtëshkollore të destinuara për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë.<br>- Në këtë fazë, ligji thekson mirëqenien dhe mbarëvajtjen e të gjithë pjesëmarrësve në aktivitetet sportive, por veçanërisht të sportistëve. | |
| 6. Infrastruktura sportive | - Ligji i Sportit e përkufizon objektin sportiv dhe konkretizon kriterin për ngritjen e objektit sportiv: strukturën e ndërtimit, pajisjen funksionale të tij, | Ligji i Sportit, Nenet 67-71 |
| 7. Mbështetja financiare në seksionin e sportit (financimi) | - Financimet mund të aplikohen duke kontribuar në zbatimin e programit vjetor të sportit dhe aplikimi duhet të dorëzohet në një tender publik.<br>- Plani i zbatimit përcaktohet nga Ministri pas marrjes së opinionit të KOS-AFS-së dhe Këshillit të Ekspertëve.<br>- Mjetet për t'i shërbyer interesit publik sigurohen nga buxheti kombëtar, buxhetet e komuniteteve lokale, Fondacioni për Sport, donacionet, sponsorizimet dhe nga burime të tjera.<br>- Lojërat e fatit përfaqësojnë një burim financimi që shfrytëzon llotaritë për të mbështetur politikën kombëtare sportive, duke siguruar funksionimin e organizatave sportive. | Ligji i Sportit. 5, 16, 17 |
| 8. Sponsorizimi | - Nuk ofrohen detaje për të në Ligjin e Sportit, por më hollësisht shpjegohet në Programin Kombëtar të Sportit në Slloveni.<br>- Programi kombëtar thekson se shumica e sporteve të nivelit të lartë në Slloveni nuk janë atraktive për sponsorizimin, por lidhja midis ngjarjeve sportive dhe medias është burim i përhapur i sponsorizimit. | Programi Kombëtar i Sportit në Slloveni 2014-2023 |
| 9. Luftimi i dukurive negative në sport | - Ligji i Sportit ka vetëm një pjesë mbi "parimet e përgjithshme të sjelljes në sport", i cili përmend disa shembuj të sjelljes së pahijshme.<br>- Megjithatë, në programin kombëtar përmenden aspekte specifike të çështjeve etike në sport.<br>- Organizata Anti-Doping është themeluar nga Komiteti Olimpik Kombëtar.<br>- "Rregulli i kontrollit të dopingut dhe verifikimit gjinor" është krijuar në vitin 1996, i cili e përcaktonte dopingun nga Komiteti Kombëtar Anti-Doping. Në vitin 2009, u prezantua Komisioni Kombëtar Anti-Doping 2009 (i njohur më vonë si Organizata Anti-Doping). | Ligji i Sportit 2017, Neni 3<br>Programi Kombëtar i Sportit në Slloveni 2014-2023 |
| 10. Edukimi dhe promovimi | - Ministri ka të drejtë të përcaktojë kushtet, kriteret, përmbajtjen e detyrueshme, kohëzgjatjen, format dhe mënyrën e trajnimit dhe vlerësimin e trajnimit.<br>- Të gjitha programet e trajnimit për punëtorët profesionistë rregullohen dhe institucionalizohen nga shteti.<br>- Edukimi i sportistëve nuk theksohet në Ligjin e Sportit por më shumë në Programin Kombëtar. | Ligji i Sportit, Neni 50 |

| | | |
|---|---|---|
| 11. Monitorimi i zbatimit të ligjit | - Vendimet merren nga Këshilli i Ekspertëve dhe Komiteti Olimpik Kombëtar dhe zbatohen nga federatat dhe klubet kombëtare, lokale dhe komunale.<br>- Për vendimmarrjen e ekspertëve dhe ndihmën e ekspertëve në vendimmarrje, qeveria krijon këshillin e ekspertëve. Përgjegjësitë kryesore përfshijnë dhënien e mendimeve për ligjet e propozuara dhe dhënien e një mendimi ekspert për çështjet që kanë të bëjnë me sportin. Një herë në vit, këshilli i ekspertëve mban shënim për raportet për zbatimin e programit kombëtar dhe për inspektoratin përgjegjës për sportin.<br>- Këshilli i Ekspertëve përbëhet prej 17 anëtarëve të emëruar nga qeveria e që janë ekspertë të aftë në fushën e sportit. Gjashtë nga ta emërohen nga OCS-ASF (dy në sportet individuale, dy në sportet ekipore, dy në të gjitha sportet, një propozohet nga NPC Sllovenia dhe një propozohet nga SUSA.<br>- Mandati i Këshillit të Ekspertëve është pesë vjet. | Ligji i Sportit 2017 |
| 12. Shënim | - Sistemi sportiv i Sllovenisë u reformua për të vënë më shumë të drejta të sportistëve në pah, ndërsa çështje të tjera relevante, si arsimi, sponsorizimi, antidopingu dhe procesi i licencimit të klubeve, nuk përmenden me Ligjin e fundit.<br>- | Ligji i Sportit 2017 |
| 13. Struktura e Qeverisjes | - Shihni figurën më poshtë.<br>- Agjencitë përkatëse: Drejtorati i Sportit, Këshilli i Ekspertëve të Sportit, Federatat Kombëtare të Sportit, Asociacionet dhe Klubet Sportive, Komiteti Olimpik Kombëtar – Asociacioni i Federatave Sportive, Asociacionet e Sporteve Lokale.<br>- Këshilli i Ekspertëve është organ këshillëdhënës në Parlament për politikën e sportit. Ai ishte krijuar sepse Kushtetuta sllovene nuk e kishte përfshirë sportin në kuadrin e saj.<br>- Neni 5 i Ligjit të Sportit thekson se Komiteti Olimpik është përfaqësuesi kryesor kombëtar i organizatave sportive. | Ligji i Sportit 2017 |

| | | |
|---|---|---|
| |  | |
| 14. Linjat e përgjegjësisë dhe llogaridhënies | - OCS-ASF është organi ombrellë qeverisës i sportit që lidh federatat kombëtare, komunale dhe të tjera sportive që drejtojnë sportin.<br>- Nën Drejtorinë e Sportit dhe OCS-ASF, këshilli i ekspertëve gjithashtu i jep qeverisë opinionin e tyre për zhvillimin e sportit, megjithëse nuk i jepet asnjë autoritet faktik.<br>- Federatat kombëtare, federatat sportive komunale dhe klubet punojnë nën autoritetetin e OCS-ASF. | Sport Act 2007 Art. 49 |
| 15. Standardet e Qeverisjes | - Si Akti ashtu edhe Programi Kombëtar nuk përmendin asnjë standard të qeverisjes | |

## Republika e Maqedonisë së Veriut

| **Fushat e krahasimit** | **Veçoritë dhe përshkrimi** | **Materialet dhe dokumentet përkatëse** |
|---|---|---|
| 1. Korniza strategjike | Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të hartojë programin për zhvillimin e sportit për pesë vitet e ardhshme, duke përcaktuar qëllimet dhe prioritetet, projektimin e nevojave të specializuara, nivelet e fondeve dhe investimeve, zhvillimin e sportit dhe sportit universitar, mbështetjen | Ligji për Sport |

| | | |
|---|---|---|
| | shkencore dhe parandalimin e dhunës dhe dopingut në sport. | |
| 2. Korniza ligjore | - Ligji për Sport është një dokument ligjor gjithëpërfshirës që mbulon pothuajse të gjitha aspektet ligjore të sportit të Maqedonisë së Veriut, duke u përqendruar në përkufizimin e klubeve, sportistëve dhe personave që konsiderohen si pjesë e industrisë së sportit.<br>- Ligji për Sport përshkruan edhe licencimin dhe njohjen e klubeve sportive dhe federatave të sportit. | Ligji për Sport |
| 3. Struktura institucionale dhe statusi i federatave dhe klubeve sportive | - Qeveria e Republikës përcakton politikën dhe strategjitë, të cilat më pas ndiqen nga Komiteti Olimpik i vendit për zbatim.<br>- Komiteti Olimpik Maqedonas (KOM) është shoqata më e lartë joqeveritare dhe anëtarët përbërës janë federatat sportive të sporteve olimpike.<br>- Përgjegjësia e KOM-it përfshin pjesëmarrjen, ndihmën dhe krijimin e zhvillimit të sportit në Maqedoninë e Veriut, pjesëmarrjen në zhvillimin e programeve kombëtare, koordinimin e aktiviteteve me federatat kombëtare të sportit dhe përcaktimin e përbërjes së ekipeve olimpike maqedonase.<br>- Komunat dhe qyteti i Shkupit kanë përgjegjësi në zhvillimin e ngjarjeve masive sportive, si dhe përkrahin klubet sportive dhe sindikatat sportive në atë zonë.<br>- Organi shtetëror përgjegjës për sportin formon edhe një grup këshillimor ekspertësh, Këshillin e Sportit, për të përfshirë punëtorë të shquar profesionistë, shkencorë dhe të tjerë të shquar në fushën e sportit. Shtatë anëtarë emërohet nga organi i administratës shtetërore për sport me mandat katërvjeçar.<br>- Megjithatë, administrata shtetërore ka kompetencë të shkarkojë çdo anëtar të këshillit para datës së përfundimit të mandatit katërvjeçar.<br>- Këshilli i Sportit është i detyruar të japë mendime mbi menaxhimin e shpërndarjes së financimit dhe organin shtetëror përgjegjës për sportin. Këshilli i Sportit duhet të dorëzojë një raport së paku një herë në vit. | Ligji për Sport, nenet 17, 23 |

| | | |
|---|---|---|
| 4. Ofrimi i shërbimeve ose procesi i licencave | - Klubet sportive dhe federatat kombëtare të sporteve mund të luajnë sporte pasi t'u lëshohet vendimi dhe të konstatohet se i plotësojnë kushtet.<br>- Klubet sportive dhe federatat kombëtare të sporteve duhet të bëjnë kërkesë pranë administratës shtetërore që t'u lëshojë vendim për performancë sportive. Kërkesa duhet të përfshijë mënyrën e komunikimit, vendimet për regjistrim në Regjistrin qendror, transkriptin e Regjistrit të anëtarëve të grupit të tifozëve, statutin dhe dëshminë për ambientet e duhura të siguruara.<br>- Për një sport mund të krijohet vetëm një federatë kombëtare.<br>- Për qëllime të licencimit për kryerjen e punëve drejtuese në fushat e sportit, organi i administratës shtetërore i autorizuar për punë nga fusha e sportit organizon provim. | Ligji për Sport, nenet 11-14 |
| 5. Koncepti i sportit | - Sporti është veprimtaria që përfshin të gjitha format e aktiviteteve sportive të sportistëve të të gjitha moshave, si dhe aktivitetet sportive dhe rekreative të qytetarëve. | Ligji për Sport |
| 6. Infrastruktura e sportit | - Ligji për Sport kufizon rreptësisht objektet sportive në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe komunave që përdoren vetëm për arsye sportive.<br>- Organi qeveritar përgjegjës për sportin miraton një 'rregullore' për kategorizimin e objekteve sportive për realizimin e interesit publik – duke siguruar gara sportive cilësore si në nivele të performancës së lartë, ashtu edhe në nivel rekreativ.<br>- Me rastin e shfrytëzimit të pjesëve të objekteve sportive me rëndësi kombëtare, prioritet u jepet ekipeve kombëtare dhe klubeve që garojnë në nivel ndërkombëtar dhe në kampionatin më të lartë sportiv të vendit.<br>- Organi qeveritar përgjegjës për sportin ka kompetencë të investojë, të mirëmbajë dhe të planifikojë ndërtimin e objekteve të reja në pronësi të komunave dhe qytetit.<br>- Komunat mund të krijojnë partneritet publiko-privat për menaxhimin e objekteve të reja. | Ligji për Sport, nenet 62, 63 |

| | | |
|---|---|---|
| 7. Mbështetja financiare në sektorin e sportit (financimi) | - Qeveria përcakton shpërndarjen e fondeve pasi të marrë një mendim nga këshilli i sportit në bazë të listës së kritereve të financimit.<br>- Organizatat (ODK-të, klubet, sportistët aktivë individualë, personat juridikë që kanë marrë vendim për ushtrimin e veprimtarisë sportive) mund të përdorin lirimet tatimore si fonde për sa vijon:<br>1. Pagat për sportistët<br>2. Organizimi ose akomodimi për garat vendore dhe ndërkombëtare<br>3. Marrja me qira ose ndërtimi i sallave sportive<br>4. Pagesat e qirasë të lokaleve afariste për funksionimin e klubit<br>5. Pagesat e kredive për blerjen e objekteve për klubin<br>6. Pagesat e komunalive<br>7. Kujdesi shëndetësor, pensioni<br>8. Organizimi i garave ndërkombëtare në Maqedoninë e Veriut.<br>- Këshillat komunalë hartojnë një Rregullore për shpërndarjen e mjeteve, përkatësisht për mënyrën e shpërndarjes së mjeteve për subjektet. Mjetet do të financohen nga buxheti i komunave dhe qyteti i Shkupit.<br>- Aleanca sportive e mbështetur nga buxheti i qeverisë mbështet federatat dhe klubet kombëtare sportive lidhur me:<br>1. Organizimet e ligës vendase,<br>2. Organizimin e garave ndërkombëtare<br>3. Financimin e trajnerëve të lartë<br>4. Blerjen e automjeteve të specializuara dhe pagat | Ligji për Sport, neni 14 |
| 8. Sponsorizimi | - Nuk shpjegohet shprehimisht në Ligjin për Sport | Ligji për Sport |
| 9. Luftimi i dukurive negative në sport | - Ligji shpjegon pajtueshmërinë me Konventën për kontrollin antidoping në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në administratën shtetërore do të themelohet një komision antidoping. | Ligji për Sport, neni 55 |
| 10. Edukimi dhe promovimi | - Nuk përmendet në Ligjin për Sport | Ligji për Sport |

| | | |
|---|---|---|
| 11. Monitorimi i zbatimit të ligjit | - Administrata qeveritare përgjegjëse për sportin monitoron ligjshmërinë e punës së komunave dhe performancën e tyre, si dhe jep sugjerime dhe rekomandime për veprim.<br>- Qeveria përgjegjëse për sportin monitoron edhe përfshirjen e publikut në punën e komunave. | Ligji për Sport |
| 12. Linjat e pushtetit dhe llogaridhënia | - Komiteti Olimpik Kombëtar është organi ombrellë drejtues i sportit që lidh federatat kombëtare, komunale dhe të tjera sportive që udhëheqin me sportin.<br>- Këshilli i ekspertëve gjithashtu i jep qeverisë mendimin e tyre lidhur me zhvillimin e sportit, por nuk ka ndonjë pushtet real.<br>- Federatat kombëtare, federatat sportive komunale dhe klubet i raportojnë Komitetit Olimpik.<br>- Komunat i raportojnë administratës shtetërore përgjegjëse për sportin. | Ligji për Sport |
| 13. Standardet e qeverisjes | - The Ligji për Sport nuk përmend ndonjë standard qeverisjeje. | Ligji për Sport |

Grupi punues për hartimin e Koncept Dokumentit ka shqyrtuar tri opsione me synim të arritjes së objektivave, të përcaktuara në kapitullin 2. Opsioni i parë është status quo, ose opsioni pa asnjë ndryshim. Opsioni i dytë është opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit të kornizës ligjore në fuqi. Opsioni i tretë është Ligji i ri i veçantë për fushën e Sportit, ndryshimi dhe plotësimi i ligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dukurive negative në sport, Strategjia e Sportit në kombinim me masa zbatuese të ngritjes së kapaciteteve si dhe rekomandimet për ndryshimet në aktet tjera ligjore me qëllim të harmonizimit.

Kapitulli 3.1: Opsion asnjë ndryshim

Opsioni i parë i shqyrtuar nga grupi punues është opsioni pa asnjë ndryshim. Me këtë opsion, korniza ligjore për Sport do të mbetej në fuqi pa asnjë ndryshim çka nënkupton se kompetencat, të drejtat dhe përgjegjësitë e institucioneve dhe palëve përgjegjëse për zbatim do të mbeteshin të pa definuara në kornizën ligjore në fuqi.

Vazhdimi i gjendjes ekzistuese do të konsistojë në kapacitetet e limituara të të gjitha niveleve të institucioneve publike, organizatave sportive, sportistëve dhe trajnerëve të cilët ndikohen drejtpërdrejtë nga ky koncept dokument. Stafi arsimor do të mbetej po ashtu me kapacitete të limituara për të nxitur pjesëmarrjen në sport dhe mësuar nxënësit në mënyrë të duhur që të praktikojnë disiplina të ndryshme sportive në ambiente të sigurta.

Infrastruktura fizike sportive ekzistuese do të vazhdoj të përkeqësohet si dhe nuk do të jetë në dispozicion dhe funksion të sportit dhe shfrytëzimit racional. Planifikimi i duhur i infrastrukturës së re do të mbetet sfidë nga e cila drejtpërdrejtë do të prekej komuniteti i sportit.

Mos krijimi i mekanizmave të rinj do të shpie në moszbatim të ligjit ekzistues si dhe mos përcaktimi i rregullave dhe standardeve të qeverisjes së mirë do të cenonin të drejtat e sportistëve dhe organizatave sportive.

Mungesa e një baze të të dhënave/platformë digjitale do të vështirësoj procesin e identifikimit të nevojave, orientimit të buxhetit si për nga aspekti i infrastrukturës fizike sportive po ashtu edhe në identifikimin e nevojave për ngritje të kapaciteteve apo shfrytëzimin e potencialit të komunitetit sportiv.

Opsioni status quo, për më tepër rrezikon mos-shfrytëzimin e kapacitetit maksimal të përfaqësimit të Kosovës në rrafshin ndërkombëtar si dhe shpie në mungesë të nxitjes së pjesëmarrjes së shoqërisë në aktivitetin fizik.

Ligji aktual i Sportit nuk do të jetë në harmoni me kornizën ligjore në fuqi e cila kontribuon negativisht në dimensione të ndryshme duke nisur nga dispozita të paqarta ligjore, mos-qasje të duhur në infrastrukturën të sportit, të hyra të limituara nga fusha e sponsorizimit për federatat, shoqatat dhe klubet.

Në mungesë të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Arsimit, Shkencë dhe Teknologjisë, Ministrisë së Shëndetësisë, Komunave dhe palëve tjera të përfshira në proces, federatat dhe klubet e sportit do të vazhdojnë të ballafaqohen me sfida të natyrave të ndryshme përfshirë ngarkesat administrative.

Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit

Opsioni i dytë i shqyrtuar nga grupi punues është opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit. Ky opsion është shqyrtuar në drejtim të mos-ndryshimit të kornizës ligjore në fuqi respektivisht ligjit të sportit, marrë parasysh se Projektligji për Lirinë e Asociimit në Organizatat Jo-qeveritare është në proces të ndryshimit. Nisur nga fakti se ky projektligj për nga natyra është mjaft kompleks, ndryshimi dhe miratimi i të njëjtit mund të merrë kohë të konsiderueshme, ku rrjedhimisht reforma në sport do të pamundësohej.

Gjithashtu, ky opsion parasheh nxjerrjen e udhëzimeve operacionale të mënyrës së menaxhimit të objekteve sportive në të dy nivelet, në raport me nevojat e tyre për të evituar problemet praktike të identifikuara.

Përmes këtij opsioni, parashikohet ri-ndarja buxhetore për sektorin e sportit duke përcaktuar modelin që të buxheti për klubet e sportit dhe sektorin e sportit të ngritet, e cila do të përcillet me mekanizmat e monitorimit në të gjitha nivelet. Grupi punues po ashtu ka identifikuar që ky propozim i ri-ndarjes buxhetore pa ndryshime ligjore të ligjit dhe pa përcaktimin e bazës ligjore të standardeve të planifikimit, menaxhimit të infrastrukturës sportive do të ishte i mangët dhe do të paraqiste sfida në zbatim. Mos përcaktimi i standardeve dhe parimeve të qeverisjes së mirë në kornizën ligjore, do të qoj në përpjekje të dështuara.

Krijimi i një mekanizmi koordinues i përbërë nga përfaqësues të institucioneve të nivelit qendror, komunave, përfaqësues nga radhët e organizatave të sportit dhe profesionistë tjerë, do të lehtësonte deri në një masë bashkëpunimin në nivel të këtyre institucioneve, megjithatë përgjegjësitë ligjore do të mbeteshin të padefinuara dhe llogaridhënia do të mbetet sfidë në sektorin e sportit pa ndërhyrje në kornizën ligjore.

Po ashtu, krijimi i një baze të dhënave/platformë digjitale pa ndryshime në kornizën ligjore dhe pa përcaktimin e qëllimit të saj në raport me planifikimin dhe menaxhimin e të dhënave të sektorit të sportit, do të pamundësoj shfrytëzimin e këtij mjeti për avancimin e politikave dhe orientimin më të mirë të buxhetit në funksion të zhvillimit të sportit.

Ndërhyrja në projektligjin për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare për të ndryshuar procedurat e regjistrimit të federatave dhe klubeve, nuk do të zgjidhte problemin në tërësi, pasi që problemi i identifikuar në Koncept Dokument trajton mangësitë e dispozitave ligjore, aspektet e monitorimit, zbatimit dhe ekzekutimit të ligjit për sport në veçanti.

Promovimi dhe sensibilizimi i masës nuk arrin qëllimet e përcaktuara të këtij Koncept Dokumenti.

Rrjedhimisht, opsioni i përmirësimit të zbatimit dhe ekzekutimit nuk do të zgjidh problemin e Koncept Dokumentit pasi që:

- Ligji i sportit do të mbetet në fuqi i cili nuk do të reflektoj zhvillimet e fundit në fushën e sportit;
- Ligji aktual, nuk parasheh bazën ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore për rregullimin e mëtejmë të procedurave dhe proceseve të nevojshme për zhvillimin e sektorit të sportit;
- Mungesa e bazës ligjore për krijimin e mekanizmave të rinj sikurse organizatave ombrellë të sektorit të sportit minimizon rolin dhe të drejtat e sportistëve, trajnerëve dhe atyre që janë të përfshirë në sport;
- Mos përcaktimi i parimeve të qeverisjes së mirë do të kontribuoj në rritjen e trendit të dukurive negative në fushën e sportit;
- Përgjegjësitë e institucioneve do të mbeteshin të pa definuara mirë si dhe do të paraqiste vështirësi në forcimin e bashkëpunimit të institucioneve të nivelit qendror, komunave dhe sektorit të sportit në funksion të sportit;
- Federatat, klubet, sportistët, trajnerët dhe të gjithë të përfshirët në sektorin e sportit do të kenë vështirësi në zhvillimin e mëtejmë të sportit në mungesë të orientimeve të qarta dhe si shkak i moszbatimit të duhur të kornizës ligjore;
- Do të pamundësoj zhvillimin e politikave zhvillimore dhe koncepteve të sportit dhe zhvillimin e dimensionit socio-ekonomik;
- Mos ndryshimi i ligjit do të pamundësoj shfrytëzimin e kapaciteteve maksimale të sportistëve, trajnerëve dhe profesionistëve të sportit;
- Mos ndryshimi i kornizës ligjore do të rritë kostot për të siguruar menaxhim të infrastrukturës sportive;
- Do të dobësoj iniciativat e përmirësimit të sektorit si dhe ndikoj negativisht në rritjen e përkrahjes përmes sponsorizimeve;
- Pamundësoj krijimin e rregullave dhe standardeve për ngritjen e kapaciteteve njerëzore në të gjitha nivelet.

Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë

Opsioni i tretë i shqyrtuar nga grupi punues është opsioni i rekomanduar i cili përcakton ndërhyrjet përmes masave legjislative dhe masave zbatuese të kombinuara me veprime përcjellëse si në vijim:

3.3.1 Hartimi i një ligji të ri të sportit dhe krijimi i kornizës ligjore në funksion të zbatimit të tij;
3.3.2 Ndryshimi dhe plotësimi i ligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive në ngjarjet sportive;
3.3.3 Finalizimi dhe miratimi i Strategjisë së Sportit;
3.3.4 Rivlerësimi i modelit të financimit të sportit;
3.3.5 Ngritja e kapaciteteve njerëzore.

### 3.3.1 Hartimi i një ligji të ri për sport dhe krijimi i kornizës ligjore në funksion të zbatimit të tij

Siç u cek më lartë përmes hartimit të ligjit të ri për sport i cili është nevojë imediate për të reflektuar zhvillimet e fundit në fushën e sportit, synohet të arrihen çështjet si në vijim:

- Mundësimi i reformës së legjislacionit aktual dhe definimi i përgjegjësive të institucioneve/organizatave të të gjitha niveleve, organizatave sportive dhe palëve të përfshira në sektor;
- Përcaktimi i dispozitave ligjore të plota dhe eliminimi i mangësive të cilat kanë prodhuar dobësi në procesin e planifikimit, menaxhimit dhe monitorimit të sektorit;
- Përcaktimi i përkufizimeve të cilat mungojnë në ligjin ekzistues për të ofruar qartësi në zbatim;

- Krijimi i bazës ligjore për themelimin e mekanizmave përgjegjës dhe fuqizimin e organizatave sportive, federatave, klubeve, sportistëve trajnerëve etj;
- Koordinim më të mirë të sektorit dhe përfshirje e mekanizmave të fushës së sportit, shëndetësisë, sigurisë, planifikimit hapësinor, komunave dhe organizatave sportive në funksion të zhvillimit të sportit dhe respektimit të të drejtave të garantuara me ligj;
- Të definoj qartazi përgjegjësinë e komunave në zhvillimin e sportit;
- Përcaktimin e parimeve të qeverisjes së mirë dhe po ashtu përcaktimi i veprimeve në rastet e moszbatimit të tyre;
- Përcaktimi i kushteve dhe kritereve për licencimin e federatave, themelimin dhe regjistrimin e klubeve sportive;
- Përcaktimi i kushteve dhe kritereve për zhvillimin e sporteve specifike profesionale të cilat zhvillohen në formë të veçantë dhe të ndryshme nga sportet tradicionale;
- Përcaktimi i modelit të qëndrueshëm të financimit, instrumenteve ekonomike, burimet e ndryshme të financimit sikurse fusha e sponsorizimit;
- Planifikimi më i mirë i infrastrukturës fizike sportive dhe shfrytëzimi racional dhe mirëmbajtje më e mirë e palestrave dhe hapësirave të sportit;
- Nxisë pjesëmarrjen në sport dhe aktivitet fizik për të gjitha grupmoshat;
- Krijoj mundësi për shfrytëzimin maksimal të kapaciteteve të profesionistëve të fushës së sportit si dhe përkujdes për sportistët gjatë dhe pas karrierës së tyre sportive;
- Krijoj bazë të të dhënave/platformë e cila do të përditësohej dhe mirëmbahej në baza të rregullta dhe do të ofroj të dhëna të cilat do të shërbejnë për planifikim të politikave, orientim të buxhetit dhe zhvillim të sektorit si dhe do mundësoj identifikimin e nevojave për ndërhyrje;
- Rrisë potencialin për zhvillimin e dimensionit ekonomik përmes zhvillimit dhe avancimit të sportit;
- Përcaktimin e politikave zhvillimore dhe koncepteve të reja të fushës së sportit.

Ligji i ri i sportit do të njeh autonominë e plotë të pjesës jo-qeveritare të sportit. Megjithatë, ligji do të përcaktoj standarde dhe parime të qeverisjes së mirë duke i lënë fleksibilitet sektorit jo-qeveritar që ti arrij ato objektiva dhe qëllime pa ndërhyrje dhe interferim. Në këtë drejtim, Ligji për Lirinë e Asociimit në Organizata Jo-qeveritare do të zbatohet në plotni duke i shtuar elementet e qeverisjes së mirë dhe aspekte tjera sportive të cilat mundësojnë zhvillimin e përgjithshëm të sektorit të sportit.

Gjatë hartimit të ligjit të ri për Sport, Ministria do të ketë në konsideratë legjislacionin e Bashkimit Evropian për fushën e sportit të prezantuar në këtë Koncept Dokument. Gjithashtu, hartimi i ligjit të ri do të bëhet në harmoni me Ligjin për Barazi Gjinore, Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi si dhe do të përcaktoj mekanizmat për parandalimin dhe mbrojtjen e dukurive negative në sport përfshirë mbrojtjen nga dhuna fizike apo seksuale të cialt do të jenë parimet kryesore të qeverisjes së mirë.

Pra, në linjë me atë që u theksua më sipër përmbajtja e ligjit të ri për sport do të jetë si në vijim:

1. ***Qëllimi dhe Fushëveprimi***

- Ligji ri do të përcaktoj qëllimin e qartë i cili do të definoj qeverisjen e sistemit dhe aktiviteteve të sportit; punën profesionale të sportit; sportin garues; sportin rekreativ; sportin universitar dhe shkollor; sportin në komunitet; konceptet e reja të sportit; financimin e sportit; gjithëpërfshirjen dhe të drejtën për pjesëmarrje të barabartë pa diskriminim në sport dhe aktivitet fizik.

- Ligji do të përmbaj gjithashtu përkufizime për sportin si tërësi; organizatat sportive; federatat; klubet e sportit; OJQ-të të cilat e kanë në fushëveprim sportin por nuk ushtrojnë veprimtarinë e sportit *(OJQ-të e zakonshme)*; sportistin; trajnerët dhe instruktorët; si dhe konceptet e sportit si në vijim:
    - o Sigurinë në ambientin e sportit;
    - o Integritetin në sport;
    - o Sportin e sigurt, gjithëpërfshirës dhe i barabartë;
    - o Jetën e shëndetshme përmes aktivitetit fizik;
    - o Sportin elitar;
    - o Sportin për të gjithë;
    - o Diplomacinë sportive.
- Ligji gjithashtu do të përcaktoj llojet e infrastrukturës fizike të sportit.
- Ligji i ri, do të definoj gjithashtu fushëveprimin e tij dhe zbatueshmërinë e legjislacionit i cili ka të bëjë me: përpunimin dhe procesimin e të dhënave personale; lirinë e informacionit; barazinë gjinore, të drejtat e njeriut në sport; mbrojtjen nga diskriminimi; transparencën dhe menaxhimin e parasë publike.

Varësisht nga nevoja, grupi punues për hartimin e projektligjit mund të bëjë rregullime tjera shtesë me qëllim të zbatimit më të mirë të ligjit në praktikë.

### 2. ***Strukturat vendimmarrëse të institucioneve publike të nivelit qendror dhe atij lokal***

- Strukturat vendimmarrëse në kuadër të institucioneve të nivelit qendror për sa i përket hartimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave dhe legjislacionit do të rivlerësohen për të adresuar përgjegjësitë në Ligjin e Sportit. Rivlerësimi do të merr parasysh reformat që e ngritin sportin si prioritet shtetëror dhe që e trajton atë si një çështje ndër-sektoriale me përfshirjen e ministrive dhe autoriteteve tjera në funksion të zbatimit të kornizës ligjore të sportit. Ky opsion kërkon reforma strukturore që lehtëson bashkëpunimin, koordinimin dhe efikasitetin e të gjithë mekanizmave në zbatim të kornizës strategjike dhe ligjore. Për reformën e strukturës vendimmarrëse ndër të tjera do të merret për bazë po ashtu analiza e konkurrueshmërisë rregullative.

- Gjatë rivlerësimit të strukturave vendimmarrëse në sektorin e sportit do të respektohet pavarësia e nivelit lokal dhe pavarësia e plotë të sektorit jo-qeveritar.

- Në përputhje me ligjin për vetëqeverisje lokale, ligji i ri për sport do të rishikoj rolin e komunave në: zhvillimin e sportit në nivel të komunës; inkurajimin për shfrytëzimin e potencialit për bashkëpunim ndër-komunal në sektorin e sportit në veçanti për sa ka të bëjë me infrastrukturën fizike sportive; përgjegjësinë për planifikimin, ndërtimin, menaxhimin e infrastrukturës fizike sportive; regjistrimin e klubeve dhe qasjen në sistemin/platformën e të dhënave; ngritjen e buxhetit për sektorin e sportit; organizimin e ngjarjeve të mëdha sportive për të cilat sipas nevojës mbështetje do të ofrohet nga institucionet e nivelit qendror.

- Korniza e re ligjore do të përcaktoj përgjegjësitë për të gjitha institucionet relevante që të bashkëpunojnë me komunat për zhvillimin e sportit përmes strategjisë së sportit si dhe instrumenteve tjera zbatuese.

### 3. *Mekanizmat bashkërendues institucional*

- Opsioni i politikës për mekanizmat bashkërendues në sektorin e sportit propozon krijimin e një hierarkie e cila siguron shtrirje, menaxhim dhe zhvillim të sportit si vertikalisht ashtu edhe horizontalisht me synimin kryesor nxitjen e pjesëmarrjes në aktivitetin fizik dhe në sport në tërësi.
- Qëllimi i reformës është ngritja e sportit në nivelin e dëshiruar përmes kornizës strategjike dhe ligjore e cila mundëson një qasje ndër-sektoriale të përfshirjes në sektorin e sportit ku të gjitha institucionet publike bashkërendojnë politikat, programet, skemat e financimit për sport duke përfshirë përgjegjësin[ e zbatimit dhe monitorimit.
- Hartimi i Strategjisë Shtetërore të Sportit duhet të përfshij objektiva të përgjithshme dhe specifike e cila do të siguroj një qasje gjithëpërfshirëse të institucioneve të nivelit qendror dhe atij lokal duke përfshirë organizatat përgjegjëse në sektorin e sportit e cila do të ketë planin e veprimit për secilin aktivitet në përputhje me kornizën ligjore për hartimin e dokumenteve strategjike. Miratimi i këtij Koncept Dokumenti dhe Strategjisë për Sport do të përcillet me aktivitete përkatëse në promovimin e politikës së re ku Ministria do të bëjë koordinimin dhe përfshirjen e mekanizmave përgjegjës në sektorin e sportit në funksion të zbatimit të politikës së re në sektorin e sportit.
- Ky opsion kërkon vlerësimin e nevojës të një organi të nivelit të lartë zbatues e koordinues për fushën e sportit i cili përfshin pjesëmarrjen ndërministrore dhe ndër-sektoriale me qëllim të adresimit dhe propozimit të zgjidhjeve për çështjet që janë në dobi për sportin. Për këtë qëllim, grupi punues për hartimin e ligjit, ndër të tjera do të merrë në konsideratë analizën e konkurrueshmërisë rregullative si dhe përvojën dhe praktikat e mira të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

### 4. *Organizatat ombrellë të sektorit jo-qeveritar:*

- Organizatat e sektorit jo-qeveritar do të mbeten partnerë kryesor të zbatimit të Strategjisë së Sportit të Kosovës.
- Rëndësi e veçante do ti kushtohet Komitetit Olimpik të Kosovës dhe Komitetit Paralimpik të Kosovës të cilat veprojnë si organizata ombrellë kryesore për sportin olimpik dhe para-sportin, me fokus të veçantë në prezantimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare, ngritjen e kapaciteteve në kuadër të organizatave sportive, dhe zhvillimin e sportit në nivel vendor. Përmes ligjit të ri për sport do të përcaktohen qartë roli dhe përgjegjësit e të të dy organizatave.
- Ligji do të ofroj qartësi për rolin dhe përgjegjësitë e organizatave sportive ekzistuese dhe atyre të rejave të cilat në qendër të veprimtarisë së tyre kanë personat me aftësi të kufizuara siç janë: Olimpiada Speciale, Shoqata e Sporteve për të Shurdhëritë në Kosovë, Federata e Sportit për të Verbër, etj.
- Do të vlerësohet nevoja për krijimin e organizatave tjera ombrellë të cilat i mungojnë komunitetit, ku rrjedhimisht ligji i ri do të përcaktoj bazën ligjore për krijimin e organizatave të cilat do të jenë zëri kryesor për avokimin e të drejtave të pejsëmarrëve në sport.
- Federata e Sportit Shkollor dhe ajo e Sportit Universitar përveç që do të kenë funksionet e zhvillimit të aktivitetit si federata sportive, të njëjtat do të fuqizohen edhe përmes politikave zhvillimore për ngritjen e kapaciteteve dhe ndërlidhjen më të mirë me mekanizmat e sportit dhe institucionet e arsimit.
- Ligji do të ofroj qartësi të rregullave për funksionimin e federatave qofshin ato edhe jo-olimpike apo shoqatave sportive të cilat përveç sportit garues mund të kenë në fokus nxitjen e pjesëmarrjes në aktivitetin fizik, përfshirjen e të rinjëve dhe të gjitha grupmoshave në sport, apo edhe grupeve tjera të veçanta.
- Korniza e re ligjore do të mundësoj përfshirjen dhe përcaktimin e rolit të sportistëve, trajnerëve dhe prindërve në nivelet e strukturave organizative të sportit për të mundësuar shfrytëzimin e potencialit për zhvillim.
- Grupi punues gjatë hartimit të ligjit, varësisht nga nevoja mund të bëjë propozime përkatëse të organizatave ombrellë të lartcekura.

- Ligji i ri, përveç që do të njeh autonominë e plotë të organizatave sportive, statusi i tyre *(Federatave dhe Klubeve të Sportit)* do të jetë i interesit të veçantë publik i cili do të reflektohet gjithashtu në kornizën e re ligjore. Përjashtim nga ky status, do të bëjnë organizatat e rregullta jo-qeveritare të cilat merren me sektorin e sportit por nuk ushtrojnë veprimtari sportive.

5. ***Strukturat tjera***

**Agjencia anti-doping**

- Ligji për Sport do të bëjë referencë në ligjin e veçantë për anti-doping dhe do të njoh pavarësinë e ushtrimit të veprimtarisë së plotë.

**Këshilli i Arbitrazhit Sportiv**

- Do të vazhdoj të funksionoj duke u përcaktuar si organ plotësisht i pavarur i cili do të funksionoj në përputhje me standardet ndërkombëtare si dhe do të gëzoj pavarësi në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave funksionale, organizative dhe në administrimin financiar në pajtim me ligjin.

**Këshilli kombëtar për parandalimin e dhunës, sjelljeve të palejuara, dukurive negative në ngjarjet sportive**

- Do të vazhdoj të funksionoj si organ në kuadër të ligjit përkatës për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive. Paralelisht me procesin e hartimit të ligjit të ri për sport do të inicohet ndryshimi dhe plotësimi i ligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive në përputhje me pikën 3.3.2 për të adresuar cështjet e dhunës, sjelljeve të palejuara, dukurive negative në ngjarjet sportive si dhe për të mundësuar funksionimin e plotë të këtij mekanizmi.
- Gjatë ndryshimit dhe plotësimit të këtij ligji, do të trajohet me kujdes pjesa që ka të bëjë me luftimin e dukurive negative përfshirë dhunën fizike, seksuale dhe ngacmimin seksual. Mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave grave e vajzave dhe burrave e djemve që merren me sport do të krijohen dhe funksionalizohen duke marrë në konsideratë rolin e sinjalizuesit dhe kornizën ligjore për mbrojtjen e sinjalizuesve si dhe kodet e qeverisjes së mirë dhe atij etik.

**Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive**

- Do të vazhdoj të funksionoj si organ në kuadër të kornizës ligjore përkatëse të shëndetësisë i cili do të ketë rol kyç në kujdesin shëndetësor të sportistëve profesional dhe të tjerëve të përfshirë në aktivitet fizik të organizuar si dhe parandalimin dhe trajtimin e lëndimeve potenciale sportive. Ligji i ri i sportit do të përcaktoj rregulla dhe detyrime për realizimin e kontrolleve mjekësore si dhe do të paraqes nevojën për ndryshimin dhe plotësimin e kornizës ligjore për të qenë në harmoni me ligjin e ri të sportit dhe për të mundësuar lidhjen më të mirë me institucionet dhe organizatat e sportit dhe ato të arsimit.

**Grupi konsultativ i Sportit**

- Korniza e re ligjore do rivlerësoj rolin e grupit konsultativ ekzistues për të siguruar shmangien e duplifikimit të rolit dhe përgjegjësive, ku roli kryesor i këtij grupi është ofrimi i këshillave profesionale.

6. ***Dispozitat e përgjithshme dhe dispozitat tjera specifike procedurale***

- Ligji i ri do të parasheh dispozitat e përgjithshme dhe dispozitat specifike procedurale të planifikimit, menaxhimit dhe zhvillimit të sportit në të gjitha nivelet. Ligji po ashtu do të krijoj bazë të qartë ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore dhe nxjerrjen e kodeve dhe udhëzuesve për zbatimin e fushave të caktuara në ligj.
- Ligji do të përcaktoj Strategjinë e Sportit si dokumentin kryesor strategjik e orientues për zhvillimin e sportit, si dhe do të njoh autonominë e plotë të sektorit jo-qeveritar duke inkurajuar vet-rregullimin në funksion të arritjes së objektivave të Strategjisë së Sportit.
- I njëjti do të përcaktoj parimet dhe standardet e qeverisjes së mirë, llogaridhënien dhe transparencën në sektor, të drejtat dhe detyrimet për të gjitha institucionet të nivelit qendror dhe lokal si dhe organizatave të sektorit jo-qeveritar në zbatimin e ligjit të sportit.
- Duke marrë parasysh se procedurat dhe kriteret për regjistrimin dhe licencimin e federatave të sportit të përcaktuara në kornizën ligjore aktuale të Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizata Jo-qeveritare dhe atë të Ligjit të Sportit, grupi punues gjatë hartimit të ligjit të ri, do të shqyrtoj mundësinë dhe praktikat e mira të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, që procesin e regjistrimit dhe licencimit të tyre si dhe të organizatave sportive që ta përcaktoj rregullimin e ri ligjor me qëllim të eliminimit të pengesave dhe vështirësive të cilat ekzistojnë aktualisht me kornizën ligjore në fuqi.
- Ligji do të njeh mundësinë që klubet e sportit të regjistrohen edhe si biznese në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare.
- Ligji do të njeh aktivitetet e natyrave të veçanta të cilat zhvillohet në formë ndryshe prej sporteve tjera siç është esports, dhe do të krijoj kushte dhe kritere të veçanta për zhvillimin e tyre në përputhje me rregullat e Bashkimit Evropian.
- Ligji i ri, përveç që do të njeh autonominë e plotë të organizatave sportive, do të njeh edhe statusin e tyre tyre të veçantë publik i cili do të reflektohet në kornizën ligjore.
- Kujdesi i sportistëve, trajnerëve dhe ekspertëve të sportit të cilët arrijnë rezultate të larta në sport do të rregullohet me ligjin e ri të sportit si dhe do të vë fokusin në mundësimin e zhvillimit të karrierës duale të sportistëve.
- Ligji do të përcaktoj detyrimin për të përcaktuar llojet e infrastrukturës fizike sportive përfshirë të hapësirat e jashtme dhe të brendshme, nacionale apo lokale; përcaktimin e kritereve bazë të standardeve minimale të menaxhimit dhe mirëmbajtjes të cilat pastaj do të zbërthehen përmes akteve nënligjore në zbatim të ligjit.
- Ligji i ri do të përcaktoj sistemin e të dhënave/platformën dhe digjitalizimin e shërbimeve për brenda kufijve buxhetor ku: Ministria përkatëse për sport, Ministria përkatëse për Punë të Brendshme, Ministria përkatëse e Arsimit, Komuna, KOK-u, KPK-ja, Federatat dhe Klubet do të kenë qasje në sistemin e të dhënave/platformën, e cila do të përmbaj të dhëna për: infrastrukturën fizike sportive, federatat, klubet, sportistët, gjyqtarët/referet, buxhetin etj. Kjo platformë, do të shërbej për një planifikim më të mirë të politikave, orientim të buxhetit dhe zhvillim të sektorit si dhe do të mundësoj identifikimin e nevojave për ndërhyrje.

7. ***Mbrojtja e të drejtave dhe barazia gjinore në sport***

- Ligji i ri për sport do të përcaktoj të drejta të barabarta në qasje dhe pjesëmarrje në sport dhe qeverisjen sportive për sa i përket aspektit gjinor dhe do të jetë në harmoni të plotë me Ligjin për Barazinë Gjinore dhe Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në këtë drejtim, gjatë përcaktimit të parimeve të qeverisjes së mirë dhe vlerësimit të nevojës së ndryshimit të ligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, do të trajohet me kujdes pjesa që ka të bëjë me luftimin e dukurive negative sikurse dhuna fizike, seksuale dhe ngacmimi seksual. Mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave grave e vajzave dhe burrave e djemve që merren me sport do të krijohen dhe

funksionalizohen duke marrë në konsideratë edhe rolin e sinjalizuesit dhe kornizën ligjore për mbrojtjen e sinjalizuesve.

*8. Ngritja e kapaciteteve*

- Ligji do të përcaktoj dispozita ligjore dhe autoritetet përkatëse për ngritjen e kapaciteteve në të gjitha nivelet si dhe do të bëjë ndërlidhje me Strategjinë e re të Sportit.

*9. Zbatimi*

- Ligji i ri do të përcaktoj autoritetet për zbatimin e ligjit të ri të sportit ku rolin kryesor në zbatim do ta kenë federatat, klubet e sportit, sportistët, trajnerët, profesionistët e sportit si dhe të gjithë të tjerët të përfshirë në procesin e sportit.
- Në zbatim të ligjit, do të përcaktohen përgjegjësitë e institucioneve të nivelit qendror dhe atij lokal si dhe ato të organizatave jo-qeveritare për zbatimin e strategjisë dhe legjislacionit në përputhje me opsionin e rekomanduar në këtë Koncept Dokument.

*10. Transparenca*

- Ligji i ri do të përcaktoj standarde dhe rregulla të transparencës, publikimit të dokumenteve si dhe do të garantoj lirinë e qasjes në informacion në përputhje me dispozitat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe në përputhje me ligjin për lirinë e informacionit duke respektuar autonominë e sektorit jo-qeverisës. Standardet e pranuara ndërkombëtarisht do të bëhen pjesë e sistemit juridik vendor.

*11. Sanksionet*

- Ligji i ri do të përmbaj sanksione për dështimin e zbatimit të dispozitave të ligjit të cilat do të drejtohen kryesisht për institucionet e nivelit qendror, komunave si dhe mekanizmave tjerë të sektorit qeverisës.
- Përderisa, për sa i përket pjesës së sektorit jo-qeveritar, ligji i ri do të përcaktoj vetë-rregullimin e sektorit ku federatat dhe organizatat e sportit do të kenë fleksibilitetin e tyre të rregullimit të sanksioneve në harmoni me sanksionet dhe masat disiplinore të federatave ndërkombëtare ku ato bëjnë pjesë. Në raste përjashtimore, kur të drejtat e sportistëve, klubeve dhe palëve tjera të përfshira në proces shkelen, ligji do të përcaktoj sanksione për moszbatimin e ligjit për të gjithë pa përjashtim.

*12. Monitorimi*

- Ligji i ri do të përcaktoj sistemin/platformën digjitale si mjet për monitorim ku gjithashtu roli dhe përgjegjësitë e institucioneve në raport me monitorimin dhe raportimin do të përcaktohen përmes dispozitave ligjore në ligj.
- Dispozitat ligjore të ligjit të sportit do të adresojnë përgjegjësitë e mekanizmave kryesor në zbatimin e politikave qeveritare dhe pajtueshmërinë me ligjin.

*13. Shfuqizimi dhe periudha tranzitore*

- Me ligjin e ri do të shfuqizohet ligji aktual i sportit me plotësimet dhe ndryshimet e tij. Gjithashtu me këtë ligj, do të shfuqizohen edhe dispozitat e veçanta që rregullojnë pjesë të sportit që nuk janë në përputhje me ligjin e ri të sportit.
- Me qëllim zbatimin e plotë të ligjit, Ministria do të propozoj një periudhë tranzitore të hyrjes në fuqi të ligjit prej së paku 6 muaj pas miratimit të tij nga Kuvendi për të mundësuar realizimin e reformës.

*14. Çështjet përcjellëse të ligjit*

- Ligji i ri i sportit do të përcjellët edhe me aktivitete tjera shtesë në drejtim të realizimit të ri-organizimit dhe përshtatjes me dispozitat e ligjit. Për këtë qëllim, Ministria do të ngris një mekanizëm të veçantë

që do të mbështes punën në përgatitjen e sektorit për zbatimin e ligjit. Mekanizmi i veçantë do të përbëhet nga ekspertë të fushave të ndryshme të stafit ekzistues të institucioneve publike si nga MKRS, MAShTI, MSH etj. Ky mekanizem, sipas nevojës mund të ftoj përfaqësues të jashtëm për mbështetjen e punës dhe realizimin e aktiviteve të caktuara të cilat janë përcaktuar në këtë Koncept Dokument.

### 3.3.2 Ndryshimi dhe plotësimi i ligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive

- Grupi punues gjatë analizës së zhvilluar të legjislacionit ekzistues në fuqi të sektorit të sportit ka konkluduar se Ligji Nr. 05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive është ligj i mangët i cili nuk adreson në mënyrë të plotë parandalimin dhe luftimin e dukurive negative përfshirë aspektet e qeverisjes së mirë që do të mundësonte një ambient të sigurtë dhe favorizues për pjesëmarrje në sport.
- Plotësim ndryshimi i ligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive do të ndodh paralelisht me procesin e hartimit të ligjit të ri për sport për të siguruar një konsistencë të plotë në mes të këtyre dy ligjeve të cilat janë jetike për të mundësuar një qeverisje më të mirë në sektorin e sportit.
- Ligji aktual në fuqi, përvec elementeve dhe cështjeve të cilat i përmban në parandalimin dhe luftimin e dukurive negative, do ti shtohen kompetenca dhe përgjegjësi në parandalimin dhe luftimin e dhunës fizike, seksuale, ngacmimit seksual si dhe do të përcaktoj mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të grave e vajzave dhe burrave e djemve që merren me sport. Mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të tyre do të përcaktohen në harmoni të plotë me ligjin e ri për sport, ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi, ligjin për barazi gjinore, ligjin për sinjalizuesit, kodet e etikës dhe qeverisjes së mirë si dhe praktikave të mira për fëmijët në sport.

### 3.3.3 Finalizimi dhe miratimi i Strategjisë së Sportit

Ministria përgjegjëse për sport, në bashkëpunim Komitetin Olimpik dhe organizatat e sportit, do të finalizoj Strategjinë Shtetërore të Sportit e cila do të konsultohet me të gjitha palët e përfshira.

Strategjia do të përcaktoj objektiva dhe targete të qarta për sa i përket orientimit të zhvillimit të sportit, mënyrës së ndarjes buxhetore dhe aspekteve të shfrytëzimit të resurseve financiare, njerëzore dhe infrastrukturës të dedikuara për sektorin e sportit.

Strategjia Shtetërore për Sportin do të përafroj dhe do të bazohet në standardet dhe dokumentet strategjike të BE-së.

- ***Politikat zhvillimore do të fokusohen gjithashtu në sektorët si vijon:***

  - ***Sporti elitar***

Potenciali më i fortë të cilin e ka Kosova është rinia e cila çdo ditë është duke na bërë krenar me sukseset e arritura në arenën ndërkombëtare. Për të fuqizuar edhe më tej sportin elitar, sportistët, trajnerët dhe profesionistët e sportit kanë nevojë për udhëheqje dhe mbështetje të cilësisë së lartë, jo vetëm në sportin të cilin e praktikojnë, por gjithashtu nga mjedisi i tyre i punës duke përfshirë infrastrukturën e nevojshme për të maksimizuar potencialin në arritjen e rezultateve kulminante sportive.

Ministria përgjegjëse për sport dhe strukturat vendimmarrëse, në bashkëpunim të ngushtë me Komitetin Olimpik të Kosovës, gjatë krijimit të politikës zhvillimore do të përkushtohet që të:

1. Sjellë risi në sportin elitar;
2. Krijoj kushte dhe ambient më të favorshëm për trajnimin e sportistëve elitar;
3. Krijoj kushte dhe sistem të qëndrueshëm të identifikimit të talenteve sportiv;
4. Ofroj mundësi dhe mbështetje për zhvillimin e talenteve të rinj;
5. Përcaktoj mbështetjen dhe kujdesin për sportistët elitar gjatë karrierës sportive;
6. Mundësoj trajnime specifike dhe mundësi punësimi për sportistët elitar gjatë dhe pas karrierës së tyre sportive.

- ***Sporti për të gjithë***

Politikë zhvillimore e veçantë do të jetë sporti për të gjithë, përfshirja e të gjitha grupmoshave pa dallim në aktivitetin fizik me qëllim ngritjen e nivelit pjesëmarrës në aktivitete të ndryshme dhe përmirësimin e formës fizike dhe shëndetit mendor duke përfshirë forcimin e marrëdhënieve shoqërore. Strukturat vendimmarrëse në fushën e sportit gjatë krijimit të politikës zhvillimore për sportin për të gjithë do të përkushtohen që të fuqizojnë integrimin e aktivitetit fizik dhe sportiv në sistemin e arsimit parauniversitar dhe universitar me fokus të veçantë në nivelin parashkollor, nivelin fillor dhe të mesëm; zhvillimin e qëndrueshëm të aktiviteteve sportive të organizuara; nxitjen e aktivitetit fizik në formë jo të organizuar me fokus të veçantë tek aktivitetet që zhvillohen në ambiente të hapura dhe natyrë.

Gjithashtu, kujdes i veçantë do t'i kushtohet qasjes ndër-sektoriale gjatë krijimit të kornizës ligjore dhe zhvillimit të politikave zhvillimore duke përcaktuar rol aktiv të Ministrisë së Shëndetësisë dhe institucioneve shëndetësore, ku roli i tyre do të reflektohet në kornizën e ardhshme ligjore duke synuar arritjen e ndikimeve pozitive shëndetësore për të gjithë ata që merren me aktivitete fizike.

- ***Sporti për diplomaci***

Arritjet dhe sukseset e sportisteve tanë në arenën ndërkombëtare e kanë bërë krenar të gjithë popullin. E ardhmja e Kosovës është po aq e ndritur sa e tashmja. Sporti është mjet i rëndësishëm në promovimin e agjendave dhe në nxitjen e ndryshimeve sociale dhe kulturore ku sportistët tanë janë ambasadorët e epokës moderne dhe në këtë kontekst, politika zhvillimore e sportit për diplomaci do të ketë në fokus zhvillimin e këtij koncepti ku hartimi i objektivave strategjik do të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë përkatëse për punë të jashtme. Komponentë tjetër e rëndësishme e këtij koncepti është edhe sporti për turizëm, ku ndër qëllimet kryesore e ka pjesëmarrjen në sport dhe aktivitet fizik përmes shëtitjes dhe turizmit, ku arsyeja kryesore e udhëtimit është pjesëmarrja në sport dhe aktivitet fizik, dhe për të parë një ngjarje sportive. Kjo komponentë do të zhvillohet duke u mbështetur në përvojat e vendeve të cilat e kanë zhvilluar këtë koncept dhe duke i bërë pjesë të procesit autoritetet publike përgjegjëse për turizmin si dhe duke marrë përvojën dhe ekspertizën e sektorit jo-qeveritar profesionistëve vendor në zhvillimin e këtij koncepti.

Grupi punues për hartimin e Strategjisë së Sportit do të bëjë përfshirjen e kombinimin e këtyre politikave zhvillimore ku politika tjera zhvillimore mund të dizajnohen gjatë procesit të hartimit dhe finalizimit.

### 3.3.4 Përcaktimi i modelit të financimit të sportit

Shuma e buxhetit për kokë banori në sektorin e sportit në periudhën e ardhshme afatmesme duhet të rritet në veçanti kur kemi në fokus edhe zhvillimin e sistemit të sportit në komunitet.

Ekzistojnë modele të ndryshme të financimit dhe në këtë drejtim, Strategjia e re e Sportit duhet të fokusohet në një qasje ndërsektoriale, duke përfshirë financimin e politikave të sportit për të mundësuar ngritjen e rolit dhe përgjegjësisë së të gjithë hisedarëve të sektorit të sportit në avancimin e fushës së sportit. Do të konsiderohet ndarje më e madhe e buxhetit për sportin e nivelit lokal me fokus të veçantë te klubet sportive me qëllim të ngritjes së konkurrencës sportive në nivelin lokal dhe ndërmjet komunave.

Gjithashtu, buxheti i planifikuar nga ministri të ndryshme në funksion të sportit, do të kanalizohen përmes Strategjisë së re të Sportit, duke promovuar në të njëjtën kohë sportin dhe vullnetarizmin.

Duhet të konsiderohet mekanizmi i ridistribuimit të hyrave për të ngritur fondin e sportit dhe ngritur përkrahjen e zhvillimit të sportit. Kjo mund të marrë formën e instrumenteve ekonomike/lehtësirave në veprimtari apo aktivitete të posaçme, të cilat pastaj i dedikohen fondit të sportit. Instrumentet ekonomike mund të aplikohen për duhanin, alkoolin, derivatet djegëse etj. Një pjesë e taksës rrugore ose shumës së parkingut mund ti dedikohen sportit për të mundësuar qëndrueshmërinë dhe pjesëmarrjen në aktivitete fizike. Të hyrat e mbledhura nga këto instrumente dhe shuma buxhetore e dedikuar për sport do të ndahet përmes procesit të rregullt buxhetor të përcaktuar me kornizën ligjore në fuqi për buxhetin e Republikës së Kosovës.

Në drejtim të financimit, duhet të ri-konsiderohet krijimi i sinergjisë së fondeve private dhe atyre të shtetit duke vlerësuar përdorimin e lotarisë dhe mjeteve të gjeneruara nga bastet për të mbështetur zhvillimin e sportit. Lotaritë shtetërore janë një nga burimet më të përdorura të financimit për sportin në Evropë. Ndërsa paratë nga bixhozi dhe bastet janë më pak të përdorura në të gjithë Evropën përveç disa garave specifike në disiplina të ndryshme. Pra, në përgjithësi në Evropë përdorimi i lotarisë është forma më e shpeshtë e hasur për financimin e sportit.

Ministria, në funksion të zhvillimit të sektorit të Sportit do ta ketë mundësinë e shqyrtimit të alternativave të ndryshme duke mos përjashtuar edhe mundësinë e huamarrjes me qëllim të realizimit të kredive të buta të cilat do të mundësonin mobilizim më të shpejtë të resurseve në funksion të avancimit të infrastrukturës fizike sportive.

Grupi punues thekson se duhet të rivlerësohet shfrytëzimi i parasë të mediave pasi që paratë nga media janë burimi më i madh i të ardhurave për sportet komerciale dhe profesionale në Evropë. Prandaj, financimi në sport duhet të marrë në konsideratë se si të maksimizohet mbështetja edhe nga paratë e mediave nisur nga fakti se jurisprudenca e BE-se dhe praktikat e shumë vendeve evropiane, tregojnë se shitja kolektive e marketingut dhe të drejtave televizive, nëse zbatohet siç duhet, është një instrument i përshtatshëm për të rritur mbështetjen në sport.

Ligji i ri, gjithashtu duhet të bëjë një ndërlidhje më të mirë në shfrytëzimin e fondeve të jashtme të organizatave të ndryshme ndërkombëtare duke forcuar mekanizmat për përgatitjen dhe maturimin e projekteve me qëllim atraktimin e fondeve nga jashtë. Për një gjë të tillë, kërkohet qasje ndërsektoriale dhe përfshirje e ekspertizave të ndryshme në sektor.

### 3.3.5 Ngritja e kapaciteteve administrative e profesionale për sektorin e sportit në të gjitha nivelet

Gjatë analizës dhe zhvillimit të koncept dokumentit për sport si dhe bazuar në të dhënat e prezantuara, kapacitetet njerëzore qofshin ato administrative apo profesionale, janë të limituara në gjitha nivelet, duke

filluar nga Ministria përgjegjëse për Sport, Ministria përgjegjëse për Arsim, KOK, KPK, si dhe në shumicën e organizatave të sportit *(Federata dhe Klube të Sportit)* duke përfshirë stafin dhe të angazhuarit në nivel të klubeve të sportit. Këto kapacitete të limituara, ndikojnë drejtpërdrejtë në cilësinë e sportit në shumë dimensione.

Gjatë fazës së hartimit dhe miratimit të kornizës së re ligjore të sportit, Ministria në bashkëpunim me autoritetet përkatëse të sportit, do të inicoj vlerësimin e nevojave për kapacitetet njerëzore të përfshira në sektorin e sportit për të mundësuar përshtatjen dhe zbatimin e kornizës së re ligjore.

Në këtë drejtim, zgjidhja afatgjate vlerësohet se mund të arrihet përmes rivlerësimit të strukturave vendimmarrëse dhe strukturave zbatuese ku prioriteti kryesor do të jetë ngritja e kapaciteteve në të gjitha nivelet dhe fushat e sportit dhe qeverisjes së mirë. Në këtë drejtim, Strategjia e Sportit do të përcaktoj programe afatmesme të veçanta për ngritjen e kapaciteteve në sektorin e sportit.

Me ligjin e ri të sportit, bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë dhe mekanizmave të ministrisë me Komitetin Olimpik, Komitetin Paralimpik, Ministrisë përgjegjëse për Arsim, Komunës, Federata të Sportit etj, do të adresohet me prioritet të veçantë, ku roli kryesor i Ministrisë do të jetë përcaktimi i kritereve dhe standardeve profesionale për të angazhuarit në sektorin e sportit.

Për sa i përket ngritjes së kapaciteteve, duke pasur në konsideratë se në nivel ndërkombëtar gjithnjë e më tepër janë duke u ngritur iniciativat për zhvillimin e sportit në nivel ndërkombëtar, organizatat e sportit, federatat, klubet, sportistët dhe të gjithë të përfshirët në këtë sektor, duhet të shfrytëzojnë mundësinë e përfitimit nga fondet e:

a. Solidaritetit Olimpik;
b. UEFA Hattrick;
c. Zhvillimi i FIFA;
d. Erasmus Plus etj.

Shfrytëzimi i këtyre programeve/granteve mund të bëhet përmes granteve të vogla për të zhvilluar ide dhe ngritur kapacitetet. Një program i tillë do të mund të drejtohet nga Ministria përgjegjëse për Sport, Ministria përgjegjëse për Arsim, apo Zyra e Kryeministrit e cila i mbulon proceset e integrimit evropian.

### 3.3.6 Rekomandimet për ministritë e linjës në fuqizimin e sportit

Duke marrë parasysh problemin e identifikuar në sektorin e sportit:

- MKRS, të rishikoj ligjin për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, si dhe të hartoj kodin e qeverisjes së mirë dhe etikës për përcaktuar mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë personave si dhe parandalimin dhe luftimin e dukurive negative përfshirë dhunën fizike, seksuale dhe ngacmimin seksual. Gjatë rishikimit të kornizës ligjore vëmendje e vecanët duhet ti kushtohet grave e vajzave dhe burrave e djemve që merren me sport si dhe duhet të njihet roli i sinjalizuesve në mekanizmat e rinjë që duhet të përcaktohen në ligj;
- MAShTI, të shqyrtoj mundësinë e ngritjes së fondit të orëve të edukatës fizike në të gjitha nivelet e arsimit me fokus tek klasa 1 deri në 5 si dhe mundësinë e fuqizimit të aktivitetit fizik të adaptuar në kuadër të kurrikulës parashkollore;
- MAShTI, të shqyrtojë çështjen për shtimin e mësimdhënësve adekuat për zhvillimin e lëndës së edukatës fizike për klasët 1 deri në 5;
- MAShTI, të shqyrtoj mundësinë e zhvillimit të kapaciteteve ekzistuese për lëndën e edukatës fizike.

- Ministritë e linjës sikurse Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Brendshme etj. të ofrojnë mundësi për sportistët e dalluar në përfshirjen e tyre në funksion të avancimit të veprimtarive të caktuara në kuadër të institucioneve duke mundësuar shfrytëzimin e kapaciteteve maksimale.
- MFPT, të shqyrtoj rregullimin ligjor të lotarisë dhe lojërave të fatit me qëllim që mjetet e realizuara nga ky sektor, të dedikohen në zhvillimin e sportit, ngritjen e pjesëmarrjes në aktivitet fizike dhe sport si dhe përmirësimin e shëndetit.
- MFPT, dhe MAPL të shqyrtojnë dhe vlerësojnë nevojën për ngritjen e kapaciteteve njerëzore të dedikuara për sektorin e sportit në institucionet publike të të gjitha niveleve;
- MFPT, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi të adresoj cështjet e ngritura në këtë koncept dokument që kanë të bëjnë me pensionimin e parakohshëm të sportistëve elitar;
- MKRS dhe MFPT të krijojnë forma të bashkëpunimit me Agjencinë e Punësimit gjatë fazës së hartimit të programeve dhe përfshirjes së sportistëve në këto programe për të ofruar mundësi të vazhdimit të karrierës në kapacitete të ndryshme.

Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme të opsioneve

Figura më poshtë paraqet ndikimet më të rëndësishme që janë identifikuar. Shtojcat 1 deri 4 paraqesin vlerësimin e të gjitha ndikimeve në përputhje me mjetet për identifikimin e ndikimeve ekonomike, shoqërore, mjedisore dhe ndikimeve të të drejtave themelore. Këto mjete janë të listuara në Manualin për Hartimin e Koncept Dokumenteve. Katër shtojcat gjithashtu tregojnë vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve të ndryshme dhe nivelin e preferuar të analizës.

*Figura 12: Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategori ndikimi*

| **Kategoritë e ndikimeve** | **Opsioni 1** | **Opsioni 2** | **Opsioni 3** |
| --- | --- | --- | --- |
| Ndikimet ekonomike | Opsioni do të ndikoj në përkeqësimin e gjendjes ekzistuese, ku potenciali i sportit në zhvillimin ekonomik nuk do të mund të jetë në efektin e dëshiruar si rezultat i përkeqësimit të infrastrukturës fizike sportive, mungesës së rritjes së cilësisë së sportit të cilat do të shpien në zvogëlimin e mbështetjes nga bizneset. | Përmirësimi i zbatimit dhe i ekzekutimit do të ketë ndikime të përkohshme por ndikimi ekonomik i pritur në periudhë afatmesme dhe afatgjatë është i pamundur pa një reformë në sistemin e sportit. | Krijimi i një kornize të re ligjore dhe hartimi i Strategjisë së Sportit i kombinuar me masa zbatuese dhe standarde të trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve, do të ketë efekt të drejtpërdrejtë në rritjen e vendeve të punës si dhe mundësi për investime në sektorin e sportit si dhe në infrastrukturë.<br>Gjithashtu, zhvillimi i konceptit të sportit për turizëm do të tërheq vëmendjen e shoqërisë që do të kontribuoj në dimensionin ekonomik dhe shoqëror. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Ndikimet shoqërore | Opsioni asnjë ndryshim do të coj në paqëndrueshmëri të organizatave të sportit, klubeve, sportistëve, trajnerëve dhe profesionistëve sportiv si dhe do të ketë efekt negativ në promovimin e sportit në të gjitha nivelet nga ai rekreativ deri te sporti elitar ku të gjithë grupmoshat do të ndikohen negativisht. | Ndikimet sipas opsionit 2 do të ishin në masë më të reduktuar por pa ndryshimet ligjore në ligjin e sportit, pa një dokument strategjik orientues për zhvillimin e sportit drejtë shfrytëzimit të potencialit shoqëror, ndikimi shoqëror do të jetë minimal. | Opsioni 3 do të ketë ndikime pozitive në pjesëmarrjen e të rinje si dhe pjesëmarrjen e të gjithë grupmoshave në aktivitete fizike të cilat drejtpërdrejtë do të ndikojnë në përmirësimin e jetës dhe shëndetit. |
| Ndikimet mjedisore | Asnjë ndikim mjedisor. | Asnjë ndikim mjedisor | Nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis, megjithatë rritja e pjesëmarrjes në aktivitetet fizike dhe sport në përgjithësi do të rezultoj në interesim më të madh dhe kujdes të shtuar ndaj mjedisit. |
| Ndikimet në të drejtat themelore | Opsioni asnjë ndryshim do të ndikoj negativisht në mbrojtjen e të drejtave themelore dhe integritetin njerëzor si dhe do të ketë ndikim negativ të shumëanshëm, duke filluar nga shkelja e të drejtave në privatësi e mbrotje të dhënave personale, dukuritë negative, kurdisja e ndeshjeve, mungesë përgjegjësie e llogaridhënie. | Opsioni dy nuk do të arrij të arrij të mbroj të drejtat themelore pasi që mos intervenimi në kornizën ligjore do të pamundësoj përfshirjen e qeverisjes së mirë në të gjitha nivelet duke përfshirë adresimin e qartë të përgjegjësisë për mbrojtje dhe avancimin e të drejtave themelore. | Opsioni 3 ndikon drejtpërdrejt në mbrojtjen e të drejtave themelore të të gjithë atyre që përfshihen në aktivitetin fizik sportiv.<br><br>Opsioni rekomandon përfshirjen e parimeve të qeverisjes së mirë në kornizën ligjore e cila do të mundësoj avancimin dhe shfrytëzimin e mekanizmave për parandalimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.<br><br>Parimet dhe standardet e qeverisjes së mirë, janë propozuar të shoqërohen me ndërgjegjësimin dhe trajnimin e të gjithë grupmoshave për tu |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | siguruar se janë të informuar për të drejtat e tyre dhe mjetet juridike në dispozicion. |
| Ndikimi gjinor | Ndikim negativ gjinor ku pjesëmarrja e burrave do të vazhdoj të dominoj në të gjitha nivelet. | Opsioni 2 nuk ka ndikime të rëndësishme gjinore. | Opsioni 3 konsiston në ngritjen e pjesëmarrjes në aktivitete të sportit ku gjendja ekzistuese në të cilin pjesëmarrja e burrave dhe djemve është dukshëm më i madh se sa pjesëmarrja e grave dhe vajzave në aktivitetet e sportit dhe jo vetëm. Ngritja e pjesëmarrjes në sport do të shoqërohet me fushata ndërgjegjësuese ku gjithashtu do të synohet zbatimi i plotë i ligjit për barazi gjinore në të gjitha nivelet.<br><br>Gjendja ekzistuese e pabarazizë në të gjitha nivele e qeverisjes sportive ku pjesëmarrja dhe përfaqësimi i grave në strukturat qeverisë të sportit mbetet në nivel të ulët, do të zvogëlohet me synim arritjen e barazisë së plotë graduale. Opsioni i rekomanduar sjellë ndërthurje në këtë fushë. |
| Ndikimet e barazisë sociale | Asnjë ndikim në barazinë sociale. | Opsioni 2 do të mundësoj ngritje të lehtë të pjesëmarrjes në aktivitete të sportit por ndikimi do të jetë minimal duke marrë në konsideratë se qasja në infrastrukturë sportive dhe qasja në aktivitete rekreative do të rezultoj në vishtirësi pa një Strategji të qartë të Sportit dhe pa masa | Opsioni 3 përmes krijimit të kornizës së re ligjore të sportit si dhe përmes miratimit të Strategjisë së Sportit do të ofroj qasje më të lehtë në aktivitetin fizik si dhe në sportin në të gjitha nivelet po ashtu duke krijuar infrastrukturë fizike dhe hapësira për sport. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | konkrete për gjithëpërfshirje dhe barazi. | Korniza e re ligjore dhe strategjike do të shoqërohet me aktivitete ndërgjegjësimi me qëllim nxitjen dhe pjesëmarrjen e të gjitha grupmoshave, atyre që jetojnë në varfëri, grupeve të margjinalizuara dhe të rinjëve të komuniteteve si dhe do të ofroj ambient të sigurtë dhe favorizues për të gjithë pavarësisht përkatësisë sociale, fetare, nacionalitetit apo statuseve tjera. |
| Ndikimet tek të rinjtë | Asnjë ndikim tek të rinjtë. | Opsioni 2 do të ketë ndikim minimal përmes masave zbatuese të cilat nuk do të arrijnë qëllimet e këtij koncept dokumenti. | Opsioni 3 i cili mundëson krijimin e një kornize të re ligjore të shoqëruar me Strategjinë e Sportit e cila do të përmbaj ovjektiva dhe targete ndër-vite për nxitjen e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete sportive është prioritet kryesor drejtë shfrytëzimit të potencialit që përmes një rinie aktive, të përmirësohet shëndeti i shoqërisë, të avancoj imazhi i Kosovës në arenën vendore dhe ndërkombëtare në sektorin e sportit si dhe të sjellë përfitime shumëdimensionale. Opsioni i rekomanduar sjellë ndërthurje në këtë fushë. |
| Ndikimet në ngarkesën administrative | Gjendja aktuale të ketë ndikim negativ në funksionimin e qeverisjes së sektorit | Opsioni 2 pa ndryshime ligjore nuk do të zgjidhte problemin në tërësi pasi që për lehtësimin e procedurave dhe | Opsioni 3 i krijimit të kornizës ligjore do të mundësoj harmonizimin e ligjit me ligjin për procedurën e |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | jo-qeveritar në sektorin e sportit | ndërveprimit të organizatave të sportit me komunën dhe ministrinë do të mbeten të pa ndryshuara. | përgjithshme administrative si dhe krijimi i sistemit/platformës digjitale do të lehtësoj dukshëm administrimin e punës së të gjitha niveleve duke filluar nga sektori jo-qeveritar deri te niveli i komunës dhe ministrisë.<br><br>Opsioni 3 gjithashtu përcakton masa konkrete në ngritjen e bashkëpunimit të ministrisë me ministrinë e përkatëse për regjistrimin e ojq-ve, me komunën si dhe komitetin olimpik, komitetin paralimpik, federatat, klubet dhe personat tjerë të përfshirë në sektor. |
| Ndikimi i NVM-e | N/A | N/A | N/A |

Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave

Grupi punues, sic është cekur në hyrje të këtij Koncept Dokumenti, ka përfituar nga analiza e zhvilluar nga zyrtar të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, nga grupi punues për hartimin e Strategjisë së Sportit, hulumtime dhe analiza të realizuara në këtë sektor. Grupi po ashtu ka analizuar kornizën ligjore në fuqi ku të gjetura janë konsultuar edhe me palët e përfshira në proces.

Megjithatë, nxjerrja dhe analizimi i të dhënave kuantitative ka qenë më i vështirë dhe me raste nuk ka koresponduar me të dhënat të cilat mbahen nga autoritete të ndryshme sikurse, Ministria, Komuna, Ministria përkatëse për regjistirmin e OJQ-ve, Komitetit Olimpik të Kosovës, kryesisht për shkak të mungesës së një sistemi të të dhënave të mirëfillt të administrimit të punës dhe kapaciteteve të limituara.

Po ashtu, grupi punues ka hasur në sfidë në analizimin e aspekteve gjinore pasi që të dhënat për sa i përket pjesëmarrjes në aktivitet fizik dhe sport si dhe shpenzimet e realizuara në sektorin e sportit nuk kanë mundur të zbërthehen në aspketin gjinor. Grupi punues vlerëson se planifikimi i aktiviteteve, mbështetjes financiare dhe përgatitjes së programeve qoftë në zhvillimin e sportit apo në krijimin e infrastrukturës sportive, Ministria të ketë për bazë ligjin për barazi gjinore dhe të bëjë buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.

Të dhënat të cilat janë mbledhur nga palët e përfshira në proces si dhe nga grupi punues për hartimin e Strategjisë së Sportit, janë konsultuar dhe komunikuar me të gjitha autoritetet e përfshira me qëllim saktësimin e të dhënave. Si veprim shtesë, grupi për hartimin e Koncept Dokumentit, ka analizuar kornizën ligjore, institucionale dhe strategjike të shteteve tjera sikurse të Irlandës, Kroacisë dhe Sllovenisë si dhe ka

analizuar praktikat dhe legjislacionin e BE-së për të formësuar opsionet e prezantuara në këtë Koncept Dokument.

Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi

Komunikimi dhe konsultimi janë pjesë e rëndësishme për ngritjen e kualitetit të analizave në këtë Koncept Dokument. Në këtë drejtim, grupi punues ka planifikuar aktivitetet e konsultimit, të listuara në Figurën 13 mëposhtë.

*Figura 13: Pasqyrim i aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit të kryera për një Koncept Dokument*

| - Procesi i konsultimit synon të marrjen e opinioneve nga institucionet, organizatat e sportit, sportistët, trajnerët dhe të gjitha palët e përfshira në sektorin e sportit për këtë Koncept Dokument | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Qëllimi kryesor i aktivitetit | Grupi i synuar | Aktiviteti | Komunikimi/ Njoftimi | Data e aktivitetit |
